Rendi Alkorn

# Pse Pro-Jetës?



# Jeta njerëzore fillon... Kur?

Asnjë çështje nuk ka shkaktuar më shumë përçarje dhe polemika sesa aborti. Janë të shumtë ata që besojnë se jemi përpara një zgjedhjeje: të ndihmojmë gratë, apo të ndihmojmë foshnjat. Ky libër na tregon se sa jetësore është që t'u vijmë në ndihmë si grave, ashtu edhe foshnjave. Rendi Alkorn (Randy Alcorn) u jep, drejtpërdrejt dhe me kujdes, përgjigje përdëllyese dhe të bazuara në fakte çështjeve kyçe të debatit mbi abortin.



Kjo foto e vlerësuar me një çmim paraqet ndërhyrjen kirurgjikale për foshnjën Sara Mari Suitcer (Sarah Marie Switzer), 24-javëshe, e palindur, me anomalinë 'spina bifida' (lat. spina bifida, kurriz i ndarë, është një çrregullim i lindur, i shkaktuar nga mbyllja jo e plotë e tubit embrionik nervor). Sara, që në foto ka kapur gishtin e dorës së kirurgut, u vendos sërish në barkun e nënës së saj dhe lindi dy muaj më vonë, nëntë javë para kohe.



Një fotografi tridimensionale EKO-je e një foshnje, 21 javë pas ngjizjes – në gjysmë të shtatzënisë. Teknologjia moderne hap kështu një dritare për në mitër, që po ndryshon këndvështrimin e debatit mbi abortin.

OM EAST
Eternal Perspective Ministries
EPM

AL

Rendi Alkorn

# Pse Pro-Jetës?



Eternal Perspective Ministries
EPM

OM EAST

PSE PRO-JETËS?

Publikuar nga Shërbesat e Perspektivës së Brendshme, Inc.
© 2004 nga Shërbesat e Perspektivës së Brendshme
Numri Ndërkombëtar Standard i Librit: 1-59052-369-5
Citimet e Shkrimit janë marrë nga:
Bibla e Shenjtë, Versioni i Ri Ndërkombëtar
©1973, 1984 nga Shoqëria Biblike,
Multnomah është shenjë dalluese e Botuesve Multnomah, Inc.,
dhe është regjistruar në Zyrën e Markave Origjinale Dalluese të SHBA-së.
Colofoni është shenjë dalluese e Botuesve Multnomah, Inc.

TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA
Asnjë pjesë e këtij botimi nuk duhet riprodhuar, ruajtur, korrigjuar apo shpërndarë në asnjë lloj forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjuar, regjistruar apo edhe mënyrë tjetër, pa lejen paraprake me shkrim.

©2012 Eternal Perspective Ministries for the Albanian Edition.
This project is a joint project of Eternal Perspective Ministries and OM EAST.
All rights reserved.

Shtypur nga Vernon Publishing
Tiranë, Shqipëri 2012
Tirazhi: 5000 kopje

ISBN: 978-9928-104-33-5

"Me një stil të ngjeshur, por me një paraqitje të plotë të pozicionit pro-jetës, Rendi Alkorn sjell një burim të paçmueshëm për njerëzit me zemër të gjerë—shpesh gjuhëlidhur—për gjithë ata që janë pro jetës kudo që ndodhen."

***Frederika Methjues Grin***
*— Gazetare, komentuese dhe autore e librit*
*Zgjedhjet e vërteta: Duke dëgjuar gratë,*
*duke kërkuar alternativa para abortit.*

"Ky volum imponues thërrmon deri edhe stereotipet duke ndihmuar në shërimin e plagëve të konfliktit të brendshëm më urgjent të realitetit amerikan."

***Rabi Daniel Lapin*** *— President i Drejt Traditës, një koalicion kombëtar i hebrenjve dhe të krishterëve, autor dhe prezantues i një programi radiofonik.*

"Një rast imponues për çështjen më të rëndësishme të brezit tonë. S'munda ta lija thjesht mënjanë."

***Endi Stenli*** *— Komuniteti i Kishës Maja e Veriut*

"Gjithçka që mund t'i nevojitet dikujt. Të përmbledhura në një libër të hollë, gjenden përgjigjet imponuese të argumenteve më të zakonshme të zgjedhjes për jetën. Rendi Alkorn të sjell në kujtesë se të gjitha qeniet njerëzore meritojnë dinjitet, liri dhe të drejta të barabarta. Besoj se ky libër ka kapacitetin të hapë sytë dhe të ndryshojë zemrat e miliona njerëzve. Është libër i fuqishëm, që do të dëshironit t'ia dhuronit gjithkujt që njihni."

***Nensi Steford*** *— Aktore dhe autore e Mrekullia e Dashurisë së Tij dhe Bukuria e Librit*

"Për të ndryshuar kulturën tonë të sotme, nuk është e mjaftueshme të thuash që je pro jetës; duhet të shpjegosh pse je pro jetës. Ky libër përbën një burim të shkëlqyeshëm që bën pikërisht këtë gjë."

***Fr. Frenk Pavone*** *— Drejtor Kombëtar, Priftërinj për Jetën*
*President i Këshillit fetar kombëtar për Jetën*

"Një këndvështrim i menduar mirë përmes analizave të plota se përse mbrojtja e jetës njerëzore nuk është vetëm një pozicion i drejtë, por pozicioni i vetëm i drejtë që ne si shoqëri duhet të mbështesim. Besoj që mendjet do të ndryshojnë pasi ta lexojnë këtë libër."

***Kristen Day** — Drejtor Ekzekutiv, Demokratët për Jetën e Amerikës*

"Pse Pro–Jetës mbetet një burim i paçmueshëm për çdokënd, që kërkon të ndihmojë një mik apo një të afërm për të kuptuar këndvështrimin për jetën? Me një gjuhë të qartë dhe imponuese Rendi Alkorn parashtron çështjen për jetën duke përdorur njëkohësisht fuqinë e arsyes dhe ndjenjës."

***Çarls W. Kolson** — Vëllazëria në Burg, Uashington, DC*

"Një libër gjithëpërfshirës dhe imponues, i dokumentuar më së miri, veçanërisht kur lidhet me jetët e foshnjave tona në rrezik."

***Xhenifer O'Neill** — Aktore, autore dhe zëdhënëse e fushatës ndërgjegjësuese "Mjaft Heshtjes!"*

*Audri Stoutit, e cila kujdeset për*
*të sapolindurit dhe nënat*
*e tyre, dhe që u kujdes edhe*
*për nënën time kur ajo u shua nga*
*kanceri në vitin 1981.*
*Veprat e tua të mira nuk kanë për*
*t'u harruar nga ai Zot,*
*i cili shpërblen dorën e*
*gjithkujt që ofron ujin në emrin e Tij.*

# Falënderime. . .

...redaktorit tim dhe njëkohësisht edhe mikut tim të çmuar, Rod Morris, për dorën e fundit të dhënë materialit; Kethi Ramit, e cila ka bërë një punë të pashembullt me ngjeshjen e dorëshkrimit origjinal; si edhe Boni Histendit, që më ndihmoi me shtypjen e disa pjesëve përfundimtare të librit. U jam mirënjohës Brajën Smithit, Brent Runejt, Kristina Koulterit, Kimberli Brokut, dhe Brajën Thomasënit për asistencën e tyre në këtë projekt; gjithashtu Daug Gabertit për inkurajimin e tij. Faleminderit gruas sime, Nensit, Ronit dhe Kethi Norkistit, Xhenët Elbërsit, Linda Xhefrisit, si dhe Sherën Majzënhajmërit. Vlerësoj thellësisht çdonjërin prej jush për pjesëmarrjen e çmuar në këtë libër. Shumë falënderime shkojnë edhe për Gejli Etbërri, Lerri Gedbaf dhe Alis Grej, të cilët më dhanë informacion ndihmues në bocetin e parë.



# Pjesa I

# Parimet themelore

# I

## Pse të flasim për abortin?

Një përfaqësues i Lidhjes Kombëtare të Veprimit për të Drejtën e Abortit (LKVDA) foli në një klasë të shkollës së mesme mbi anët pozitive të abortit. Një prej nxënësve i kërkoi mësuesit nëse mund të paraqitesha edhe unë me prozicionin pro-jetës. Kur shkova një javë më vonë, instruktori i pro-zgjedhjes më tregoi që nxënësit e klasës së tij kishin votuar 23 me 1 në favor të pro-zgjedhjes.

U paraqita rastin e të drejtave të fëmijëve të palindur. U shfaqa foto të pamjes së brendshme të mitrës gjatë kohës së zhvillimit të një të palinduri në fazat e para, të ashtuquajtura të lejueshme për abortin.

Pas orës së mësimit, mësuesi më tha: “Nëse do të duhej të votonim sërish, rezultati do të kishte qenë i ndryshëm. Mendjet kanë ndryshuar.” Më pas, ai vuri në dukje diçka plotësisht me vend: “E di, nuk kisha dëgjuar kurrë më parë për pozicionin e pro-jetës.”

Krenohemi me veten, me mendjet tona të hapura dhe me mundësinë e një edukimi të drejtë dhe të orientuar drejt fakteve. Po ja ku paska mësues pesëdhjetë vjeçar me master shkencor, që *nuk kishte dëgjuar kurrë më parë mbi pozicionin pro-jetës*. Ai e kishte pranuar pa asnjë kritikë pozicionin pro-zgjedhjes të ofruar prej të tjerëve, po ashtu kishin bërë edhe nxënësit e tij.

## Tendenca befasuese

Jo shumë vjet më parë dukej sikur pozicioni pro-jetës po zhdukej si pjesë e kohërave të vjetra. Të rinjtë ishin aq të zhytur në relativizmin moral dhe tolerancën e orientuar nga shoqëria postmoderne sa dukej sikur po prireshin në mënyrë uniforme drejt pro-zgjedhjes. Por zhvillimi i fundëm befasues është se sot, më shumë të rinj, krahasuar me prindërit e tyre, e kundërshtojnë abortin.

Një vëzhgim i fundit i Gallupit me adoleshentët ka treguar se 72 për qind e të anketuarve besojnë që aborti është moralisht i gabuar. Vetëm 19 për qind besojnë se duhet të ligjërohet duke përfshirë të gjitha rrethanat, krahasuar me 26 për qind të të rriturve. Rreth 32 për qind e adoleshentëve, krahasuar me 17 për qind të të rriturve, mendojnë që aborti nuk duhet lejuar në asnjë rast.[1]

Ky fakt u konfirmua edhe nga një sondazh[2] kombëtar që pasoi, i dëshmuar edhe nga një numër i lartë pjesëmarrësish adoleshentë në Marshimin Kombëtar *"Në Emër të Jetës"*.[3] Në faqet e sotme të internetit, vajzat e reja inkurajohen gjerësisht të zgjedhin jetën.[4] Shumë të rinj refuzojnë të pranojnë kulturën bashkëkohore në mbrojtje të abortit.

Në *"Pse Pro-jetës?"* dua të paraqes arsye të dhimbshme të bazuara në fakte reale, të cilat shpjegojnë dhe i japin kuptim lëvizjes së kundërt me atë pro-zgjedhjes, drejt perspektivës pro-jetës.

## Çështja përcaktuese në epokën tonë

Aborti është ndërhyrja kirurgjike më e shpeshtë tek gratë në Amerikë. Një prej katër fëmijëve që konceptohet kirurgjikisht abortohet, ndërkohë që kryhet edhe një numër i panjohur abortesh me kimikate.[5] Meqenëse 50 për qind e shtatzënive janë të paplanifikuara, kjo do të thotë se gjysma e këtyre shtatzënive përfundojnë me aborte. Cdo vit në SHBA raportohen rreth 1.37 milionë aborte.[6] Rreth 43 për qind e grave në moshë për lindje fëmije kanë kryer ose do të kryejnë abort. Siç duket, çdo familje, është prekur në njëfarë mënyre nga aborti.

Pretendimet lidhur me këtë çështje janë jashtëzakonisht të larta. Nëse pozicioni i pro-zgjedhjes është i drejtë, atëherë liria për të zgjedhur abortin duhet të jetë e drejtë themelore civile. Por nëse pozicioni pro-jetës është i drejtë, atëherë 3,753 abortet e bëra çdo ditë në Amerikë përbëjnë më shumë jetë të humbura njerëzore, sesa jetët e humbura në tragjedinë e 11 Shtatorit 2001, në shkatërrimin e Qendrës Botërore Tregtare.

Aborti është "butoni i nxehtë". Vetë fjala abort të bën të përjetosh emocione të forta. Midis çështjeve që shkaktojnë emocione të forta tek njerëzit, aborti zë vendin e parë duke kryesuar mbi antisemitizmin, abuzimin me alkolin, çështjen e të pastrehëve, dënimin me vdekje, pornografinë dhe djegien e flamurit.[8]

Të dhënat nga një sondazh i fundit i Gallupit, tregojnë se 26 për qind e amerikanëve kanë bindje të forta pro-zgjedhjes, ndërkohë që 29 për qind kanë bindje të forta mbi pozicionin e kundërt, atë pro-jetës. Të marra së bashku, 55 për qind e amerikanëve kanë bindje të forta mbi abortin, duke u ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në besimin dhe bindjet e tyre mbi këtë çështje.[9]

Duke qenë se 45 për qind nuk janë të vendosur lidhur me qëndrimin e tyre mbi këtë çështje, ndërkohë që edhe të tjerë që më parë kanë patur bindje të forta, e kanë ndryshuar opinionin dhe besimin lidhur me këtë çështje, atëherë ka shumë mundësi që më shumë se gjysma e amerikanëve akoma mund të ndikohen në mënyrën e të menduarit mbi abortin.

## Një këndvështrim i krishterë

Disa lexues të krishterë tani mund të mendojnë: "Ky libër nuk është për ne, por për ata jobesimtarë, që kryejnë abort." Në fakt, 43 për qind e grave që bëjnë abort e identifikojnë veten si protestante dhe 27 përqind si katolike. E pra, dy të tretat e aborteve në Amerikë kryhen nga gra me një prejardhje të krishterë. 18 për qind e të gjitha aborteve në SHBA kryhen nga gra, që e kanë identifikuar veten si të rilindura ose të krishtera ungjillore.[10] Kjo përbën përafërsisht një çerek milion aborte për çdo vit që ndodhin në kishat me themel të fortë në Biblën.

Çështja e abortit nuk ka të bëjë me nevojën e kishës për t'i folur botës, por me nevojën për t'i folur në fillim vetvetes dhe më *pas* botës.

Edhe pse vetë jam besimtar i krishterë, nuk e kam menduar këtë libër si një mënyrë për të parashtruar argumentet nga Bibla (Këtë e kam bërë diku tjetër.[11]) Ajo që paraqes këtu është bazuar në shkencën e mjekësisë dhe studime serioze psikologjike. Këto burime duhet të jenë po aq të besueshme sa çdo e vërtetë tjetër për të krishterët. Në të vërtetë, shumë jo të krishterë e kundërshtojnë abortin.

Personalisht besoj fuqishëm në të drejtat e grave. Kam respekt të thellë për gruan dhe vajzat e mia, të cilat i kemi rritur të kenë respekt për veten dhe të jenë mirënjohëse ndaj Perëndisë që i ka krijuar gra. Këtu nuk kam ndër mend të pakësoj traumën që kanë kaluar gra të ndryshme pas vendimit që kanë marrë për të abortuar. Askush nuk e kupton vuajtjen si Jezus Krishti, i cili është plot mirësi dhe të vërtetë. Kapitulli i 18, që flet për gjetjen e faljes nga Perëndia, është ai për të cilin kam nevojë edhe unë po aq sa çdokush tjetër.

Ky libër paraqet fakte dhe arsyetim, të shoqëruar me hir dhe dhembshuri, që do të na ndihmojë të rrënjosim besimet tona në këtë realitet.

## Kërkesa ime për ju lexues

Nëse je një person i bindur ndaj lëvizjes pro-zgjedhjes dhe po lexon librin "Pse Pro-jetës?" atëherë edhe më mirë. Shpresoj që kjo të tregojë që je person me mendje të hapur. Nëse pikëpamja pro-jetës provon të jetë po aq pakuptim dhe e paarsyeshme siç edhe ke besuar që në fillim, në rregull, le të jesh ti i pari që bën refuzimin e parë meritues. Por, nëse provohet e kundërta, atëherë të nxis të mendohesh edhe njëherë për atë që ke zgjedhur.

Nëse je akoma i paqartë dhe i pavendosur në bindjen tënde, thjesht të kërkoj ta bësh këtë libër pjesë të kërkimit tënd mbi të vërtetën. Mund të gjesh kudo informacionin mbi pro-zgjedhjen, mjafton të ndezësh televizorin apo të lexosh një gazetë. Por ky libër mund të jetë mundësia e vetme, që po të jepet për të analizuar dhe kuptuar prozicionin e pro-jetës.

Nëse je pro-jetës, është mirë të mendosh thellë mbi pozicionin e zgjedhur. Nuk mjafton të thuash; “E di që kam të drejtë, por nuk jam i sigurt përse.” Ne duhet ta bazojmë bindjen tonë mbi fakte. Nëse jemi gabim, qoftë edhe në ndonjë pikë, le të rishikojmë në çdo mënyrë të mundshme qëndrimin tonë Nëse kemi të drejtë, atëherë duhet të mësojmë si t’i ndërgjegjësojmë me mirësi dhe zgjuarsi të tjerët.

Një gjë është e sigurt: nëse aborti vërtet i vret fëmijët dhe dëmton gratë, atëherë çmimi për tu paguar është shumë i lartë që të qëndrojmë mënjanë pa bërë asgjë.

# 2

## Pro-Gruas, apo Pro-Fëmijës?

Unë dhe gruaja ime u përfshimë me aktivitetin pro-jetës të nxitur nga shqetësimi ndaj grave që ishin shkatërruar nga aborti. Në vitin 198, hapëm dyert e shtëpisë dhe mikpritëm një vajzë adoleshente shtatzënë. Unë kam shërbyer në bordin e një prej qendrave të para të shtatzënisë në Bregun Perëndimor, që u ofronte ndihmë grave shtatzëna të cilat ishin në nevojë, konfuze dhe të dëshpëruara. Objektivi ynë ishte t'i ndihmonim këto gra me çdo mënyrë të mundur. Dhe mënyra më e mirë për t'i ndihmuar këto gra, ishte t'u ofroje alternativa të tjera përveç abortit. Ndërsa koha kalonte, u bëra pjesë e edukimit pro-jetës, veprimit politik dhe ndërhyrjes jo të dhunshme jashtë klinikave të abortit. Disa shërbesa të pro-jetës përqendrohen më shumë në shpëtimin e fëmijëve të palindur, të tjera në ndihmën ndaj grave shtatzëna. Unë i konsideroj të dy llojet e përpjekjeve si jetësore, të nevojshme dhe tërësisht të pajtueshme me njëra tjetrën.

## Lëvizja që mund të mos e njihni

Mite të panumërta i janë bashkëngjitur lëvizjes pro-jetës. Një shembull i tillë është deklarata e shumë përfolur: "Përkrahësit e pro-jetës nuk duan t'ia dinë për gruan shtatzënë apo për fëmijën pasi lind." Një reportere televizive mu afrua gjatë një aktiviteti pro-jetës dhe, me kamerat që po xhironin, më kërkoi një përgjigje lidhur me këtë akuzë. "Epo, unë dhe gruaja ime mikpritëm në

shtëpi një vajzë shtatzënë dhe paguam për shpenzimet e saj për të gjithë kohën që ajo qëndroi me ne. Ne e mbështetëm kur ajo vendosi të jepte fëmijën e vet për birësim. Dhe, meqënëse pyetët, ne vazhdojmë të japim një shumë të konsiderueshme nga të ardhurat tona për të ndihmuar gratë dhe fëmijët e varfër."

Pastaj e prezantova reporteren me një mikun tim pastor që po qëndronte pranë meje, i cili së bashku me gruan e tij, ka adoptuar nëntëmbëdhjetë fëmijë, disa prej tyre me sindromën Daun dhe fëmijë të tjerë me nevoja specifike. Reporterja ia bëri me shenjë kameramanit të ndërpriste xhirimin. E pyeta nëse dëshironte të intervistonte mikun tim, por ajo thjesht mohoi me kokë dhe u largua.

Fakti është ky: "Mijëra organizata pro-jetës në mbarë vendin dhe kudo nëpër botë ofrojnë teste shtatëzanie falas, ekografi me ultratinguj, këshillim, grupe mbështetje, mësime për kujdesin ndaj fëmijëve, trajnime mbi menaxhimin financiar, ndihmë materiale me pelena dhe veshje për fëmijë, si edhe strehim. Shto këtu dhjetra mijëra kisha që dhurojnë kohën e tyre, para, ushqime, kryejnë riparime të ndryshme në shtëpi, dhe ofrojnë çdo lloj ndihme tjetër për gratë shtatzëna në nevojë, nënat e vetme dhe familjet me të ardhura të pakta. Një numër i konsiderueshëm ndjekës të pro-jetës birësojnë fëmijë, hapin shtëpitë e tyre dhe japin ndihmë vullnetare pas lindjes së fëmijëve. Të gjitha këto përpjekje përbëjnë lëvizjen e vetme themelore, por më të madhen në histori.

Ndërsa ata që ofrojnë alternativën e abortit gjithashtu i tarifojnë gratë për këtë veprim, ata që ofrojnë alternativat e tjera, përveç abortit, u ofrojnë këtyre grave asistencën e tyre falas, me dashuri dhe pothuajse tërësisht pa dalë në skenë. Në kundërshtim me disa karikatura, këta njerëz janë jo vetëm pro-lindjes—njerëz nuk janë thjesht pro-lindjes—ata janë pro-*trajtimit*. Ata kujdesen për fëmijën dhe nënën, duke u gjendur përherë aty për t'i ndihmuar të dy, jo vetëm para lindjes, por edhe pas saj.

## Skizofrenia jonë kombëtare

Pavarësisht kësaj ndarjeje gati të barabartë midis atyre, që e quajnë veten pro-zgjedhjes dhe të tjerëve pro-jetës, dy të tretat e

amerikanëve thonë se besojnë që aborti është diçka "moralisht e gabuar"[1] Disa përkrahës të çështjes pro-jetës e interpretuan këtë si një fakt që tregon se nuk është më e nevojshme të debatojmë nëse i palinduri është njeri apo nëse aborti është i gabuar. Në vend të këtij debati, ne duhet të vëmë theksin në ndihmën ndaj grave, në mënyrë që ato të kuptojnë se aborti nuk është në të mirë të tyre.

Bie dakord pa asnjë kundërshtim se duhen ndihmuar gratë me shtatzëni të padëshiruar dhe se aborti nuk do t'i ndihmojë, por do t'i lëndojë më shumë. Shumë gra besojnë se aborti është i gabuar, por kjo është e keqja më e vogël—megjithëse e tmerrshme, sepse ato sërish mendojnë se aborti është një alternativë tjetër përveç lindjes së një fëmije, rritjes së tij/saj, apo dhënies së fëmijës për birësim.[2]

Duhet t'u hapim sytë se, nëse alternativat e tjera duken shumë të vështira, aborti vret një person të pafajshëm. Dhe pikërisht për këtë arsye, sjell dhe pasojat më negative në jetën e një gruaje.

Gjithsesi, shumë prej atyre që besojnë se fëmijët ende të palindur janë qenie njerëzore dhe se aborti është imoral, zgjedhin të bëjnë abort dhe ta mbrojnë atë si diçka të ligjshme. Kjo tregon se këta njerëz nuk besojnë që një fëmijë i palindur është qenie njerëzore po aq sa një fëmijë tre vjeçar. Ata nuk besojnë se aborti është i pamoralshëm njëlloj sikur vrasja e një tre vjeçari është e pamoralshme.

Sondazhet tregojnë se shumë prej njerëzve që besonë se aborti është imoral, besojnë njëkohësisht se aborti duhet të qëndrojë i ligjshëm. Është me vend të pranohet që këta njerëz besojnë se përdhunimi, rrëmbimi, abuzimi ndaj fëmijëve dhe vrasja janë të pamoralshme, por ata *nuk* do të argumentonin mbi faktin nëse përdhunimi dhe vrasja duhet të ligjërohen. Ka një ndryshim thelbësor në mënyrën se si e shohin këta njerëz *përdhunimin* ose *vrasjen* si të "pamoralshme" dhe *abortin* si të "pamoralshëm".

Asnjë person, i cili e konsideron fëmijën akoma të palindur si një person plotësisht të zhvilluar, nuk mund të mbrojë në mënyrë të arsyeshme ligjshmërinë e abortit, vetëm nëse mbron gjithashtu ligjshmërinë e vrasjes së personave të tjerë, sepse çdo argument pro abortit që nxjerr në pah mundimet e një nëne, stresin dhe

vështirësitë financiare për të mbajtur një fëmijë, mund të përdoret po aq bindshëm për fëmijën e saj 12 vjeçar, bashkëshortin ose prindërit e saj. Në shumë raste, fëmijët e rritur janë *më shumë* të kushtueshëm dhe kërkojnë më shumë përkushtim nga nëna e tyre sesa një fëmijë i palindur akoma. Por, njerëzit menjëherë kuptojnë se këto argumenta janë krejtësisht të pavlefshme kur vjen puna tek vrasja e fëmijëve të tyre të rritur.

Shpesh, gratë kanë pohuar se kur kanë bërë abort s'e kanë pasur aspak idenë se çfarë kishin brenda vetes. Disa e e dinin në mënyrë të nënvetëdijshme se po mbanin një fëmijë brenda tyre, por e mbyllën veten brenda retorikës çnjerëzore pro-zgjedhjes. Sot ato gra, thellësisht pendohen për zgjedhjen e tyre. Ato e shikojnë veprimin e tyre si një çmenduri të momentit që u mundësua me *qëllimin e mirë* por tërësisht të gabuar të miqve apo familjes së tyre. Ato do të donin që dikush t'i kishte bindur për të mos bërë një zgjedhje që tashmë i përndjek nga pas çdo kohë.

Duhet t'i duam dhe të kujdesemi për gratë, që janë nën presionin e abortit. Ashtu siç duhet t'i duam po njësoj gratë që kanë kryer më parë abort dhe të bëjmë sa mundemi që t'i ndihmojmë për t'u shëruar prej traumës që shkakton.

Libri i lashtë i Fjalëve të Urta thotë se zgjedhja e drejtë është përherë e urtë dhe sjell pasoja të mira, ndërsa zgjedhja e gabuar është përherë marrëzi dhe sjell me vete pasoja të këqija.

## Ndarja e Rremë

Vrasja e një fëmije nuk është në të mirën e askujt. Kur një fëmijë lëndohet nga nëna e vet, nuk lëndohet vetëm fëmija por edhe vetë nëna. Është e pamundur të ndash mirëqenien e një nëne nga ajo e fëmijës së saj. Pikërisht sepse i palinduri është një fëmijë, pasojat e vrasjes së tij mbeten tepër serioze. Dhe është pikërisht identiteti i viktimës së parë, fëmijës, që sjell dëme tek viktima e dytë, nëna e fëmijës. Kjo është arsyeja pse nevojitet të fillojmë trajtimin e abortit me identitetin e fëmijës së palindur akoma.

# Pjesa 2



## *Fëmija*

# 3

# A është vërtet i palinduri një qenie njerëzore?

Përkrahësit pro-zgjedhjes në të shkuarën deklaronin se: “Nuk është e sigurt kur fillon jeta njerëzore; kjo është një çështje fetare, që nuk mund të marrë përgjigje përmes shkencës.” Shumë e kanë braktisur këtë bindje për shkak të kontradiktave të evidentuara nëpër dekada nga vetë shkenca. Gjithsesi, ky besim i dalë mode, është i rrënjosur aq thellë në mendësinë tonë kombëtare, saqë akoma dhe sot besohet gjerësisht nga njerëzit.

Logjika pro-zgjedhjes do të mund të mbizotëronte nëse njerëzit do të besonin se fëmijët e palindur nuk janë një qenie e plotë njerëzore.

Por a janë të tillë?

## Çfarë thotë shkenca

Dr. Alfred M. Bonxhoani, profesor i obstetrikës në universitin e Pensilvanisë, deklaron: “Kam mësuar që prej shkollimit të hershëm mjekësor se jeta njerëzore fillon që me ngjizjen... jeta njerëzore është e pranishme gjatë gjithë këtij rendi prej ngjizjes deri në moshë madhore... çdo ndërprerjeje në çfarëdo pike të këtij rendi përbën fundin e jetës njerëzore.”

Duke folur për fazat e para të zhvillimit të fëmijës në mitër, profesor Bonxhoani thotë: “Nuk jam aspak i përgatitur për të pohuar që këto faza të para paraqesin një qenie njerëzore të paplotë, do të ishte njësoj si të thosha se fëmija, para efekteve

dramatike të moshës së pubertetit nuk është ende qenie njerëzore. Kjo është jeta njerëzore në çdo fazë të saj."[1]

Dr. Zherome Lë Zhën, profesor i gjenetikës në Universitetin e Deskartës në Paris, deklaron: "Pasi është bërë fekondimi, një qenie e re njerëzore ka filluar të ekzistojë". Ai ka pohuar edhe se: "Nuk është më një çështje shijesh apo opinioni. Çdo individ ka një fillesë të rregullt që në ngjizjen e tij."[2]

Profesor Mishelin Methjus-Roth i Universitetit të Harvardit, Departamenti i Shkollës Mjekësore, thotë: " Është shkencërisht e saktë të pohosh që jeta njerëzore e një individi fillon që me ngjizjen".[3]

Momenti i krijimit për çdo person është momenti i ngjizjes. Para këtij momenti individi (me ADN-në e vet unike) nuk ka ekzistuar. Vetëm që prej këtij momenti ai ekziston.

Nuk janë vetëm përkrahësit e pro-jetës ata që e besojnë këtë. Pronari i klinikës më të madhe për abortin në Oregon dëshmoi nën betim: "*Sigurisht* jeta njerëzore fillon që me ngjizjen."[4] Libri fitues "*Prej Ngjizjes deri në Lindje*" dokumenton fillesën e fëmijës në ngjizje dhe zhvillimin e tij deri në lindje.[5]

Sa e qartë është prova që jeta njerëzore fillon që në ngjizje? Është aq e qartë sa Asambleja e Përgjithshme e Misurit aprovoi në mënyrë të jashtëzakonshme në vitin 2003 projektligjin, i cili thotë "Asambleja e përgjithshme e këtij shteti konstaton se: (1) Jeta e çdo qenie njerëzore fillon me ngjizjen; (2) Fëmijët e palindur kanë interesa për t'u mbrojtur për jetën, shëndetin dhe mirëqenien... Termi 'fëmijë i palindur' ose fëmijë të palindur' përfshin të gjithë fëmijët e palindur ose pasardhësit e qenieve njerëzore prej momentit të ngjizje deri në lindje, në çdo fazë të zhvillimit të tyre biologjik."[6]

## I ndërlikuar dhe njerëzor

Veza e fekonduar përmban një sasi të konsiderueshme informacioni gjenetik, e mjaftueshme për të kontrolluar rritjen e individit dhe zhvillimin e tij përgjatë gjithë jetës. Vetëm një fije ADN-je e marrë nga qeliza njerëzore përmban informacion të barazvlefshëm me një bibliotekë me një mijë volume librash.[7]

Qelizat e individit të ri ndahen dhe shumëfishohen me shpejtësi, duke rezultuar në një zhvillim fenomenal. Dhe ky zhvillim ndodh, sepse ka jetë. Shumë më parë se një grua të dijë që është shtatzënë, ka një jetë brenda saj, një qenie njerëzore që po rritet.

Midis ditës së pestë dhe të nëntë pas ngjizjes, personi i ri i përgatit vetvetes një strofull brenda mitrës për të qenë i sigurt dhe për t'u ushqyer. Në këtë fazë, gjinia e tij ose e saj mund të përcaktohet në mënyrë shkencore. Prej ditës së katërmbëdhjetë, fëmija prodhon një hormon, që ndalon periudhën menstruale të nënës. Do të duhen edhe dy javë derisa veçoritë njerëzore të bëhen të dukshme dhe tri javë më shumë për t'u bërë të dallueshme. Megjithatë, ai është një anëtar tërësisht i plotë i racës njerëzore.

Eshtë e vështirë ta konsiderosh të palindurin qenie njerëzore në momentin e ngjizjes, sepse ne jemi të prirur ta gjykojmë tjetrin nga dukja e jashtme, nga ajo çka na shohin sytë. Megjithatë, në kuptimin e objektivit shkencor, ai është po aq njerëzor, sa edhe çdo fëmijë tjetër i lindur apo i rritur. Ai duket një qenie njerëzore për shkak të fazës së zhvillimit.

Në ditën e tetëmbëdhjetë pas ngjizjes është formuar zemra dhe kanë filluar të zhvillohen sytë. Në ditën e njëzet e një, zemra nis të qarkullojë gjakun në gjithë trupin e tij. Në ditën e njëzet e tetë nisin të marrin formë këmbët dhe duart. Prej ditës së tridhjetë është formuar truri, që rritet me shpejtësi duke u shumëfishuar në masë dhjetë mijë herë.

Prej ditës së tridhjetë e pestë goja, veshët dhe hunda kanë filluar të marrin formë. Në ditën e dyzetë valët e trurit dhe rrahjet e zemrës (që ka nisur vetëm tri javë më parë) së bebes së palindur mund të regjistrohen dhe të dëgjohen përmes një stetoskopi me ultratinguj. Në ditën e dyzet e dytë struktura e tij skeletore është formuar dhe truri kontrollon lëvizjen e muskujve dhe të organeve.

S'ka rëndësi si duket ai apo ajo, fëmija është fëmijë. Dhe gjithmonë, aborti i jep fund jetës së fëmijës. Edhe mënyrat më të hershme për të bërë abortin, duke përfshirë Mifepristone (RU-486) dhe çdo lloj pilule janë tepër të vona për të shmangur marrjen dhe dhënien fund të një jete.

## Drama e jetës

Fotografi i famshëm i mitrës, Lenar Nilson, është i mirënjohur për esenë e tij fotografike në revistën "*Life*" *(Jeta)* dhe librin e tij *"Një fëmijë është lindur"*. Në esenë e tij "Drama e jetës para lindjes", ai pohon këtë në lidhje me një fëmijë të palindur në fazën e ditës së dyzet e pestë pas ngjizjes (para se shumë gra të dinë që janë shtatzëna): "Ndonëse embrioni peshon më pak se 1 gram, ai përmban të gjitha organet e brendshme të një të rrituri në fazat e ndryshme të zhvillimit. Sepse ka një gojë të vogël me buzë, një gjuhë në zhvillim dhe sythat e 20 dhëmbëve të ardhshëm të qumështit. Organet e tij riprodhuese sa kanë filluar të formohen."[8]

Në javën e tetë, duart dhe këmbët janë pothuajse të krijuara në mënyrë të përsosur. Në javën e nëntë, fëmija mund të përkulë gishtat rreth një objekti të vënë në pëllëmbën e tij. Janë duke u formuar thonjtë e gishtave dhe fëmija nis të thithë gishtin e madh të dorës. Në javën e tij të nëntë bebja "ka përsosur kapërdimjet, rrotullimet mbrapsht brenda mitres dhe ka filluar të godasë."[9]

I palinduri tanimë mund të reagojë dhe mund të jetë i aftë të ndjejë dhimbje.[10] Dhe përsëri abortet për fëmijët në këtë fazë janë quajtur "aborte të hershme."

Në javën e dhjetë, fëmija picëron sytë, gëlltitet dhe shfryn. Në javën e njëmbëdhjetë urinon, bën një numër të konsiderueshëm shprehjesh në fytyrë, madje edhe qesh.[11] Në javën e dymbëdhjetë, fëmija godet, rrotullon këmbët, mbledh dhe lëshon gishtat e këmbës, bën dorën grusht, lëviz gishtat e mëdhenj të dorës, përkul kyçin e dorës dhe hap gojën.[12]

E gjithë kjo ndodh në tremujorin e parë të jetës së tij. Në gjashtë muajt e ardhshëm, në mitër nuk zhvillohet asgjë e re. Fëmija i plotë i pacenuar vetëm sa rritet dhe maturohet—veç nëse jeta e tij humbet nga dështime të rastësishme ose përmes abortit.

Është fakt i padiskutueshëm shkencor, që çdo ndërhyrje kirurgjikale për abort në Amerikë ndalon rrahjet e një zemre dhe shuan valët e matshme të një truri.

# SAJA

Skot Klazëndorfi thotë: "Përgjigjja e pyetjes 'Çfarë është kjo?' u bën jehonë gjithë gjykimeve të tjera."[13] Ai vë në dukje se ka vetëm katër ndryshime midis fëmijës së palindur dhe atij të sapolindur. Ato mund të mbahen mend përmes akronimit SAJA,[14] të cilin shkurtimisht e përmbledh:

*Struktura e trupit:* A e përcakton struktura trupore faktin se kush je ti?

*Ambienti*: A të bën qëndrimi në shtëpi më shumë apo më pak njerëzor se qëndrimi jashtë shtëpisë? A e bën qëndrimi në trupin e nënës më pak njerëzor një fëmijë krahasuar me atë që jeton jashtë tij?

*Jashtë zhvillimit:* A janë njëzet vjeçarët më shumë njerëzorë se tetëvjeçarët, meqenëse janë më të zgjuar dhe më të fortë?

*Aspekti i varësisë:* Mos ndoshta varësia nga dikush tjetër e përcakton faktin se kush je? A mund të jetë dikush që vuan nga Alzeimeri apo nga dializa e veshkave më pak njerëzor? A jam unë, një diabetik i varur nga insulina, tani më pak njerëzor se atëherë kur nuk e kisha këtë varësi?

Një fëmijë tre muajsh është shumë më i vogël se ai dhjetë vjeçar, shumë më pak i zhvilluar dhe po aq i paaftë për t'u kujdesur për veten sa një foshnjë e palindur.

Çështja nuk është se sa i madh, i pjekur, i zgjuar apo i papërshtatshëm është një i palindur, por *kush* është ai.

Përgjigjja është e thjeshtë—ai është një qenie njerëzore.

# 4

## Cili është ndryshimi midis vezës, spermës, embrionit dhe fetusit?

Dy vjet më parë, kur aborti u ligjërua në Amerikë, një nga përkrahësit e pro-zgjedhjes i udhëzonte infermieret në një revistë të mirënjohur mjekësore, se "Përmes ndërgjegjësimit të publikut, mënyrës së komunikimit, koncepteve dhe ligjeve, ideja e abortit mund të shkëputet nga ideja e vrasjes."[1] Po të njëjtin vit në një simpozium në Los Anxhelos u ofrua ky trajnim: "Nëse u thua *(grave shtatzëna)*, 'nxirre jashtë beben' mund të krijosh lehtësisht ose të përshkallëzosh më tej traumën, ndaj është më mirë t'u thuash 'boshatis mitrën' ose 'do të gërvishim pak pjesën e brendshme të mitrës', por asnjëherë 'do të gërvishim beben.'"[2]

Gjuha nuk është thjesht shprehja e mendjes, por modeluesi i saj. Përdorimi i fjalëve ndikon perceptimin tonë mbi një ide—madje edhe atë ide që e komunikuar në terma të drejtpërdrejtë, do të ishte e neveritshme.

Fjalët që fokusohen vetëm në shtatzëninë dhe mitrën e heqin vëmendjen nga personi që jeton në të. Dhe s'ka rëndësi se si thuhet, 'boshatisja e mitrës' apo "përfundimi i shtatzënisë", të dyja marrin një jetë njerëzore.

Një feminist pro-jetës ka thënë: "Përkrahësit e pro-jetës nuk janë kundër dhënies fund të shtatzënisë. Shtatzënitë duhet të zgjasin vetëm për njëfarë kohe. Ne jemi pro përfundimit të shtatzënisë në muajin e nëntë. Protesta jonë është kundër vrasjes së fëmijëve."[3]

## Çfarë do të thotë fetus?

Ashtu si termat *fëmija* dhe *adoleshenti*, termat *embrion* dhe fetus nuk u referohen qenieve jonjerëzore, por atyre njerëzore në faza të caktuara të zhvillimit. *Fetus* është një fjalë latine e përkthyer në disa kuptime, si: "pjellë", "i ri" ose "vogëlush".

Është shkencërisht e gabuar të thuhet se një embrion njerëzor ose një fetus nuk është qenie njerëzore vetëm se është në fazën më të hershme të zhvillimit të një fëmije. Kjo është njësoj sikur të thuash që një fëmijë nuk është njeri, sepse nuk është ende adoleshent. Njëra prej vajzave të mia është dy vjet më e madhe se tjetra. A do të thotë që është dy vjet më e mirë? A mos vallë bëhesh më njerëzor ndërsa rritesh? Nëse është kështu, atëherë të rriturit janë më njerëzorë se fëmijët dhe futbollistët janë më njerëzorë se ngarësit e kuajve. Diçka jo njerëzore nuk mund të bëhet njerëzore duke u rritur apo duke u pjekur; çfarëdo që është njerëzore është e tillë që prej fillimit.

## A është veza ose sperma qenie njerëzore?

Karl Segëni vë në lojë kundërshtarët e abortit duke pyetur: "Pse nuk mund të quhet vrasje shkatërrimi i një veze apo sperme?"[4] Përgjigjja, ashtu si çdo shkencëtar do ta dinte, është se ka një ndryshim thelbësor midis spermës dhe vezës së fekonduar në njërën anë dhe vezës së fekonduar dhe zigotës në anën tjetër.

Ashtu si qelizat e flokëve apo zemrës së dikujt, as veza dhe as sperma nuk kanë kapacitetin për t'u bërë ndryshe nga ç'janë. Por kur veza dhe sperma bashkohen, atëherë fillon një jetë e re njerëzore, dinamike dhe gjenetikisht unike. Kjo jetë nuk është as spermë dhe as vezë dhe as një kombinim i thjeshtë i të dyjave. Një vezë e fekonduar është rishtas një qenie njerëzore e krijuar. Pra është një person, me një jetë të vetën, në një ritëm të shpejtuar dhe vetë-adresuar zhvillimi.

Që prej çastit të fekondimit, kjo qelizë e vetme përmban gjurmën e plotë gjenetike në gjithë kompleksitetin e saj. Kjo shpjegon çdo detaj të zhvillimit njerëzor duke përfshirë gjininë e

fëmijës, flokët, ngjyrën e syve, gjatësinë dhe ngjyrën e lëkurës.[5] Merre këtë qelizë të vetme të zigotës së sapokrijuar, vendose në një qelizë shimpanzeje dhe "një gjenetist do ta identifikonte lehtësisht si qenie njerëzore. Cilësia njerëzore është mrekullisht e dukshme."[6]

Produkti i ngjizjes, (POC/PIK), është një depersonalizim i zakonshëm i një fëmije të palindur. Realisht një foshnjë, një fëmijë dhjetë vjeçar apo një i rritur nuk janë as më shumë as mëpak "produkt i ngjizjes", sesa një fetus. Ashtu si prodhimi i ngjizjes të një kali është një kalë, po kështu produkti i ngjizjes njerëzore është gjithmonë një njeri.

Debati mbi qelizat burimore të bërthamës së embrionit është shembull i aftësisë kuptimore. Qelizat burimore janë qeliza të gjithanshme udhëzuese, prej ku zhvillohen një shumëllojshmëri indesh dhe organesh. Të konsideruara si "material parësor" për kërkime biomjekësore, ato janë të disponueshme dhe merren nga burime njerëzore beninje (të shëndetshme), nga individë të rritur (me miratimin e tyre paraprak), nga gjaku në kordonin umbilikal dhe placenta. Por shumë shkencëtarë zgjedhin të përdorin për eksperimente bërthamën e qelizave burimore të marra nga embrioni i bebeve njerëzore, të cilët e humbin jetën në këtë "korrje". Ky debat etik sjell implikime serioze mbi mënyrën si i konsiderojmë qeniet njerëzore, dhe nëse ata janë sakrificë e nevojshme që t'u shërbejnë të tjerëve.[7]

Interesante është që Instituti Kombëtar i Shëndetit zbuloi se publiku po reagonte kundër "kërkimit të bërthamës së qelizës burimore embrionale" duke shkatërruar kështu embrione njerëzore përmes eksperimentimit. Kështu që IKSH-ja zgjodhi një term të ri për të përshkruar ekzaktësisht të njëjtën gjë: "Kërkimi për bërthamën pluripotente të qelizës burimore njerëzore". Ky term i ri vetëm sa maskon realitetin që embrionet njerëzore bëhen objekt i eksperimentimit.[8] Në vend që t'i jepet fund kësaj procedure të pamoralshme, ata thjesht i dhanë një emër tjetër të ri.

# Pa dyshime

Nëse klonimi njerëzor rezulton i suksesshëm, kjo do të thotë se një person mund të ndërhyjë në vazhdimin e jetës në një çast pas ngjizjes. Kjo s'do ta ndryshonte aspak statusin e tyre njerëzor. Çështja qëndron në praninë e një personi tjetër njerëzor në vazhdimin e jetës njerëzore, dhe jo mënyra si arriti aty.

Dr. Tomas Hilgers deklaron, "Asnjë trup i gjallë individual nuk mund të 'bëhet' një person, vetëm nëse është tashmë i tillë. Një qenie e gjallë nuk mund të bëhet asgjë tjetër përveçse ajo qenie që është në thelb tashmë."[9]

Ofruesit e abortit janë bërë më të drejtpërdrejtë në pranimin e asaj që ndodh gjatë një aborti. Dr. Uorren Herni, i cili mëson doktorët si të kryejnë aborte, e përshkruan kështu punën e tij:

> E kam filluar punën time me abortin me një vajzë të re, e cila ishte 17 javëshe shtatzënë... Futa pincën në uterus dhe i përdora duke filluar me kokën e fetusit, i cili ishte ende gjallë, meqë injektimi fetal nuk mund të bëhet në këtë fazë të shtatzënisë. Shtrëngova pincën duke e mbyllur ndërsa shtypa kafkën e fetusit dhe e tërhoqa jashtë. Fetusi, tashmë i vdekur, rrëshqiti jashtë pak a shumë i padëmtuar.[10]

Ky njeri, i cili ia ka kushtuar jetën e tij kryerjes së aborteve dhe mësimit të të tjerëve si ta bëjnë një gjë të tillë, nuk ka absolutisht asnjë dyshim, që aborti vret një fëmijë.

A do të dish diçka që ky njeri nuk e di?

# 5

## A është i palinduri pjesë e trupit të gruas?

Ashtu si shumë të tjerë, filozofi Mortimer Adler deklaron se i palinduri është "një pjesë e trupit të nënës, në të njëjtin kuptim si krahu apo këmba e një individi është pjesë e organizmit të gjallë. Vendimi i individit për të pasur një krah apo këmbë të prerë ka të bëjë me sferën e privatësisë—lirinë për të bërë atë që dikush do të bëjë brenda kufirit për të mos dëmtuar të tjerët apo mirëqenien shoqërore."[1]

### E *vërtetë apo e rreme?*

Një pjesë e trupit përcaktohet nga i njëjti kod gjenetik, që kanë edhe pjesët e tjera të trupit. Çdo qelizë e bajameve të nënës, zemrës, apendicitit dhe mushkërive kanë të njëjtin kod gjenetik. Edhe fëmija i palindur ka një kod gjenetik, por është dukshëm ndryshe nga ai i nënës. Çdo qelizë e trupit të tij është unike e tij, çdonjëra prej tyre e ndryshme nga qelizat e trupit të nënës së tij. Shpesh edhe tipi i gjakut të tij është i ndryshëm dhe në gjysmën e rasteve edhe gjinia po ashtu.

Nëse trupi i gruas do të ishte i vetmi që përfshihet në një shtatzëni, atëherë mendoni pak sa gjymtyrë duhet të ketë trupi i saj—dy hundë, katër këmbë, dy palë gjurmë gishtash, dy tru, dy sisteme qarkullimi dhe dy sisteme skeletesh. Gjysmën e rasteve, ajo mund të ketë edhe organe gjenitale mashkullore. Nëse është e pamundur

që një grua të ketë organe gjenitale mashkullore, atëherë fëmija mashkull që ajo mban brenda vetes nuk është pjesë e trupit të saj.

Një zigotë kineze e transplantuar në mitrën e një gruaje suedeze do të jetë gjithmonë kineze dhe jo suedeze, sepse identiteti i saj është bazuar në kodin gjenetik dhe jo në trupin ku jeton.

Një fëmijë mund të vdesë dhe nëna të jetojë, ashtu si edhe e kundërta, një nënë mund të vdesë dhe një fëmijë të jetojë, duke provuar kështu që ata të dy janë individë të veçantë.[2]

Në operacionet e paralindjes, fëmija i palindur, ende i lidhur me nënën me kordonin umbilikal, largohet, i jepet anestezi dhe rifutet në mitrën e nënës. Fëmija në këtë rast quhet pacient i operuar dhe ka të dhënat e veta mjekësore, ku shënohen grupi i gjakut dhe shenjat jetësore.

Në vitin 1999, një fëmijë i palindur i quajtur Samuel Armas, u operua për një *spina bifida/shpinë e ndarë*. Fotoja e tij e publikuar në revistën *"Jeta"* tërhoqi vëmendjen e të gjithë botës. Ndërsa kirurgu po bënte mbylljen, bebja Samuel nxori dorën jashtë barkut dhe i kapi gishtin kirurgut. Fotoreporteri Majkëll Klensi e kapi këtë veprim të habitshëm përmes shkrepjes fotografike. (Shih një shembull të ngjashëm, foton fituese në revistën *Jeta* të bebes së palindur, Sara Mari Suicër në pjesën e pasme të librit.) Klensi njoftonte, "Papritmas, një krah i plotë shtyu pjesën që po mbyllej, u kthye mbrapsht dhe ja ku u duk një dorë e vockël. Doktori e kapi dorën dhe e ngriti, e cila reagoi duke shtrënguar gishtin e tij. Sikur ta testonte për fuqi, doktori e tundi dorën e imët. Samueli qëndroi i fortë. I shkrepa një foto. Uau!"[3]

Samuel Armas u qep sërish brenda mitrës së nënës së vet për të lindur afërsisht katër muaj më pas. Po si ndikoi e gjithë kjo ngjarje në jetën e Klensit? "Në atë çast, ai ndryshoi pozicion, nga përkrahës i pro-zgjedhjes në të pro-jetës. Ashtu siç e ka theksuar: 'Isha plotësisht i shokuar për dy orë pas operacionit... Tani e di që aborti është i gabuar, është absolutisht i gabuar.'"[4]

A mos vallë dikush mendon seriozisht se ky pacient që ndjen dhembje, shtrëngon gishtin, ishte vetëm një shtojcë nga trupi i nënës së tij? A mund të argumentohet në mënyrë të besueshme se, pasi ai të jetë rivendosur në barkun e nënës, duhet të jetë e

ligjshme të vrasësh të njëjtin gjatë katër muajve të ngelur deri kur ai të lindë?

## Mospërputhje e gjithanshme

Në Universitetin e Mjekësisë në Karolinën e Jugut, nëse testi i urinës së një gruaje shtatzënë tregon përdorim kokaine, ajo mund të arrestohet për shpërndarje droge një të mituri. Po ashtu, në Ilinois një grua shtatzënë, që drogohet mund të ndiqet penalisht për “shpërndarje substance droge një të mituri”. Ky është një pranim i qartë se një fëmijë i palindur është një person me të drejta, që meriton mbrojtje qoftë edhe prej nënës së tij.

Megjithatë, kjo grua që ndiqet penalisht dhe burgoset për vënien në rrezik të jetës së fëmijës së vet ende të palindur, është *e lirë ta abortojë të njëjtin fëmijë*. Sot në Amerikë është ilegale të dëmtosh fëmijën tënd të palindur, por është krejtësisht e ligjshme ta vrasësh atë.

Çdo lokal që shërben pije alkoolike në Oregon e ka të detyrueshme të ngjisë këtë poster:




Nëse alkooli dëmton bebet e palindura, atëherë çfarë mund t’u shkaktojë aborti?

Kongresi i SHBA-së votoi në mënyrë unanime pezullimin e dënimit me vdekje të një gruaje shtatzënë para lindjes së saj. Çdo deputet, pavarësisht nëse ishte përkrahës i pro-zgjedhjes, ishte i sigurt që ky fëmijë ishte një person i veçantë, i pafajshëm në lidhje me krimin e nënës së tij. Nuk u kërkua pezullimi i ekzekutimit për hir të zemrës, veshkave apo bajameve të nënës.

Shumë shtete kanë miratuar ligjet kundër vrasjes fetale duke e shpallur vrasje për këdo, përveçse për nënën, marrjen e jetës me paramendim të fëmijës së saj të palindur. Këto ligje janë pohime të qarta të faktit se fëmija është një qenie njerëzore. Në vitin 2004 Kongresi miratoi Aktin ligjor “Viktimat e palindura të veprimeve të dhunshme”, që deklaron se kushdo që “qëllimisht vret ose përpiqet të vrasë një fëmijë të palindur..., do të dënohet..., për vrasje me qëllim (paramendim) ose përpjekje për të vrarë një qenie njerëzore.”[5]

Mendoni pak për implikimet e çuditshme të këtij standardi të dyfishtë.. Nëse një grua ka planifikuar të kryejë një abort, por gjatë rrugës për në klinikë bebja e saj vritet in-utero (brenda mitrës), vrasësi i kësaj bebeje do të ndiqet penalisht për vrasje. Por, nëse vrasja nuk ndodh, një orë më vonë doktori do të paguhet për kryerjen e një procedure legale—vrasja e *të njëjtit fëmijë* (në një mënyrë ndoshta edhe më të tmerrshme).

Çfarë ndryshimi ka për një fëmijë se kush e vret?

## Një mësim nga Luiza Braun

Të jesh brenda diçkaje nuk është njësoj me të jesh pjesë e diçkaje. (Një makinë nuk është pjesë e garazhit meqë parkohet aty.) Luiza Braun, bebja e parë e eksperimentuar përmes testit të tubit, u ngjiz kur sperma dhe veza u bashkuan në enën e Petrit. A u bë ajo pjesë e trupit të nënës së vet pasi u vendos në mitrën e saj? Jo më shumë se ç’ishte pjesë e enës së Petrit, për aq kohë sa qëndroi aty.

Qeniet njerëzore nuk duhen diskriminuar për vendin ku jetojnë. Nuk ka asgjë të veçantë rreth lindjes që do ta bënte rrënjësisht të ndryshme një bebe nga momentet para lindjes. Nuk ka asgjë magjike që ndryshon natyrën e fëmijës kur ai shpërngulet 60 cm jashtë mitrës së nënës.

# 6

# Çfarë na thonë fotografitë?

Pengesa më e madhe e një fëmije të palindur është se ai jeton në një vend ku nuk ka dritare. Fati i tij është në duart e atyre që nuk e shohin atë. Por në vitet e fundit, kjo situatë ka ndryshuar në mënyrë radikale.

*"Koha"* (*Time*) në 2002 dhe *"Të Rejat e Javës"* (*Newsweek*) në 2003 ua dedikuan historinë kryesore imazheve të frymëmarrjes përmes ultratingujve të fëmijëve të palindur.[1] *"Newsweek"* ngrinte këtë pyetje në kopertinën e vet, "A duhet të ketë fetusi të drejtë? Si e ka ndryshuar shkenca argumentin mbi këtë çështje?

Të gjitha argumentet avullojnë para fytyrës së fëmijës së palindur.

## Fuqia e ultratingujve

Rebeka Nenkarrout bëri një ultratingull me çmim 80 dollarë në Planifikimin Prindëror, por nuk iu lejua të shihte rezultatin, sepse 'do t'ia bënte më të vështirë vendimin.' E turbulluar ajo shkoi në Qendrën e Kërkimit për Shtazëninë dhe bëri një ultratingull falas ku iu lejua ta shihte.

Më pas u shpreh: "Nëse nuk do ta kisha parë rezultatin do ta kisha bërë pa dyshim abortin. Por ultratingulli më konfirmoi 100% se brenda vetes kam një jetë dhe jo thjesht një ind apo një pjesë të rrumbullakët."[2]

Sipas Tomas Glessnërit, “Para se të përdorej teknologjia e ultratingullit, qendrat e shtatzënisë raportonin se ndër gratë që vinin për testim dhe këshillim, vetëm 20 deri në 30% e tyre vendosnin ta mbanin shtatzëninë. Ndërkaq, përmes përdorimit të ultratingujve, ky raport ndryshoi duke shkuar deri në 80 dhe 90%.”[3]

Odri Stout, infermiere, më tregoi në lidhje me një ultratingull të kryer nga vetë ajo. Gjatë kësaj kohe të veçantë, bebja “hapi dhe mbylli gojën, e zuri lemza, qëndroi me shpinë sikur të ishte ulur në një karrige plazhi duke shtriqur këmbët e vockla. Madje, një moment hapi pëllëmbën e dorës që mami i vet t’i numëronte gishtat përmes ekranit. Në atë moment u duk qartë që nëna ishte shumë e prekur.

Kur Odri e kreu skanimin, pyeti gruan në lidhje me planet e ardhshme mbi beben. Ajo ia ktheu: “Do ta mbaj patjetër fëmijën tim.” Kur e pyeti nëse skaneri kishte bërë ndonjë ndryshim në mendjen e saj, ajo u përgjigj: ‘Ndryshim rrënjësor. Erdha këtu vetëm për të bërë një verifikim në lidhje me shtatzëninë në mënyrë që të bëja më pas abortin.”[4]

Me mijëra histori si kjo vijnë nga Qendrat e Shtatzënisë që përdorin tanimë metodën me ultratinguj. Faqe të ndryshme në internet shfaqin imazhe mahnitëse ultratingujsh—disa prej tyre tregojnë qartë fëmijën që qesh, që hap gojën për gjumë, duke u shtriqur dhe duke fjetur.[5] Por sërish, ka refuzime të forta. Kur i tregova një fotografi të pjesës së brendshme të mitrës të një fëmije të palindur tetë javësh një përkrahësi të pro-zgjedhjes—një kolegeje inteligjente dhe mjaft të përgatitur—ajo më pyeti: “Mendon vërtet se do t’ia hedhësh ndonjërit me këtë fotografi të sajuar?” I bëra me dije që të shikonte tekstet shkollore të Universitetit të Harvardit në Departamentin e Mjekësisë, revistën *“Jeta”* *(Life)*,[6] ose librin e Nilsonit *“Një fëmijë është lindur”*[7] se do të gjente të njëjtat fotografi. Por ajo nuk donte të dëgjonte. Pse? Sepse ajo po thoshte në të vërtetë: “Duket qartë që aty në foto është një fëmijë dhe sepse nuk dua të besoj që aborti e vret një fëmijë, refuzoj të besoj që është fotografi e vërtetë.”

# Çfarë tregojnë eshtrat e mbetura

Në filmin “Dhurata e zgjedhjes” thuhet se i palinduri është “një probabilitet i një personi të ardhshëm”. Ajo që mbetet pas një aborti janë pjesë të vogla, por mrekullisht dhe plotësisht të formuara—krahë dhe këmbë, duar dhe shputa, trungu dhe koka. Pjesët fizike të mbetura nuk tregojnë fundin e një jete të mundshme, por të një jete të vërtetë. Nëse nuk besoni, analizoni pjesët e mbetura nga një abort.[8] Nëse nuk do të kesh zemër të shohësh, pyete një çast veten pse. Nëse ky do të ishte veç një ind siç edhe pretendohet dhe jo një fëmijë i copëtuar, atëherë nuk do të ishte e vështirë ta shihje, apo jo?

Në manualin e vet “Si të bëhet, *Praktika e Abortit*”, Dr. Uorren Herni konstaton: “Një lloj gërshëre e gjatë dhe e lakuar e tipit Mayo do të ishte më se e përshtatshme për t’i këputur kokën dhe copëtuar fetusin.’[9] Dikush duhet të ketë kokë në mënyrë që të këputet dhe pjesë trupore që të copëtohen. Copat e mbledhura të mishit dhe pjesët indore nuk kanë pse të këputen ose të copëtohen.

Pse njerëzit, që nuk e kanë problem të shohin vrasjet e përgjakshme dhe autopsitë e tmerrshme në ngjarje dramatike të drejtpërdrejta, shqetësohen të shohin fotot e një aborti? Feministja e pro-zgjedhjes, Naomi Uolf, ndërsa flet për fotot e abortit të fëmijëve pranon se,

> “Për shumë përkrahës të pro-zgjedhjes, imazhet janë një propagandë revoltuese. Për të qenë të sinqertë, ekziston një ndjesi mes nesh që tmerri i imazheve i përket përkrahësve pro-jetës... dhe që paraqesin dhunën e përfytyrimeve gjatë abortit, së cilës, nëse do t’i ishte dhënë gjysma e mundësisë, do ta kishte kthyer botën tonë në një vend të frikshëm dhe shtypës. ‘Njerëzit si ne’ e shohin një material të tillë thjesht si një pornografi e lëvizjes pro-jetës. Por feminizmi me të mirat e veta është bazuar thjesht në të vërtetën... Ndërsa imazhet e një vdekjeje të dhunshme të fetusit gjatë abortit u bëjnë punë mrekullisht përkrahësve të pro-jetës në të mirë të polemikës së tyre politike, vetë fotot nuk janë polemike, ato janë fakte biologjike. Dhe të gjithë ne e dimë këtë.”[10]

## E drejta për të mbetur në padije

Kur një kandidat i pro-jetës përdori një reklamë në televizion me imazhe të fëmijëve të abortuar, njerëzit iu vërsulën dhunshëm. Një gazetar i lajmeve të mbrëmjes të *"CBS Evening News"* deklaroi se debati mbi abortin kishte arritur "shkallën më të ulët të komunikimit njerëzor." Çuditërisht nuk kishte asnjë reagim për fëmijët që po vriteshin dita-ditës përmes abortit... po merreshin vetëm me dikë që kishte patur kurajën të *tregonte* që fëmijët po vriteshin.

Çështja nuk ka të bëjë me "Pse i shfaqin përkrahësit e pro-jetës këto imazhe?", por "Pse asnjë nuk e mbron atë që shfaqet në foto?" Shqetësimi i vërtetë për fotot e fëmijëve të palindur nuk ka të bëjë me imazhet e gjakosura, por sepse provojnë arsyen e pozicionit të pro-jetës.

Fotot e imazheve të brendshme të mitrës dhe ultratingujt nuk janë të neveritshme apo të shëmtuara, por të bukura dhe mahnitëse. A i mirëpresin këto foto përkrahësit e pro-zgjedhjes? Jo. Organizatat për të drejtën e abortit u referohen imazheve të ultratingujve si "armë" në duart e lëvizjes së pro-jetës. Ndonjëherë bizneset dhe klinikat ofrojnë fotografi ultratingujsh 3 D (ndonjëherë edhe 4 D) me fëmijë të palindur që qeshin, teshtijnë dhe gogësijnë. (shih imazhin ultratingull të një fëmije të palindur në kopertinën e pasme të librit) Në një diskutim, një prej përfaqësuesve të panelit deklaroi se këto foto reflektojnë "një shqetësim jo të shëndetshëm për beben." Vini re terminologjinë "beben". Teknologjia e ultratingujve zbërthen argumentin e vjetër të lëvizjes së pro-zgjedhjes, "Nuk kemi të bëjmë me bebe!" Njerëzit thonë, "Po çfarë po thoni? Pa dyshim që është një bebe—*shiheni!*"

## Kapërcimi i mohimit

Holokausti ka qenë aq çnjerëzor sa nuk mund të përshkruhet thjesht me fjalë. Përshkrimet e vdekjeve nëpër kampet naziste kanë qenë të publikuara për një kohë të gjatë në gazetat amerikane, por kur këto gazeta nisën të publikojnë foto të njerëzve të masakruar,

më në fund publikut amerikan iu hapën sytë. Nëse nuk do kishte qenë për fotot, edhe në ditët e sotme shumica prej nesh nuk do të mund të kishin kuptuar apo besuar mbi Holokaustin.

Njëherë shkova në një qytet studenti kur përkrahësit e projetës kishin ekspozuar foto të fëmijëve të abortuar në krah të viktimave të kampeve naziste, fusha të tëra me të vrarë, foto nga koha e skllavërisë amerikane, si edhe barbarizma të tjera që njeh historia. Fotot kishin shenja të qarta paralajmëruese mbi imazhet që transmetonin, kështu që kushdo të mund të zgjidhte vetë nëse donte t'i shihte ose jo. Dëshmova efektin e padiskutueshëm që pati kjo tek studentët dhe fakulteti duke përfshirë edhe ata, që nuk donin ta besonin atë që po shihnin.

Përkrahësit e të drejtave për kafshët argumentojnë se, për të bërë të njohur çështjen e tyre duhet të shfrytëzojnë mundësinë e fotove të tmerrshme të këlyshëve të fokave që qëllohen për vdekje. Nëse është vendi për të parë të tilla foto, atëherë a nuk është vendi të shihen edhe fotot e aborteve? Dhe, nëse aborti nuk vret fëmijën... atëherë pse na shqetëson kaq shumë shfaqja e tyre?

A qëndronte zgjidhja e çështjes së Holokaustit duke ndaluar shfaqjen e fotove të tmerrshme apo duke ndaluar vrasjet?

A është zgjidhje çështja e abortit duke refuzuar së pari fotot e bebeve të vdekura? Apo largimi i asaj që i çon bebet në vdekje?

# 7

# Çfarë e bën një jetë njerëzore "kuptimplotë"?

Dr. Uilliam Herrisoni, përkrahës i pro-zgjedhjes, argumenton: "Çështja e vërtetë në debatin për abortin në ditët e sotme nuk ka të bëjë me momentin kur fillon jeta, por a është moralisht një jetë kuptimplotë.[1] Por kush e vendos se cila jetë është kuptimplotë dhe cila nuk është. Përgjigja, gjithnjë, është se njerëzit e fuqishëm vendosin nëse jeta e njerëzve më të dobët është kuptimplotë.

## Një standard i dyfishtë

Pitër Singër, profesori i Etikës në Universitetin e Prinstonit, shkruan, "Jeta e një fetusi nuk ka më shumë vlerë se jeta e një kafshe me të njëjtin nivel arsyetimi, turpi, droje, kapaciteti për të mësuar, për të ndjerë etj.[2] (Prindërit që paguajnë që fëmijët e tyre të marrin pjesë në orët e Singërit ndoshta do ta merrnin në konsideratë faktin që ky profesor beson se ka një justifikim moral të vrasësh të moshuarit...)

Një person pro-abortit nga Portlandi i Oregonit, Xhim Njuholli, thotë: "Jo të gjithë janë të destinuar të lindin. Besoj se jeta për një fëmijë fillon atëherë kur do nëna e tij."[3] Pra, jeta njerëzore filloka vetëm atëherë kur dhe nëse një person tjetër e vlerëson?

Në vitin 1973, vendimi i Gjykatës së Lartë *"Roe kundër Wade"* vuri në pikëpyetje nëse ka jetë "kuptimplotë" një i palindur? Por *kuptimplotë për kë?* Por, a nuk e konsideron çdo njeri jetën e tij

si kuptimplotë që nga koha kur ka qenë në mitër, sepse nëse ajo jetë do ishte ndërprerë, ky njeri nuk do të ishte gjallë sot?

Të bardhët vendosën dikur që të zinjtë ishin më pak njerëzorë. Burrat vendosën që gratë kanë më pak të drejta. Nazistët vendosën që jetët e çifutëve nuk ishin kuptimplote. Sot, njerëzit e mëdhenj vendosin që njerëzit e vegjël, nuk janë mjaftueshëm kuptimplotë që të kenë të drejta.

Të jesh person nuk është diçka që dhurohet nga Lidhja Çoroditëse e Profesorëve, që synojnë të shpëtojnë shoqërinë njerëzore nga "të padëshirueshmit". Person-shmëria ka një vlerë të brendshme, që vjen me faktin që je anëtar i racës njerëzore. Sipas Biblës, kjo është pjesë e të qenët i krijuar sipas imazhit të Perëndisë.

## Çfarë thotë shkenca mbi "kuptimin"?

Çfarë e bën një jetë "kuptimplote"? Tashmë është fakt shkencor, se ka metoda të menduara që janë në funksion tek fëmijët e palindur. Shtypi i asociuar raportoi një studim, që tregon se "bebet fillojnë të mësojnë gjuhën e tyre të ardhshme në botë që para se të lindin". Studimet tregojnë se, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në mitër "fetuset dëgjojnë, ndiejnë, dallojnë dhe mësojnë diçka mbi strukturën akustike të anglishtes amerikane.[4]

*"Lajmet e Javës"* (*Newsweek*) deklaron, "Jeta brenda në mitër paraqet një zonë të re të pashkelur më parë për studimin e zhvillimit njerëzor, dhe eksplorimet e para të kësaj bote tjetër... kanë sjellë zbulime befasuese."[5] Artikulli vazhdon, "Pa e zmadhuar aspak, fetusi mund të jetë ai që me të drejtë do të quhej mrekullia e njohjes, ndërgjegjja dhe ndjeshmëria." Thuhet gjithashtu se shkencëtarët kanë zbuluar tanimë për vetëdijen e fetusit në tremestrin e dytë.[6] Kapaciteti i jashtëzakonshëm që ka fëmija i palindur është dokumentuar më së miri nëpër studime shkencore për vite të tëra.[7]

Në fillim të tremestrit të dytë, bebja nis të lëvizë duart, të përpëlisë sytë nga prania e dritës, që mund të përshkojë trupin e nënës. "Fetusi u përgjigjet edhe tingujve të lartë ose shumë të ulët, aq të ulët sa në fakt veshi normal i një të rrituri nuk

mund ta rrokë."[8] Ai e dëgjon muzikën e lartë dhe mbulon veshët nga zhurmat e larta që vijnë nga bota e jashtme. Në javën e shtatëmbëdhjetë, fëmija përjeton lëvizjen e qepallave të syve gjatë gjumit duke na treguar që ai nuk është vetëm duke fjetur, por edhe ëndërruar.[9] A mund të themi për dikë që është i aftë të ëndërrojë, se nuk është i tillë për të menduar?

Pa dyshim, abortet në fazat e vona vrasin një qenie njerëzore që mendon dhe ndjen. Në fund të tremestrit të dytë, rrathët nervorë të trurit janë njësoj të zhvilluar sa ata të një të sapolinduri.[10] Duket gati e papërfytyrueshme që çdokush që është i vetëdijshëm për këto fakte të mbrojë ligjërimin e sotëm të abortit në tremestrin e dytë dhe të tretë. Sërish përkrahësit e pro-zgjedhjes i mbrojnë këto aborte."

Por, a janë abortet e hershëm më të mirë se ato të një kohe të mëvonshme? Edhe në rastet e aborteve të hershëm, që marrin një jetë para se të krijohet kapaciteti për të menduar, vdekja është po aq e vërtetë dhe domethënëse. Një fëmijë i gjallë që mund të kishte një emër, një familje dhe një jetë, tanimë nuk do të ketë asnjërën prej tyre.

## Etikë e mangët

Singëri thotë: "Nëse bëjmë një krahasim me një defekt serioz të një fëmije me atë të një kafshe, të një qeni apo derri, më shpesh do të hasim që kafsha ka kapacitetete më të mëdha, aktuale dhe të mundshme në lidhje me arsyetimin, ndjeshmërinë, komunikimin dhe gjithçka tjetër, që bindshëm mund të konsiderohet moralisht domethënëse."[11]

Singëri sugjeron se vlera e qenies njerëzore qëndron në dobinë e shërbimit kundrejt të tjerëve: "Kur vdekja e një fëmije me aftësi të kufizuara do të çojë në lindjen e një fëmije tjetër me një perspektivë më të mirë për një jetë të lumtur, totali i lumturisë do të ishte më i madh nëse fëmija i parë, i paaftë, do të vritej. Humbja e mundësisë për të qenë i lumtur për fëmijën e parë është më e rëndësishme, sepse fiton lumturinë e të dytit. Prandaj, nëse vrasja e një fëmije hemofilik nuk do të ketë efekte negative te tjerët, sipas rezultatit përfundimtar, është e drejtë ta vrasësh atë."[12]

Kur Singëri shkoi për të dhënë mësim në Universitetin e Prinstonit, nuk u mirëprit, përkundrazi u protestua nga një grup ende i pavdekur, një grup për të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuara. Ata sulmuan librat e tij, ku thuhet se është me vend të vriten foshnjat e paafta të sapolindura, po ashtu edhe çdo fëmijë apo i rritur me aftësi njohëse të kufizuara në një nivel serioz.

Logjika e pro-zgjedhjes nis me abortin, por nuk ndalon këtu. Në një kohë që është bërë e pranueshme vrasja e fëmijëve të palindur, asnjë i varfër apo i brishtë nuk mund të shpëtojë nga kjo. A mund të ketë një person me aftësi të kufizuar një jetë kuptimplotë? Po përsa u përket të moshuarve? Nëse ata që nuk janë të aftë të mendojnë nuk e meritojnë të jetojnë, çfarë duhet të themi atëherë për ata që mendojnë në mënyrë të gabuar?

Dr. Çarls Hartshorn i Universitetit të Teksasit përsërit sipas etikës së Singërit: "Sigurisht që një foshnjë nuk është tërësisht një qenie e plotë njerëzore... Nuk e përkrah idenë që vrasja e foshnjëve është thjesht një mënyrë tjetër vrasjeje. Personat që janë tërësisht funksional në kuptimin e plotë, kanë të drejta shumë më të rëndësishme, madje edhe se foshnjat."[13]

## A është ndokush i sigurt?

Dejvid Bunin tregon se aborti është "moralisht i kritikueshëm", por gjithsesi "moralisht i lejueshëm". Ai e pohon këtë të fundit, sepse sipas tij, "aborti prodhon lumturinë e përgjithshme."[14] Njësoj si Singëri, Bunin vëren se i njëjti subjekt, ndjesia e lumturisë (e matur përmes komoditetit, largimit të stresit ose vështirësive financiare) mund të arrihet duke u marrë jetën njerëzve të tjerë, jo vetëm të palindurve. Nuk ka asgjë që ta zvogëlojë apo pengojë atë që mund të konsiderohet e lejueshme kur rezultati i saj prodhon lumturinë.

Prapaskena e diskutimit mbi atë që përbën dhe konsiderohet kuptimplote është utilitarizmi, dobia që sjell. A janë njerëzit mendërisht dhe fizikisht të paaftë, të dobishëm për personat e shëndetshëm dhe të fuqishëm, apo janë thjesht një barrë për ne? Një grup feministësh kanë theksuar dikur se, nëse fëmijët

e palindur nuk janë të sigurt, atëherë askush tjetër nuk është i tillë:

Nëse marrim një anëtar të species *Homo sapiens* dhe e vendosim jashtë hapësirës së mbrojtjes ligjore, atëherë kemi rrëzuar çështjen kundër diskriminimit për gjithë të tjerët. Baza për trajtim të barabartë nën ligj është se të qenët anëtar i species është e mjaftueshme për të qenë anëtar i komunitetit njerëzor pavarësisht racës, gjinisë, paaftësive, moshës, fazës së zhvillimit, gjendjes së varësisë, vendbanimit, apo pasurive që dikush mund të disponojë.[15]

Aborti na ka vënë në një drejtim të rrezikshëm. Ne mund t'i thërrasim arsyes dhe të shmangemi nga një e tatëpjetë e rrëshqitshme. Ose mund ta ndjekim këtë shteg drejt konkluzionit të pashmangshëm—një shoqëri, ku i fuqishmi, i orientuar nga interesat vetjake, përcakton kush duhet të jetojë e kush duhet të vdesë.

Biologu Dr. Leon Kas i Universitetit të Çikagos thotë nën shqetësimin e drejtimit të shkencës moderne dhe mjekësisë në veçanti: "Jemi dëshmitarë të erozionit të idesë sonë se njeriu është diçka hyjnore ose e shkëlqyer, si një krijesë me liri dhe dinjitet. Dhe është më se e qartë se, nëse ne arrijmë ta shohim veten thjesht si një copë mishi, atëherë të tillë do të bëhemi."[16]

Kjo është bota e dizenjuar nga retorika e lëvizjes për të drejtën e abortit.

A është kjo bota ku doni të rrisni fëmijët dhe nipërit tuaj?

Pjesa 3

# Gruaja



# 8

## A është aborti vërtet një çështje e së drejtës së gruas?

Kejt Mishëlmen, ish-presidente e NARAL (Shoqata Kombëtare për Shfuqizimin e Ligjeve Kundër Abortit), thotë: "Duhet t'u kujtojmë njerëzve se aborti është garanti i..., të drejtave të grave për të marrë pjesë plotësisht në jetën sociale dhe politike të shoqërisë."[1] Por edhe një grua shtatzënë *mund* të jetë pjesë aktive e shoqërisë. Dhe nëse nuk mundet, a mund të gjendet një zgjidhje më e mirë duke ndryshuar shoqërinë dhe jo duke vrarë fëmijë?

Si mund ta arrijnë barazinë gratë pa mundur të kenë nën kontroll jetën e tyre riprodhuese? Feministët për jetën përgjigjen:

> Kushti paraprak i kësaj pyetjeje ka të bëjë me dominimin e mashkullit gjatë mijëvjeçarit—që kishte krijuar burrin superior ndaj gruas inferiore. Teknologjia mjekësore është ofruar për të gjetur zgjidhjen e barazisë, por kushti paraprak mbetet të jetë i gabuar. ... Është fyerje për gruan t'i thuash se ajo duhet të ndryshojë natyrën e saj biologjike në mënyrë që të përputhet me kërkesat e shoqërisë.[2]

Në esenë "Feminizmi: I magjepsur pas abortit," ambientalisti Rozmeri Boçër tregon se lëvizja feministe e ka degraduar figurën e gruas, si të paaftë për të përballuar stresin dhe presionin e shtatzënisë ndërsa i drejtohet vrasjes së fëmijëve të vet.[3]

Grupet pro-zgjedhjes kundërshtojnë vazhdimisht përpjekjet që aborti të trajtohet si çdo operacion tjetër kirurgjikal kur vjen puna për ta vënë në dijeni pacientin lidhur me rreziqet që pasojnë. Ata duket se nuk besojnë në aftësinë e grave për të bërë zgjedhjen e duhur pasi të njihen me të gjitha faktet.

Serrin Fostër, presidente e lëvizjes Feministe për Jetën, flet fuqishëm ndërsa përcjell "Çështjen Feministe kundër Abortit." Ajo thotë se historikisht të parat aktiviste kundër abortit kanë qenë gra dhe ironikisht "ligjet anti-abort që feministet e hershme punuan dhe u përpoqën aq shumë për të mbrojtur gratë dhe fëmijët ishin ato që u shkatërruan nga vendimi i *Roe v. Wade* një shekull më vonë."[4]

## Historia feministe

Sjuzën B. Enthëni u ngrit për të drejtat e grave në një kohë që gratë nuk kishin as të drejtën e votës. Ajo i referohet abortit si "vrasja e fëmijëve" duke e parë si një mënyrë për të eksploruar gruan dhe fëmijën. Enthëni shkruan: "Vajtoj për krimin e tmerrshëm të vrasjes së fëmijëve... S'ka rëndësi motivi, për shkak të dashurisë apo lirisë, apo dëshira për ta shpëtuar nga vuajtjet të palindurin e pafajshëm. Gruaja që pajtohet me këtë veprim është tmerrësisht fajtore."[5]

Gazeta e drejtuar nga kjo grua, *"Revolucioni"*, ka bërë këtë deklaratë: "Kur një grua shkatërron jetën e fëmijës së saj të palindur, kjo është shenjë që, pavarësisht edukimit apo rrethanave, ajo gabon plotësisht."[6]

Enthëni dhe feministe të tjera që ishin kundër abortit dekada më vonë u ndoqën nga të tjera pasuese feministe. Më e spikatura ka qenë Margaret Sengër, e cila e përkrahte abortin si një drejtim të eugjenikës, ekonomisë dhe lirisë seksuale. Pasi eugjenika dështoi duke rezultuar me Holokaustin, organizata e saj u kthye në një lëvizje të fshehtë, duke u shfaqur me vonë me emrin Federata e Planifikimit Prindëror.[7] Sengëri dhe të tjerët që e ndoqën Enthënin u përpoqën ta lidhnin çështjen e abortit me çështjen e të drejtave të grave.

Dr. Bernard Nathënsën thotë se në vitet ‘60-të, ai dhe ndjekësit e tij për të drejtën e abortit me paramendim e lidhën abortin me çështjen e të drejtave të grave, kështu mund të ecte dhe të përqafohej gjerësisht jo vetëm për meritat e tij, por edhe për ato të të drejtave të grave.[8] Kështu aborti u kanalizua në çështjen e të drejtave të grave.

Elis Poli hartoi versionin origjinal të Amendamentit të të Drejtave të Barabarta (ADE), një dokument referues feminist, por këtu i referohej abortit si “shfrytëzimi final i gruas.”[9]

Një feminist e ka quajtur përpjekjen për lidhjen e feminizmit me abortin si “feminizëm terrorist”. Ndryshe ajo e konsideron si një imponim, që i bëhet feminizmit që “të jetë në gjendje të vrasë në emër të kauzës që beson.”[10] Në publikimin e tyre *“Feministi Amerikan”,* Feministët për Jetën japin edhe një foto të fytyrës së ëmbël të një fëmijë duke shtruar pyetjen: “A është kjo fytyra e armikut?” Ndërkaq paraqesin faktin që, si lëvizje feministe pro-jetës kanë një shtrirje prej 2 shekujsh histori, fundi i të cilës nuk shënohet në vitet ’70-të, kohë kur lëvizja e grave zgjodhi abortin.[11]

Sondazhet e ndryshme tregojnë se më shumë gra se burra pohojnë të drejtën e fëmijës së palindur për të jetuar.[12] Në fakt, “grupi më i madh pro abortit në Shtetet e Bashkuara (ashtu si edhe në vendet e tjera) përbëhet nga meshkujt e racës së bardhë ndërmjet moshës 20 deri në 40 vjeç.”[13] Dhe më specifikisht, ‘këtë grup e përbëjnë më shumë meshkujt beqarë’[14]. Duket kaq ironike që aborti është kthyer në çështje të të drejtave të grave në një kohë kur është parë si një nxitje pikërisht nga meshkuj të papërgjegjshëm dhe dështakë në lidhje me kujdesin ndaj grave dhe fëmijëve. A nuk është koha që të vijnë në vete meshkujt me pozicionin që kanë zënë si vetëm sigurues të parave për të vrarë fëmijët? A nuk duhet të inkurajohen ata pozitivisht që përpara gruas, që kanë lënë shtatzënë t’i thonë: “Do të jem këtu për ty dhe fëmijën tonë. Do të bëj gjithçka që mundem për të dhe për ty.”

## Zgjedhja e seksit (gjinisë)

Një prej ironive të feminizmit të sotëm është që përmes përkrahjes së abortit ka vërtetuar atë që ka përbërë pasurinë më të madhe

të të drejtave themelore, duke ia hequr përfundimisht të drejtën e jetës.

Aborti është kthyer në mënyrën kryesore të eliminimit të seksit femëror të padëshiruar në të gjithë botën. Një anketim i bërë në një duzinë fshatrash të Indisë zbulojnë një statistikë rrëqethëse: Në një popullsi prej dhjetë mijë banorësh, vetëm 50 prej tyre ishin vajza.[15] Vajzat e tjera, mijëra prej tyre, ishin vrarë përmes abortit. Ndërkohë që në Bombei, prej tetë mijë testeve që kishin treguar se ishin të seksit femër, të gjitha, përveç një rasti të vetëm, ishin vrarë përmes abortit.[16]

Për shkak të aborteve seks-përzgjedhëse, dy të tretat e fëmijëve në Kinë janë meshkuj. Në shkallë vendi, raporti i lindjes së djemve është katër me një.[17]

Testi i Amniosentezisë i hasur në shembujt e mësipërm është një mënyrë e përdorur edhe në Amerikë për të njohur seksin e fëmijës. "*Revista Mjekësore me Informacione nga Bota*" botoi një studim, ku 99 nënave u ishte bërë me dije seksi i fëmijës. Pesëdhjetë e tre fëmijë ende të palindur ishin djem dhe dyzet e gjashtë ishin vajza. Vetëm njëra prej nënave zgjodhi të abortonte fëmijën e saj djalë, njëzet e nëntë të tjera nëna vendosën të abortonin vajzat e tyre.[18]

Kështu përmes abortit po vriten më shumë vajza se djem. Të vrasësh një vajzë të palindur është njësoj si të vrasësh një grua të ardhshme. Nuk mund të ketë të drejta të barabarta për gratë derisa nuk ka të drejta të barabarta për seksin femëror të palindur.

# 9

## A kemi të drejtë të zgjedhim të bëjmë ç'të duam me trupat tanë?

Përkrahësit e pro-zgjedhjes argumentojnë: "Çdo grua ka të drejtë të zgjedhë të bëjë ç'të dojë me trupin e saj". Ironikisht, për shkak të zgjedhjes së abortit, të paktën 650.000 femra në SHBA çdo vit nuk kanë të drejtë të zgjedhin të bëjnë çfarë të duan me trupat e tyre. (Ky numër është i përafërt krahasuar me numrin total të fëmijëve të abortuar në SHBA, sepse gjysma tjetër janë fëmijët meshkuj) Një foshnjë vajzë e vrarë përmes abortit nuk ka më jetë, as mundësi zgjedhjeje apo një trup që të mund ta kontrollojë.

Njeriut nuk i lejohet ta zbulojë veten lakuriq në publik. Gjithashtu ka ligje, që ndalojnë urinimin publik, prostitucionin dhe përdorimin e drogës. Shumë prej nesh kemi rënë dakord me këto ligje edhe pse na ngushtojnë hapësirën e lirisë për të bërë gjëra të caktuara me trupat tanë. Dora ime është pjesë trupit tim, por unë nuk jam i lirë ta përdor për të goditur dikë, për të vjedhur apo dëmtuar ndonjë fëmijë.

### E drejta për të zgjedhur

Kur paraqes pozicionin e pro-jetës para studentëve zakonisht e nis me: "Unë jam përkrahës i pro-zgjedhjes. Prandaj besoj që një mashkull ka të drejtë të përdhunojë një femër nëse është zgjedhja e tij. Në fund të fundit është trupi i tij dhe askush prej nesh nuk ka të drejtë t'i tregojë çfarë të bëjë apo të mos bëjë me të."

Pasi lë një kohë pauze derisa audienca të qetësohet u kërkoj të më tregojnë pse mendojnë se e kam gabim. Ata vënë në dukje që e drejta për zgjedhje e mashkullit dëmton dhe dhunon të drejtat e femrës së pafajshme. U drejtohem më pas: "Pra, ju po më thoni që jeni anti-zgjedhjes, apo jo?" Pas argumenteve të tyre u përgjigjem: "Sipas jush, nëse ju tregoj që zgjedhja e një gruaje përmes abortit dëmton ose vret një qenie tjetër njerëzore, atëherë do të vazhdoni të jeni pro-zgjedhjes për abortin?"

Shpresoj që drita e kuqe të ndizet dhe ata t'ia vënë veshin zërit të brendshëm të një arsyetimi unik—atë që nuk e kanë dëgjuar, duke iu kushtuar çështjes së abortit.

Është absurde të mbrosh një zgjedhje specifike me pretendimin se është një zgjedhje. Kumbimi shurdhues për "të drejtën e zgjedhjes" lë në hije atë çka është më se e qartë: *jo të gjitha zgjedhjet janë të përligjura*. Në fakt—dhe për këtë besoj se kam miratimin e shumë jo të krishterëve po aq sa edhe të të krishterëve—disa zgjedhje janë kryekëput të këqija. Prandaj nuk mund të jemi të gjithë pa përjashtim pro-zgjedhjes ose anti-zgjedhjes. Përkundrazi, duhet të jemi pro-së mirës dhe anti—së keqes.

## I përzgjedhur pro-zgjedhjes

Të gjithë ne si njerëz kemi favorin e zgjedhjes ku të banojmë, çfarë makine të ngasim, çfarë ushqimesh të hamë dhe me mijëra gjëra të tjera, që futen në listën e preferencave personale. Jemi gjithashtu të lirë të zgjedhim fenë, kahun e politikës, stilin e jetës edhe atëherë kur nuk pëlqehemi nga të tjerët.

Por ka edhe shumë gjëra të tjera për të cilat nuk kemi lirinë e zgjedhjes—duke përfshirë sulmin fizik, zënien rob, vjedhjen e shtëpisë, të makinës apo mashtrimin në një marrëdhënie interesi. Është e vetëkuptueshme që njerëzit kanë *lirinë* për të bërë zgjedhjet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kanë *të drejtën* për t'i realizuar.

Kur kundërshtojmë "të drejtën për të zgjedhur" për të përdhunuar apo abuzuar mbi një fëmijë, ne nuk po kundërshtojmë të drejtën, por atë që është e gabuar. Dhe nuk jemi aq mendjengushtë dhe as fanatikë për ta bërë një gjë të tillë.

Në njëfarë mënyre lëvizja “pro-zgjedhjes”, çka në fakt është një lëvizje pro abortit, ka pasur sukses me përdorimin e fjalës *zgjedhje*. *Zgjedhja* në këtë rast përbën një eufemizëm për abortin, ndaj të argumentosh kundër abortit *duket* sikur po argumenton kundër zgjedhjes. Ndaj përkrahësit e pro-jetës nuk duhet të argumentojnë kundër zgjedhjes—është një betejë e humbur për të cilën nuk ka pse të luftohet. Nuk duhet ta lëmë abortin “të ankoruar” me zgjedhjen. Përkundrazi, sa herë që dëgjojmë “pro-zgjedhjes” le të pyesim dhe t’i nxisim të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. *Për çfarë zgjedhjesh e keni fjalën?* Nëse përgjigjja është aborti, atëherë vazhdoni të pyesni, *A mendon që njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin të vrasin fëmijët?* Kundërshtimi i abortit nuk është kundërshtim i zgjedhjes në përgjithësi, ne kundërshtojmë *një zgjedhje* në veçanti—vrasjen e fëmijës.

Mendoni për pyetjen e famshme të lëvizjes pro-zgjedhjes: “Nëse nuk më beson me një zgjedhje, si mund të më besosh me një fëmijë?” Ka për qëllim t’i japë fund një diskutimi. Vini re si *zgjedhja* është zëvendësuar me *abortin*. Kur kërkojmë t’i përballim me realitetin, atëherë ata ngrenë pyetjen tjetër: “Nëse nuk më beson të vras një fëmijë, si mund të më besosh ta rris atë? Hë?”

## Po për zgjedhjen e viktimës?

Njëherë një grua vuri në dukje: “Pasi një grua mbetet shtatzënë, ajo nuk mund të zgjedhë nëse dëshiron ose jo të bëhet nënë. Ajo tashmë është... gjithçka tjetër që ka të bëjë me faktin nëse fëmija do të lindë shëndoshë e mirë apo jo.”[1]

Padronët e skllevërve kanë qenë pro-zgjedhjes. Ata theksonin ndryshimet fizike për të justifikuar superioritetin e tyre karshi skllevërve. Thoshin: “Ndoshta s’ke pse të kesh skllevër, por mos na thuaj që s’mund të zgjedhim të kemi skllevër.” Ata që donin t’i mbanin skllevërit në mënyrë ilegale u akuzuan se ishin anti-zgjedhjes dhe anti-lirisë dhe se u impononin moralin të tjerëve.[2]

Çdo veprim shtypjeje apo shfrytëzimi—nga skllavëria te prostitucioni, droga dhe aborti e kanë quajtur veten pro-zgjedhjes.

Në të njëjtën mënyrë i kanë etiketuar veprimet e kundërta si anti-zgjedhjes.

Pozicioni i pro-zgjedhjes sheh gjithmonë mbi të drejtën e viktimës për të zgjedhur. Të zinjtë nuk e zgjodhën vetë skllavërinë. Çifutët nuk zgjodhën të digjeshin në furra. Gratë nuk zgjedhin të përdhunohen. Dhe fëmijët nuk zgjedhin të abortohen.

# 10

## A është aborti pjesë e së drejtës së privatësisë?

Aborti nuk është e drejta e askujt. Çdokush ka të drejtën e privatësisë. Në kundërshtim me atë që besojnë njerëzit, Kushtetuta e SHBA-së nuk thotë asgjë për të drejtën e privatësisë. Veç kësaj, privatësia nuk është asnjëherë e drejtë absolute, por sundohet nga të drejta të tjera.

Çfarë do të mendonim për një burrë, i cili mbrohet kundër dhunës fizike ndaj gruas apo fëmijës së tij me: "Çfarë bëj unë në shtëpinë time është çështja ime dhe e askujt tjetër?"

Apo një deklaratë tjetër e zakonshme: "Aborti është një vendim privat midis gruas dhe doktorit të saj."

Doktorët janë të specializuar në mjekësi, por opinionet e tyre morale nuk kanë aq autoritet sa diagnozat mjekësore (Të cilat edhe ato nuk janë absolute, sepse kanë të metat e tyre).

Shumë doktorë janë njerëz të ndërgjegjshëm të cilët vendosin mirëqenien njerëzore përmbi interesat monetare apo përfitime të tjera. Por fatkeqësisht, disa prej tyre nuk janë udhërrëfyes moralë seriozë.

Aftësia e këtyre doktorëve për të bërë gjykime të këqija u duk gjatë luftës së dytë botërore nga shumë doktorë gjermanë.

Robert Xhei Liftën, në librin e tij shumë ndikues *"Doktorët Nazistë*"*,* dokumenton se si mjekë profesionistë inteligjentë morën pjesë në operacione mizore dhe vdekjeprurëse, dhe në eksperimente me fëmijë të pashpresë me një pandjeshmëri tronditëse.[1] Ata

përbënin personelin mjekësor më të trajnuar në Evropë, por kishin humbur çdo kufi moral.

Doktorët që kryejnë abortet janë po aq objektiv mbi abortin, sa edhe kompanitë e prodhimit të cigareve që synojnë pirjen e duhanit. Interesat e tyre personale në lidhje me abortin, ashtu si edhe pandjeshmëria mbi pasojat e veprimeve të tyre, i përjashton për të qenë burim i një udhërrëfyesi moral.

## Të shmangësh sikletin

Shumë vajza të reja dhe prindërit e tyre nuk do të kishin pasur aspak dëshirë të viheshin në siklet përballë një publiku kritikues.

Pavarësisht pikëpamjes së seksit jashtë martese, shtatzënia nuk është e gabuar edhe pse akti seksual që solli për pasojë shtatzëninë ishte veprim i gabuar. Askush nuk duhet ta trajtojë nënën si një "vajzë të keqe" ose ta vërë nën presionin e "zgjidhjes së problemit të saj" duke e abortuar fëmijën. Ne duhet ta mbështesim me dashuri gjatë periudhës së shtatzënisë, duke i ofruar mundësi nëse do ta mbajë fëmijën dhe ta rrisë vetë apo do ta japë për birësim. Çfarëdo që ajo do të zgjedhë duhet mbështetur nga të gjithë ne.

Sa herë që shoh një grua të pamartuar shtatzënë, reagimi im i parë është vlerësimi. E di se ajo mund të merrte "rrugën e shpejtë" dhe ta zgjidhte problemin pa e marrë vesh askush tjetër, por në fakt ajo ka zgjedhur që fëmija i saj të jetojë.

Seksi paramartesor ka pasoja serioze edhe pa pasur shtatzëni të padëshiruar. Për ketë arsye duhet të ndërtojmë një sistem të pjekur edukimi.[2] Pjekuria i thotë jo gjithçkaje që të dëmton dhe njëkohësisht i thotë po më të mirës që jeta ka për ty. Por pasi ndodh, seksi paramartesor mund të të bëjë të kuptosh shumë gjëra dhe të mos përsëritet më. Vrasja e një qenieje njerëzore të pafajshme përmes abortit është një çështje më serioze dhe e vazhdueshme. Përmes abortit, njëri paguan për gabimet e tjetrit. Përveç kësaj, e bën një vajzë të re të jetojë pjesën tjetër të jetës së saj me ndjenjën e fajit duke e çuar në një gjendje më të rëndë, mbulimin e tij. Aborti mund të fshehë përkohësisht një problem, por nuk mund ta zgjidhë kurrë atë.

Aborti edukon një qëndrim të tillë: "Rehatia dhe lumturia ime janë të parat—pavarësisht shpërfilljes dhe mohimit të të drejtave të një personi të pafajshëm." Ky qëndrim shfaqet në mijëra arena, të vogla e të mëdha, që shqyen copash "fabrikën morale të shoqërisë" (dhe kështu nuk të dhuron kurrë lumturinë e premtuar).

Padrejtësia e dikujt apo rrethanat e sikletshme nuk justifikojnë marrjen e jetës së një personi tjetër.

# II

## A dëmton aborti shëndetin fizik dhe mendor të gruas?

"Aborti ka dështuar tërësisht si politikë shoqërore me synimin për të ndihmuar gratë", kështu shkruan Serrin Fostër, Presidente e Feministeve për Jetën. "Është një reflektim i faktit që ka gra të dështuara."[1]

Xhoana Epëltën ka qenë përkrahëse e abortit me NOW me profesion si kryeinfermiere në klinikën e abortit në Virxhinia. Ajo njëherë kishte pyetur veten se pse aborti ishte "aq traumatik për një grua dhe një vendim aq i vështirë për t'u marrë, nëse ishte diçka e natyrshme. Nëse ishte gjë e drejtë, pse ishte aq e vështirë?"

Epëltëni thoshte me vete: "I kam këshilluar këto gra kaq mirë, ato ishin të sigurta në lidhje me vendimin e tyre. Pse kthehen tani pas kaq kohësh, me muaj a vite më pas—psikologjikisht të shkatërruara?"[2]

Një numër i panumërt i grave, që janë dëmtuar për shkak të abortit janë shprehur më pas: "As që ma kishte marrë mendja që mund të ndodhte kjo. Askush nuk më paralajmëroi mbi rreziqet që vinin më pas."

### Komplikacione të zakonshme

Në dëshminë e saj përpara Nënkomisionit të Senatit në vitin 2004, dr. Elizabet Shedigën pohoi publikisht se, "aborti ka një shkallë

më të lartë të vdekjeve në raport me kancerin e gjirit, rritjes së placentës duke mbuluar qafën e mitrës (placenta previa), lindjeve të parakohshme dhe vetëvrasjeve të nënave... Sipas statistikave, të gjitha tipet e vdekjeve janë në shkallën më të lartë për ato gra që dikur kanë bërë abort."[3]

Të paktën dyzet e nëntë studime kanë treguar një rritje statistikore domethënëse në lindjet e parakohshme apo lindjet nën peshë të grave, që kanë kryer më parë abort. "Lindjet nën peshë dhe ato të parakohshmet janë faktorët kyç më të rrezikshëm për vdekshmërinë foshnjore ose *aftësia të ulta konjunktive* (për të menduar dhe gjykuar) dhe probleme të mëdha në sjellje."[4]

Aborti rrit mundësitë e keqformimit tek fëmijët e mëvonshëm.[5] Frekuenca e vdekjeve të hershme për foshnjat e sapolindura pasi nënat e tyre kanë kryer më parë abort janë dy në katër raste të një raporti normal.[6]

Për shkak se kryerja e abortit rrit rrezikun e lindjes së parakohshme së një fëmije të ardhshëm, ky duket të jetë shkaku edhe për mijëra raste të paralizës cerebrale në Amerikën e Veriut.[7]

Shtatzënitë ektopike ndeshen në rastet kur ngjizja zë vend jashtë mitrës, zakonisht në tubin e fallopit. Këto lloj shtatzënish përbëjnë 12% të vdekjeve amënore.[8] Departamenti i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore në SHBA realizoi një studim 20-vjeçar mbi shkallën e shtatzënive ektopike në vend, studim që tregoi një rritje të shtatzënive të tilla mbi 50% që prej kohës kur është ligjëruar aborti.[9]

Studimet tregojnë se rreziku që mbartin shtatzënitë ektopike është dy herë më i lartë për gratë, që kanë kryer një herë abort dhe katër herë më i lartë për ato që kanë kryer më shumë se një abort.[10] 40% e grave që kanë një shtatzëni ektopike, kthehen në shterpë dhe gjasat për të pasur sërish një shtatzëni ektopike janë një në tre. Vlen të theksohet se, "Vetëm 33% e grave me shtatzëni ektopike mund të kenë një lindje normale."[11]

Qendrat për Kontrollin e Sëmundjeve (QKS) raporton: "Komplikimet lidhur e shtatzaninë, si ato ektopike... vazhdojnë të prekin rreth 2000 gra çdo ditë."[12]

Sëmundja e inflamacionit pelvik, është një infeksion që çon në temperaturë të lartë, dhe shkakton shterpësi. Kërkuesit konstatojnë:

"Infeksioni pelvik (i legenit) është një komplikacion serioz i hasur jo rrallë dhe i nxitur prej abortit, duke u shfaqur deri në 30% të rasteve."[13] Një studim mbi gratë që kanë kryer abort gjatë tremujorit të parë të shtatzënisë, përforcoi se: "gratë e prekura nga sëmundja e inflamacionit pelvik pas abortit, shfaqin një shkallë shumë të lartë të... aborteve spontane, shterpësi të dytë, dispareuni dhe dhimbje kronike të legenit."[14]

Placenta previa, një keqvendosje e placentës, shkaktohet nga "dëmtime të mëparshme të mitrës"[15], duke përfshirë këtu edhe abortin. Këto raste ndeshen 7 deri në 15 herë më shumë tek gratë që kanë kryer më parë abort sesa tek ato që nuk kanë bërë ndonjëherë abort.[16] "Vetëm shkalla e komplikimeve të menjëhershme raportohet të jetë jo më pak se 10%. Përveç kësaj, studimet në lidhje më komplikacionet afatgjata tregojnë vlera jo më pak se 17% dhe në mënyrë të vazhdueshme kjo vlerë rritet me 25 deri 40%."[17]

Gratë që kanë kryer një herë abort e dyfishojnë rrezikun e kancerit të qafës së mitrës krahasuar me ato që nuk e kanë bërë ndonjëherë këtë, ndërkohë që gratë që kanë kryer më shumë se një abort e shumëfishojnë rrezikun afërsisht me pesë herë. Po kështu rritja e rreziqeve të kancerit të vezoreve dhe mëlçisë ka lidhje me një apo disa aborte të kryera në të kaluarën.[18]

Pas një kërkimi të gjerë, Dr. Joel Brind, profesor i endokrinologjisë në Universitetin e Qytetit të Nju Jorkut, doli me përfundimin: "Rreziku i vetëm i shmangshëm për kancerin e gjirit është aborti jo-spontan."[19] Një grua që ka bërë abort e rrit rrezikun e kancerit të gjirit minimalisht me 50 deri në 300%.[20]

Disa prej grave nuk mund të lindin më pas abortit. Aborti bëhet shkaktar i keqformimit të fëmijëve të mëvonshëm.[21] Frekuenca e vdekjeve foshnjore në nënat që kanë kryer abort është dy deri në katër herë më e lartë se vlera normale.[22]

## Komplikacionet e zakonshme psikologjike

Dhjetra studime e lidhin abortin me rritjen e mosfunksionimit seksual, neveri të aktit seksual, humbje të intimitetit, ndjenjë

faji të paparashikueshme, lidhje jashtëmartesore, sindromën e stresit traumatik, dyzim personaliteti, reagime brenge, abuzim dhe braktisje të fëmijës, abuzim me alkoolin dhe droga të tjera.[23] Një studim i Institutit Elliot tregon se gratë që kanë kryer abort janë pesë herë më shumë të prirura për t'iu nënshtruar drogës.[24]

Specialisti i post-aborteve, Dejvid Rirdën, shkruan, "Në një studim të zhvilluar me paciente pas abortit, kërkuesit kanë zbuluar se vetëm tetë javë pas abortit 44% e tyre ankohen për çregullime nervore, 36% kanë përjetuar shqetësime gjatë gjumit, 31% janë penduar për vendimin e marrë, dhe 11% e tyre janë këshilluar nga mjeku i familjes t'i nënshtrohen një trajtimi me barna psikotropike."[25] Ky studim është veçanërisht i rëndësishëm meqënëse disa gra nuk tregojnë pasoja të dukshme post-aborti deri në shfaqjen e tyre vite më vonë.

"Gratë e Shfrytëzuara nga Aborti" ka mbi tridhjetë mijë anëtarë në më shumë se dy breza në mbarë Shtetet e Bashkuara, edhe në Kanada, Gjermani, Irlandë, Japoni, Australi, Zelandën e Re dhe Afrikë.[26] Grupe të tjera mbështetjeje dhe rekuperimi për gratë pas abortit, përfshijnë në listën e gjatë: Viktimat e Zgjedhjes, Këshillimi dhe Edukimi Pas abortit, Ndihma dhe Edukimi për të Traumatizuarat prej Abortit, Rrjeti Largpamës i Çliruar, Këshillim për Përvojat e Abortit, Gratë e Ramahut, Projekti Rejçëll, Krahët e Hapura, Shërbimet për Traumën e Abortit, Viktimat Amerikane të Abortit, dhe ish-Grupi i Grave të Pro-Zgjedhjes. Prania e gjithë këtyre grupeve dëshmojnë për traumën mendore dhe emocionale të një numri të panumërt të grave, që kanë kryer më parë abort.

Lexova njëherë në një editorial në gazetë që aborti është thjesht një lloj tjetër operacioni, as më shumë dhe as më pak se një operacion apandesiti. Po pse nuk e kujtojnë përvjetorin e operacionit të apandesitit këta njerëz njëzet vjet më vonë? Pse nuk e gjejnë veten të zhytur në lot, me brengën e humbjes së apandesitit të tyre? Dhe ku janë gjithë ato grupe mbështetëse dhe këshilluese për ata që thjesht kanë hequr një shtojcë nga trupi i tyre?

(Shumë burra kanë vuajtur stresin post-traumatik për shkak të përfshirjes në vendimin për kryerjen e abortit dhe humbjen e fëmijëve të tyre.[27] Grupet mbështetëse ekzistojnë edhe për ata.[28])

# Vdekje nga aborti i ligjëruar

Një studim për shtatzënitë e shoqëruara me vdekje, i publikuar në *Gazetën Amerikane të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë,* tregon se shkalla e vdekshmërisë së shoqëruar me abortin është 2.95 herë më e lartë se sa shtatzënitë e çuara deri në muajin e nëntë.[29]

Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve raporton në vitin 1998, 10 vdekje që kanë të bëjnë me abortin[30,] por sipas të njëjtit raport, këto statistika janë të kufizuara, sepse nuk janë përfshirë të gjitha shtetet për shkak të mungesës së raportimit. Në të vërtetë, klinikat e aborteve kanë shumë për të humbur dhe asgjë për të fituar nëse japin informacion.[31] Gjëja që e bën vdekjen pas abortit shumë të vështirë për t'u gjurmuar, është se shumica e vdekjeve nuk ndodhin gjatë operacionit, por më pas. Kështu që, shumë shpesh identifikohen arsyet dytësore si shkaku i vdekjes:

> Mendoni për një nënë që pati hemorragji, bëri transfuzion gjaku, përmes këtij procesi mori hepatitin dhe vdiq disa muaj më vonë. Shkaku zyrtar i vdekjes? Hepatiti. Shkaku i vërtetë? Aborti. Një mitër e shpuar çon në shfaqjen e lungjeve pelvike, septicemi (helmim gjaku) dhe vdekje. Raporti zyrtar i shkakut të vdekjes mund të jetë lung në mitër ose septicemi (helmim gjaku). Por asnjëherë nuk shënohet aborti. Aborti shkakton patologji në tubat e fallopit. Vite më vonë gruaja që ka bërë abort ka një shtatzëni ektopike dhe vdes. Shkaku i shënuar i vdekjes do të jetë shtatzëni ektopike. Por shkaku i vërtetë? Aborti.[32]

Një studim i publikuar nga *"Revista Mjekësore e Jugut"* tregon se: "Gratë që kanë kryer më parë abort, kanë një shkallë shumë më të lartë rrezikshmërie të vdekjes, sesa gratë që kryejnë lindje."[33] Kjo normë përfshin një rrezik 154% më të lartë të vetvrasjeve si dhe nivele të larta të vdekjeve shkaktuar nga aksidentet apo vrasjet.

*"Shëndeti i Grave Pas Abortit"* është një vepër voluminoze enciklopedike, që citon mbi pesëqind artikuj të ndryshëm mjekësorë të publikuar, ku jepen pasojat dëmtuese të abortit te gratë.[34] Çdo

njeri që ende dyshon se aborti shkakton dëmtime serioze afatgjata te gratë, le të analizojë këta tregues në enciklopedinë e mësipërme.

## Çfarë thonë gratë

Në anketat e bëra me gratë që kanë përjetuar komplikacione pas abortit:

- Mbi 90% e tyre shprehen se nuk u është dhënë informacion i mjaftueshëm për të bërë një zgjedhje të vetëdijshme.

- Mbi 80% thonë se zor se mund të bënin abort nëse nuk do të ishin nxitur aq shumë nga të tjerët, duke përfshirë këtu këshilluesit e abortit.

- 83% thonë se do ta kishin çuar shtatzëninë deri në fund nëse do të kishin pasur mbështetje nga të dashurit, familjarët ose njerëz të tjerë të rëndësishëm në jetën e tyre.[35]

Çdo grua meriton më shumë se aborti.

# 12

## A është aborti i drejtë kur shtatzënia rrezikon jetën e nënës?

A justifikohet aborti kur jeta e gruas ose shëndeti i saj kërcënohet nga shtatzënia apo lindja e fëmijës? Ka raste shumë të rralla kur aborti është i nevojshëm për të shpëtuar jetën e nënës. Kur ishte në pozicionin e Kirurgut Kryesor të SHBA-së, Dr. Everet Kup dëshmon se në tridhjetë e gjashtë vite përvojë si kirurg pediatrik nuk mban mend asnjë situatë të vetme, ku i është dashur të ndërhyjë në heqjen e fëmijës së palindur që të mund të shpëtohej jeta e nënës. Ai tregon se ky argument për të justifikuar abortin, është thjesht si një "re tymi për të fshehur qëllimet e vërteta". Dr Lendrëm Shetlës deklaron se më pak se 1% e aborteve kryhen për të shpëtuar jetën e nënës.[1]

### Shpëto jetën që mund të shpëtohet

Një grua me helmim gjaku do të ketë reaksione negative në shëndet dhe pasoja të konsiderueshme, duke përfshirë edhe regjimin e shtratit pothuajse gjatë gjithë shtatzënisë. Kjo duket e vështirë, por nuk rrezikon jetën e nënës. Në raste të tilla, aborti për hir të "shëndetit" nuk do të ishte jetë-shpëtues, por do të merrte jetën e dikujt tjetër.

Nëse nëna ka kancer të mitrës me përhapje të shpejtë, operacioni për heqjen e kancerit mund të çojë në humbjen e fëmijës. Në një shtatzëni ektopike, fëmija zhvillohet jashtë mitrës. Nuk ka asnjë

shpresë për të që të mbijetojë, ndaj është me vend që të hiqet në mënyrë që të shpëtohet jeta e nënës. Këto janë situata tragjike, por edhe nëse një jetë duhet të humbasë, jeta tjetër duhet të shpëtohet. Në shumicën e rasteve, kjo është jeta e nënës. Ka raste të rralla, si në fazat e fundit të shtatzënisë, kur nëna nuk mund të shpëtohet, por jeta e fëmijës po. Përsëri, një jetë e shpëtuar është më mirë se dy jetë të humbura.

Dy miqtë tanë të familjes u përballën me një situatë kur kërcënohej jeta e nënës për shkak të përhapjes me shpejtësi të kancerit në trupin e saj dhe ndërhyrja do të sillte vdekjen e fëmijës. Shtatzënia ishte në fazën e hershme, kështu që nuk kishte kohë që fëmija të zhvillohej mjaftueshëm, sa të jetonte jashtë mitrës së nënës, para se nëna dhe fëmija të vdisnin të dy. Operacioni u realizua. Por në asnjë aspekt ky nuk ishte, abort. Qëllimi i kirurgut nuk ishte të vriste fëmijën, por të shpëtonte jetën e nënës. Vdekja e fëmijës ishte një efekt tragjik anësor i përpjekjeve për të shpëtuar jetë. Ky ishte një veprim në përputhje me qëllimin e pro-jetës, meqë të jesh përkrahës i pro-jetës nuk ka të bëjë vetëm me jetët e bebeve. Është qëndrim pro-jetës edhe ndaj grave-nëna.

# 13

## A është aborti i drejtë kur shtatzënia vjen për shkak të një përdhunimi apo incesti?

Studimet e kryera nga Instituti Gutmasher të përkrahësve pro-zgjedhjes tregojnë se dy femra të rritura pjellore kanë vetëm 3% mundësi për të mbetur shtatzënë pas një marrëdhënieje seksuale. Në këtë studim tregohet që ka faktorë që përfshihen gjatë një përdhunimi çka redukton shanset për viktimat për të mbetur shtatzënë.[1] Sipas këtij studimi, 14 mijë aborte në vit kryhen për shkak të përdhunimit apo incestit çka përbën 1% të të gjitha aborteve.[3] Në studime të tjera tregohet se shtatzënitë për shkak të përdhunimit janë shumë të rralla.[4] Veç kësaj, fakti që ngjizja nuk ndodh menjëherë pas marrëdhënies së kryer, shtatzënia mund të parandalohet në shumë raste përdhunimesh duke hequr spermën para se të pllenohet veza. (Ky veprim përbën një gjë krejt të ndryshme krahasuar me përdorimin e kimikateve që vrasin një fëmijë tashmë të konceptuar.)

### Cila është çështja reale?

Prej nga ka ardhur ideja e gabuar që shumë shtatzëni kanë shkak përdhunimin? Herë pas here, vajzat e reja të frikësuara, ia atribuojnë shtatzëninë e tyre përdhunimit pasi kjo shmang dënimin. Norma Mkarvej, një vajzë e re e quajtur “Roi” në çështjen *Roe v. Wade*—ngjalli keqardhje në gjykatë dhe në media pasi deklaroi se kishte qenë viktimë e një përdhunimi—vite më vonë ajo pranoi se kishte

gënjyer dhe se nuk ishte përdhunuar ndonjëherë në jetën e saj.[5] (Në kohën kur u bë përkrahëse dhe folëse publike në çështjen e pro-jetës, i kërkoi Gjykatës së Lartë të rishikonte dhe t'i rikthehej dhe njëherë çështjes së Roe v. Wade.[6])

Përkrahësit e pro-zgjedhjes e largojnë vëmendjen nga numri i madh i aborteve, duke u përqendruar te përdhunimi, për shkak të faktorit të merituar të keqardhjes. Referencat e tyre të shpeshta të krijojnë përshtypjen e rreme se shtatzënia si pasojë e përdhunimit është e zakonshme dhe jo diçka që ndodh rrallë.

Ne kemi një mikeshën tonë të dashur, që mbeti shtatzënë pas një përdhunimi. Për shkak të rrethanave të jetës, ajo nuk mundte ta rriste vetë fëmijën, ndaj e dha për birësim në një familje të krishterë. Periodikisht ajo mban kontakte me familjen dhe fëmijën e saj. Patjetër që nuk ka qenë e lehtë për të, dhimbja ishte e pakufishme—gjithsesi ajo gjen ngushëllim në faktin që fëmija jeton dhe është i rrethuar me dashuri.

Kam dëgjuar në një program televiziv një burrë të thoshte për ngjizjen e një fëmije pas përdhunimit: "Asgjë e kësaj natyre nuk ka të drejta, sepse është fryt i një përdhunimi." Po si qenka natyra e këtij fëmije e ndryshme nga ajo e një tjetri? A mos vallë disa fëmijë janë më të denjë për të jetuar, sepse etërit e tyre ishin më të mirë? Dhe pse përkrahësit e pro-zgjedhjes thonë se fëmijët e palindur, në të vërtetë i përkasin nënës dhe jo babait, dhe që në momentin kur ajo përdhunohet—krejt papritur fëmija konsiderohet si i babait dhe jo i nënës?

Në fakt, çështja këtu nuk ka të bëjë me *"mënyrën si"* u konceptua fëmija, por *"faktin që"* u konceptua". Ai nuk është "fryt i neveritshëm i një përdhunimi". Ai është krijesë unike dhe e mrekullueshme e Perëndisë.

Të kesh dhe të mbash në krahë një fëmije të pafajshëm është shumë më ngushëllues për një grua të viktimizuar, se sa dijenia që një fëmijë i pafajshëm vdiq në përpjekjet e dështuara për të pakësuar traumën e shkaktuar.

## I ngjizur nga incesti

Incesti është një krim i tmerrshëm. Shkaktarët duhet të dënohen si kriminelë dhe duhet bërë ndërhyrje e menjëhershme për ta hequr vajzën nga prania e familjarit, që ka abuzuar me të. Abuzuesi—*jo* vajza dhe as fëmija i saj—është problemi. Ndërhyrja, mbrojtja dhe ndihma e vazhdueshme personale ndaj vajzës—jo vrasja e një fëmije të pafajshëm—është zgjidhja. Pavarësisht asaj që besojnë shumica, deformimet e fetusit janë të rralla në raste të tilla. Edhe nëse fëmija del me probleme, përsëri meriton të jetojë.

Pse duhet që Personi A të vritet, sepse Personi B përdhunoi apo abuzoi seksualisht nënën e Personit A? Nëse babai juaj ka bërë një krim, mos duhet që ju si fëmijë të shkoni në burg për të? Nëse një ditë zbuloni që babai juaj biologjik ka përdhunuar nënën tuaj, a do të ndjeheshit sikur nuk keni më asnjë të drejtë të jetoni? Njëherë një grua që më kishte dëgjuar në lidhje me këtë çështje, erdhi më takoi më pas duke qarë me dënesë: “Nënën time e përdhunuan kur ishte 13 vjeçe. Pasi më lindi më dha për birësim. Sa herë që dëgjoj njerëzit të thonë se aborti është i drejtë në rastet e përdhunimit, kam menduar: ‘Nuk kam të drejtë të jetoj.’”

Le të dënojmë përdhunuesin dhe abuzuesin dhe jo viktimat e tyre. Gruaja nuk është mall i çuar dëm—ajo nuk është aspak një “plaçkë”, por një qenie e çmuar njerëzore me vlerë dhe dinjitet, që as veprimi më i ulët nuk mund t’ia zhvlerësojë. Në të njëjtën mënyrë, edhe fëmija nuk është një kancer që duhet hequr, por një qenie njerëzore që duhet të jetojë.

## Aborti shton traumën e përdhunimit

Feministet për jetën thonë: “Disa gra kanë treguar se i kanë vuajtur traumat e abortit edhe për shumë kohë pasi trauma e përdhunimit ishte zbehur.”[7] Vështirë te medosh një terapi më të keqe për një grua të përdhunuar se sa ndjenja e fajit dhe shqetësimet që ka lejuar vrasjen e fëmijës së saj. Një ditë ajo do ta kuptojë—por ata që e këshilluan të bënte abort nuk do të jenë aty për ta ndihmuar në dhimbjen e ndjenjën e fajit të saj.

Në librin e tij *"Viktimat dhe Fitimtarët"*, Dejvid Rirdon dhe bashkëpunëtorët e tij, sjellin dëshmitë e 192 grave, që kishin mbetur shtatzënë për shkak të përdhunimit dhe incestit, dhe të 55 fëmijëve të konceptuar si rezultat i këtyre agresioneve. Doli qartë se kur viktimat e dhunës flasin për veten, opinioni mbi abortin është pothuajse unanim—dhe është saktësisht e kundërta e asaj që mund të parashikojë shumica.

Pothuajse të gjitha gratë e intervistuara në këtë anketim të shkurtër thanë se ishin penduar që kishin abortuar fëmijët e ngjizur si pasojë e përdhunimit dhe incestit. Nga ato që dhanë opinionet e tyre, mbi 90%, pohuan se nuk do t'i nxisnin viktimat e tjera të dhunës seksuale për të kryer abort. Nga ana tjetër, midis grave që kishin zgjedhur ta çonin shtatzëninë deri në fund dhe ta lindnin fëmijën, edhe pse ishte fryt i përdhunimit dhe incestit, asnjëra nuk ishte penduar për zgjedhjen që kishte bërë.[8]

Po të shihet mirë, ka një paralele ngjashmërie midis përdhunimit dhe abortit. Të dyja kryhen nga një person shumë më i fuqishëm në kurriz të një tjetri më të dobët.

Aborti nuk sjell shërim tek viktima e përdhunimit. Të vendosësh dënimin kapital mbi një fëmijë të pafajshëm, edhe pse i një krimineli, nuk i bën asnjë të keqe këtij të fundit, për më tepër nuk i sjell asgjë të mirë gruas.

Të bësh një viktimë të dytë, asnjëherë nuk e zhbën dëmin e pësuar nga viktima e parë.



# Pjesa 4

# Çështje të tjera të rëndësishme

# 14

## Po rastet e fëmijëve të padëshiruar apo me aftësi të kufizuara ?

Disa argumentojnë: "Është mizore që të lejohet një fëmijë me aftësi të kufizuara të lindë për të jetuar një jetë pa kuptim dhe fatkeqe." Por çfarë do të mendonin këta fëmijë për jetët e tyre? Kur u pyetën disa pacientë nëse paaftësia e tyre ua kishte bërë jetën pa kuptim dhe nëse do të ishte në dorë të tyre, a do kishin zgjedhur të vdisnin pas lindjes. Përgjigjja e tyre unanime ishte e fortë. Patjetër që ata duan të jetojnë! Madje ata e quajtën pyetjen krejtësisht qesharake."[1]

Dëgjova një përkrahës pro-zgjedhjes, që fliste për një fëmijë handikap në gjendje të rëndë: "A duhet lejuar një grua që të sjellë në jetë një përbindësh?" Vetëm duke përdorur këto fjalë ne gënjejmë veten duke i besuar. Termi *vegjetorë* është një fjalë tjetër e përhapur që i atribuohet njerëzve me dizavantazhe. Një terminologji e tillë i çnjerëzon ata në sytë tanë, por nuk ndryshon qenien e tyre të vërtetë.

Një mollë e nxirë mbetet sërish mollë; Një qen i verbër mbetet po prapë qen; Një grua në moshë të thyer mbetet po grua; Një fëmijë me aftësi të kufizuara është po prapë fëmijë. Natyra e një personi dhe vlera e tij nuk ndryshohet për shkak të një handikapi.

Disa doktorë rekomandojnë "Ndërprerjen e shtatzënisë" nëse historia gjenetike e një çifti tregon rrezik për anomali. Testi standard për të dalluar deformimet bëhet përmes amniocentezës. Në vitin 2000, Raporti Kombëtar i Statistikave Jetësore tregonte se 28.9

gra në 1000 kanë vuajtur nga komplikacionet e amniocentezës, duke mbartur rrezikun 3 në 100 gra.[2] Qendra e Kontrollit për Sëmundshmërinë vlerëson se në amniocentezën e hershme shkalla e vdekshmërisë së të palindurit përmes abortit është “midis 1 në 400 dhe 1 në 200 procedura”. Studimi ka zbuluar habitshëm rritjen me dhjetëfish të rrezikut të keqformimit të këmbëve pas amniocentezës së hershme.[3] Ironikisht, procedura e projektuar për të identifikuar deformimet e fetusit mbart rrezikun për ta shkaktuar këtë.

Amniocenteza shpesh kryhet që të identifikojë fëmijët me sindromën Daun, që prindërit të kenë mundësi zgjedhjeje për abort. Rreziku i dështimit si rezultat i amniocentezës është po aq i madh sa rreziku që mbart sindroma Daun.[4]

## Skizofrenia e shoqërisë sonë

Një anketim me mjekë pediatër dhe kirurgë pediatër ka zbuluar se më shumë se dy në tre mjekë, do të refuzonin operacionin e shpëtimit të jetës për një fëmijë me sindromën Daun. Nga njëra anë, ne përpiqemi të sigurojmë kushte të veçanta parkimi dhe ashensorësh për njerëzit me aftësi të kufizuara. Flasim me ndjeshmëri kur shohim në ndonjë poster fëmijë me sindromën Daun apo me spina bifida... Sponsorizojmë Lojra Olimpike të veçantë dhe bëjmë tifozllëk për konkurrentët, duke folur për ngazëllimin dhe frymëzimin që vetë ata na e përcjellin. Por kur dëgjojmë që një grua është shtatzënë me një nga këta fëmijë, themi: “Më mirë vrite!”

Vlen të theksohet se “Nuk ka pasur asnjëherë ndonjë organizim të prindërve të fëmijëve me zhvillim të vonuar mendor, që të ketë përkrahur abortin.”[5]

Mendo sikur fëmija yt 6-vjeçar të bëhet i verbër apo paraplegjik. Ai është kthyer tashmë në barrë. Rritja e tij/saj kushton, është e papërshtatshme dhe e vështirë edhe për shëndetin tënd mendor. Por a do të vendosje që ai të vdiste? Nëse do të miratohej ndonjë ligj që ligjëron vdekjen e fëmijëve të tillë, a do ta bëje? Nëse jo, pse?

Ti nuk do ta kishe vrarë fëmijën tënd me aftësi të kufizuara, *sepse e njeh*. Por të vrasësh fëmijën e palindur, sepse nuk e ke marrë në krahë dhe nuk e ke dëgjuar të qajë nuk e ndryshon vlerën dhe nuk e pakëson humbjene tij. Jepi vetes një shans për të njohur fëmijën tënd, dhe Ti ke për ta *dashur* atë.

Po për fëmijën anencefalik që nuk ka një tru të zhvilluar plotësisht? Meqë vdekja e tij është e pashmangshme, shpesh doktorët këshillojnë prindërit për të bërë abort. Por është një gjë që të dish se fëmija yt mund të vdesë dhe krejt tjetër gjë të vendosësh t'i marrësh jetën. Shumë familje kanë pasur momente të papërshkrueshme duke i njohur, duke u vënë emrin apo duke i mbajtur në krahë dhe duke u kujdesur për fëmijët anencefalikë pasi kanë lindur. Kur ata të ndahen nga jeta, prindërit do të ndiejnë pikëllimin e vdekjes së natyrshme të një anëtari të familjes. Ky pikëllim është në kontrast të plotë me hidhërimin e pashëndetshëm dhe ndjenjën e fajit që vjen nga mohimi i të drejtës së një bebeje për të qenë pjesë e familjes, duke i marrë jetën.

Cilësia e një shoqërie përcaktohet gjërësisht nga mënyra si i trajton anëtarët e saj më të dobët. Vrasjen e të pafajshmit nuk e justifikon dot me pretendimin se i liron njerëzit nga barra. Nuk është zgjidhje të shkaktosh vuajtjen mbi një person, vetëm për t'ia hequr një tjetri këtë barrë. Aborti i fëmijëve për shkak të aftësive të tyre të kufizuara, rrezikon jetën e të gjithë njerëzve të tillë në shoqërinë njerëzore.

## Barra e të qenët i padëshiruar

Planifikimi Prindëror tregon se fëmijët e padëshiruar "marrin nota më të ulëta, sidomos në aftësitë gjuhësore". Thuhet se adoleshentët e padëshiruar "shfaqin rezultate gjithnjë e më të dobëta në shkollë" dhe janë "më pak të prirur të përmirësohen nën presionin e shkollës." Dhe "më pak se gjysma e tyre, krahasuar me fëmijët e dëshiruar, kanë gjasa të vazhdojnë arsimin e lartë."[6]

Nuk e vë në dyshim saktësinë e këtyre përfundimeve. Por ato na tregojnë se duhet të dimë rëndësinë e të dashurit të fëmijëve

tanë. E megjithatë, përkrahësit e pro-zgjedhjes i përdorin kërkime të tilla për të justifikuar abortin për "të padëshiruarit".

Ka shtatzëni të padëshiruara, por *nuk ka fëmijë të padëshiruar.* Ndërkohë që disa njerëz nuk i duan këta fëmijë, të tjerë dëshpërimisht janë duke i kërkuar dhe dëshiruar gjithë jetën.

Afërsisht 1.3 milion familje amerikane duan të birësojnë, disa prej të cilëve, aq shumë e duan këtë gjë sa mungesa e tyre bëhet burim i depresionit të madh. Ka një kërkesë aq të lartë për fëmijë në ditët e sotme sa në tregun e zi mund të gjesh edhe bebe me çmim prej $50,000. Jo vetëm bebet "normale" janë të kërkuara, shumë njerëz kërkojnë t'u vijnë në ndihmë duke i rritur me dashurinë e një familjeje bebet me nevoja të veçanta, duke përfshirë edhe ato me sindromën Daun apo spina bifida.[7]

Shumë fëmijë që në fillim janë të padëshiruar për nënat e tyre, më pas bëhen të çmuar në shtatzënitë e mëvonshme deri në lindjen e tyre. Fatkeqësisht, shumë gra që do ta kishin dashur fëmijën në muajin e gjashtë të shtatzënisë abortojnë në muajin e tretë.

Veç kësaj, shumë fëmijë që dëshirohen në lindje, *nuk* janë të dëshirueshëm kur qajnë në dy të natës gjashtë javë më vonë.A duhet të vazhdojë akoma të përcaktohet fati i një fëmije, nëse meriton të jetojë apo jo, nga dëshira ose mosdëshira e prindërve për të patur fëmijë? Nëse ky është standardi i ligjëruar para lindjes, atëherë përse të mos jetë dhe më pas?

Çështja e të mosdashurit është argument i fortë për të diskutuar dëshirën pë të patur fëmijë. Por është argument i dobët dhe i pamjaftueshëm për t'i vrarë ata.

Një prej aspekteve më çorientues të debatit pro-zgjedhjes është ta paraqesin abortin si diçka që është në interesin më të mirë të bebes. Kjo është aq absurde sa të bën të qeshësh me dhimbje. Një person i vogël është copëtuar kockë pas kocke "për të mirën e *tij*"? Po njësoj, pronarët e skllevërve argumentonin se skllavëria ishte në interesin më të lartë të zezakëve. (Me kë po tallemi ne?)

Njerëzit thonë: "Nuk mund ta mbaj këtë fëmijë se nuk i jap dot një jetë të mirë" Dhe cila është zgjidhja e pamundësisë për t'i ofruar një jetë të mirë? T'ia heqësh për fare jetën që ka?

# Çdo fëmijë është i dëshiruar

*I padëshiruar* nuk përshkruan fëmijën, por një qëndrim të disa të rriturve karshi tij. Çështja e vërtetë nuk ka të bëjë me fëmijët e padëshiruar, por me mosdashjen e të rriturve.

"Të duash" është thjesht ndjenja subjektive dhe e ndryshueshme e një personi karshi një tjetri. Fëmija i "padëshiruar" është një person i vërtetë pavarësisht ndjenjave që të tjerët kanë karshi tij. Vlera e një gruaje dikur është gjykuar nga fakti nëse një mashkull e donte. Vlera e një fëmije sot gjykohet nga fakti nëse e do nëna e tij. Të dyja rastet janë padrejtësi tragjike. Slogani i panifikimit prindëror "Çdo fëmijë, një fëmijë i dëshiruar" është diçka për të cilën të gjithë duhet të biem dakord. Nuk biem dakord në mënyrën si duhet mbyllur fjalia. Si mendon *ti* se duhet mbyllur?

Çdo fëmijë, një fëmijë i dëshiruar, ndaj... le t'u japim vendin e tyre në shtëpinë që e hap derën për ta dhe le të mësojmë t'i duam më shumë.

- Çdo fëmijë, një fëmijë i dëshiruar, ndaj... le të zbulojmë fëmijët e padëshiruar para se ata të lindin dhe t'i vrasim me abort.

- Gjithkush bie dakord që fëmijët duhen dashur. E vetmja pyetje që na shqetëson: "A duhet të çlirohemi nga fëmijët *e padëshiruar* apo nga *fëmijët* në përgjithësi?

Kur vjen fjala për fëmijët e palindur, pozicioni i të drejtave të abortit reflektohet në një slogan tjetër krejtësisht të ndryshëm, që të vret sytë në një afishe: "Çdo fëmijë i padëshiruar, një fëmijë i vdekur."

# 15

## A e parandalon aborti abuzimin e fëmijës?

Një vajzë adoleshente lindi një fëmijë në motelin e qytezës Delauer. Së bashku me të dashurin e vendosën beben e sapolindur ende të gjallë në një qese plastike dhe e hodhën në kazanin e plehrave. Një nënë e re shtatëmbëdhjetë vjeçare, që po shkonte në shkollën e natës, e hodhi fëmijën e vet në lumë, sepse nuk kishte mundësi të kujdesej për të dhe nuk po gjente dot një dado. Histori të tilla ka pa fund.

Në vitin 1973, kur u legalizua fillimisht aborti, rastet e abuzimit ndaj fëmijëve në SHBA vlerësoheshin në 167.000 në vit.[1] Sipas Departamentit Amerikan të Shëndetit dhe Shërbimit Njerëzor përafërsisht 903.000 fëmijë ishin viktima të abuzimit deri në vitin 2001, një numër pesë herë më i lartë.[2]

Rritja e abuzimit ndaj fëmijëve bëhet më dramatike me vrasjen e 45 milionë fëmijëve amerikanë përmes abortit (dhe një numër i panjohur vrasjesh përmes aborteve kimike), të cilat nuk llogariten si viktima të abuzimit. Sërish aborti është abuzimi më i hershëm ndaj fëmijës dhe më i tmerrshmi me pasojë vdekjen. Argumenti që aborti parandalon abuzimin ndaj fëmijës, është po aq i vërtetë sa ç'është argumenti që vrasja e një gruaje parandalon abuzimin ndaj saj. Njerëzit e vdekur nuk mund të bëhen më objekt abuzimi, por parandalimi i abuzimit ndaj tyre duke i vrarë, është logjikë e vështirë për t'u rrokur.

Po përse abuzimi ndaj fëmijëve është rritur edhe më shumë pas

ligjërimit të abortit? Sepse *aborti vetëm sa ka ndryshuar mënyrën tonë të të menduarit për fëmijët.*

## Çfarë thonë studimet

Argumenti i pro-zgjedhjes se "ekzistenca e më shumë fëmijëve të padëshiruar çon në më shumë fëmijë të abuzuar" bie ndesh me studimet e bëra në lidhje me këtë realitet.

Profesor Eduard Lenoski në Universitetin Jugor të Kalifornisë realizoi një studim referues me 674 fëmijë të abuzuar. Ai zbuloi se 91% e prindërve, që pranuan faktin e abuzimit, donin të kishin fëmijë.[3] Argumenti i pro-zgjedhjes se fëmijët e padëshiruar janë të destinuar të bëhen objekt i abuzimit nga prindërit e tyre mund të tingëllojë logjik, por studimet më të mira të kryera në bazë të të dhënave tregon që të jetë i rremë.

"Studimet tregojnë se abuzimi i fëmijëve ndeshet më shumë tek nënat, që kanë kryer një abort."[4] Studimet e dr. Filip Neit tregojnë se kjo vjen pjesërisht për shkak të ndjenjës së fajit dhe depresionit të shkaktuar nga aborti, çka vështirëson aftësinë e nënës për të krijuar një lidhje të shëndetshme me fëmijët e ardhshëm.[5] Ai dokumenton se aborti ul aftësinë e natyrshme të vetëkontrollit të prindërve përkundrejt ndjenjave të zemërimit ndaj fëmijëve të vegjël.[6]

Të dy prindërit, si nëna dhe babai, shtypin impulsin e tyre natyral për t'u kujdesur për një fëmijë të pambrojtur në momentin kur zgjedhin abortin. Duke e ruajtur të shtypur këtë instikt ata bëhen më pak efektivë në kontrollin e ndjenjave negative ndaj të sapolindurit që ka nevojë për mbrojtje,për të qarën e fëmijës, që po rritet apo sjelljen kundërshtuese të një parashkollori.[7]

Qëndrimi që çon në abort është saktësisht i njëjtë me atë që çon në abuzimin e fëmijës. Gjithashtu, edhe nëse nëna nuk kryen abort, vjen një moment që ajo të mendojë para fëmijës së saj të vështirë tre vjeçar: "duhej ta kisha abortuar". Fëmija i detyrohet nënës në gjithçka, ndërsa ajo nuk i detyrohet atij kurrgjë. Kjo kërkon shumë durim deri në sakrificë prindërore. Qoftë edhe në subkoshiencë, arsyetimi është i pashmangshëm: Nëse kisha të

drejtë ta vrisja fëmijën para se të lindë, kam po aq të drejtë t'i jap ndonjë shuplakë ndërsa rritet.

Nga pesë mijë fëmijët që vdesin çdo vit në të gjithë Amerikën (pa përfshirë këtu abortet), 95% e tyre janë vrarë nga njëri ose nga të dy prindërit.[8] Ekziston një koncept që po përhapet gjithmonë e më tepër se fëmija u takon prindërve të tij. Duke qenë se Shoqëria i siguron të rriturit se kanë të drejtë të heqin qafe fëmijët e tyre të palindur, këta prindër vazhdojnë të mendojnë se vazhdojnë ta kenë po atë të drejtë edhe më vonë. Në një kohë që mentaliteti mbi abuzimin e fëmijës e mbërthen një shoqëri, kjo nuk e kufizon atë kundrejt vetëm një grupmoshe të caktuar. Nëse fëmijët e palindur nuk janë të sigurtë, atëherë asnjë fëmijë tjetër nuk është i sigurtë.

Pitër Singër thotë:

> "Mungon çdo lloj kufiri i qartë mes foshnjës së sapolindur, që në sensin domethënës etik nuk është një person, dhe fëmijës së rritur që mund të quhet i tillë. Në librin *A duhet të jetojë një bebe?* së bashku me kolegen time, Helga Këhs, sugjerojmë se mund të lejohet një periudhë prej 28 ditësh pas lindjes së fëmijës që ai të konsiderohet i pranueshëm me të gjitha të drejtat për jetën si të tjerët."[9]

Fëmijët marrin të drejtën për jetë vetëm në ditën e njëzet e tetë pas lindjes? Po pse të mos presim më mirë gjashtë muaj? Apo gjashtë vjet? Të vrasësh një fëmijë pesë, dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjeçar është thjesht një abort i paslindjes, apo s'është kështu? Ashtu siç tregoi Singër, në momentin që ti vendos se është e drejtë të vrasësh një person, logjikisht dera hapet tërësisht për ta vrarë të njëjtin person në çdo moshë, dhe për arsye të ndryshme.

Zgjidhja për fëmijët e dhunuar paslindjes, nuk është vrasja e tyre kur janë ende në mitër. Zgjidhja e abuzimit të fëmijës nuk është abuzimi me të në fazat më të hershme. Zgjidhja është të mos abuzosh asnjëherë.

# 16

## Personalisht kundërshtoj abortin, por jam pro-zgjedhjes?

Shumë njerëz thonë: "Nuk jam pro abortit, por jam pro-zgjedhjes." Po si do t'i përgjigjeshit dikujt që thotë: "Nuk jam pro përdhunimit, por jam pro zgjedhjes së përdhunimit?" Pozicioni i këtij personi nuk përfshin përdhunimin si proces lëndues, ndaj dhe duket ndonjëherë e justifikueshme. Mund t'i përgjigjeshit: "Të jesh pro zgjedhjes së përdhunimit *është* të jesh pro-përdhunimit.'

Në po të njëjtën mënyrë, të jesh pro-zgjedhjes për abortin është të jesh pro abortit.

Në pamje të parë, ky slogan duket se ka kuptim: "Kundër Abortit? S'kam bërë asnjëherë.' Ky arsyetim zbatohet shumë mirë për fluturimin e avionëve, lojën e futbollit ose konsumimin e picës, por jo për përdhunimin, torturën, rrëmbimin apo vrasjen.

### Një pozicion i mesëm?

Disa mendojnë se të dalësh personalisht kundër abortit, por duke besuar njëkohësisht se njerëzit e tjerë kanë të drejtë të zgjedhin abortin, është një lloj kompromisi midis pro-abortit dhe pozicionit të pro-jetës. Por nuk është kështu. Përkrahësit e pro-zgjedhjes votojnë njësoj si njerëzit pro-abortit. Për një foshnjë, që i hiqet e drejta e jetës, nuk ka asnjë ndryshim nëse njerëzit që kanë refuzuar ta mbrojnë ishin pro-abortit apo "thjesht" pro-zgjedhjes për abortin.

E vetmja arsye e duhur për të kundërshtuar abortin, është po ajo arsye që na detyron t'i kundërshtojmë *të tjerët* që e kryejnë atë,—vrasja e fëmijës. Të jesh personalisht kundër abortit dhe nga ana tjetër të favorizosh të drejtën e çdokujt të kryejë abort është vetë kontradiktore. Është njësoj si të thuash: "Kam bindjen që fëmija nuk duhet abuzuar, por e mbroj të drejtën e fqinjit tim të abuzojë fëmijën e vet nëse kjo është zgjedhja e tij.", ose "Jam kundër skllavërisë, por nëse të tjerët duan të kenë skllevër është puna e tyre.", ose "Jam kundër rrahjes dhe abuzimit ndaj gruas, por nuk dua t'u imponoj moralin tim të tjerëve, ndaj jam pro-zgjedhjes së dhunës ndaj grave."

Njëherë, një folëse në një program në radio, më tregoi se ndihej e fyer që disa njerëz e quanin "pro-abortit", ndërsa ajo e quante veten "pro-zgjedhjes". Gjatë trasmetimit e pyeta: "Pse nuk do të të quajnë 'pro abortit? A ka ndonjë gjë që nuk shkon me abortin?" Ajo u përgjigj: "Aborti është i rëndë. Puna është se asnjë nuk dëshiron të kryejë një abort." Ia ktheva: "Nuk po të kuptoj. Çfarë e bën abortin të ashpër e të rëndë? Dhe përse mendon se njerëzit nuk e duan abortin?" Ajo tha në pasion e sipër: "Epo e dini, është e rëndë të vrasësh foshnjën tënde!"

Në momentin që i doli kjo nga goja, e kuptoi çfarë tha drejtpërdrejt në transmetim, por ishte shumë vonë. Në një moment të pakontrolluar, ajo tregoi në fakt se ç'mendonte në të vërtetë, atë që *gjithsecili* e mendon nëse do ta pranonte si kjo grua: *Aborti është po aq i vështirë sa dhe i gabuar*—sepse do të thotë të vrasësh një fëmijë.

Dhe nuk ka asnjë arsye që të justifikojë vrasjen e një fëmije.

# 17

## Po në lidhje me birësimin?

Një prej ironive më të mëdha të lëvizjes pro-zgjedhjes është ideja e ushqyer, sipas së cilës gratë nuk kanë zgjedhje tjetër veç abortit. Kjo lëvizje mund të quhej ndryshe s'ka-zgjedhje-përveç-abortit. Shumë gra mund të dëshmojnë që për to "pro–zgjedhjes" do të thoshte "asnjë zgjedhje tjetër".

Etërit, nënat, të dashurit, burrat, mësuesit, këshilluesit, doktorët, infermierët, mediat dhe bashkëmoshatarët shpesh bëjnë presion mbi gruan shtatzënë që të bëjnë të vetmen zgjedhje që ndërgjegjja e saj i tregon se është e gabuar, një zgjedhje që është më tepër e të tjerëve se e saja. (Po ku do të jenë të gjithë *këta* kur ajo të ketë kuptuar se çfarë ka bërë në të vërtetë?)

A e duan në të vërtetë gratë abortin? Frederika Methjuës-Grin, ish-presidentja e Feministëve për jetën thotë: "Asnjë nuk e dëshiron abortin ashtu siç do të dëshironte një akullore apo një makinë të tipit Porsh. Ajo e do abortin siç do një kafshë e zënë në grackë, që për t'u liruar, këput me dhëmbë këmbën e vet. Aborti është një përpjekje tragjike për t'i shpëtuar një situate të dëshpëruar përmes një veprimi dhune dhe humbjeje të vetevetes."[1]

Aborti nuk është zgjedhja e lirë aq sa është zgjidhja e fundit. Shumë gra do të zgjidhnin të mos bënin abort nëse do të kishin mbështetjen emocionale dhe financiare që kanë nevojë.

Afërsisht dy të tretat e grave, që kanë abortuar e përshkruajnë veten si "të shtyra për të abortuar për shkak të rrethanave të

veçanta... mbi 84% e tyre deklarojnë se do t'i kishin mbajtur fëmijët nëse këto rrethana do të kishin qenë më të mira."[2]

## Alternativa e përmendur rrallë

Këshilli Kombëtar i Birësimit vlerëson 1.3 milion çifte, që janë në pritje të birësimit të një fëmije.[3] Ndërkohë që çdo vit 1.3 milion fëmijë vriten përmes abortit, më pak se 50.000 fëmijë janë dhënë për birësim. Kjo do të thotë se për çdo fëmijë të mundshëm për birësim, tridhjetë të tjerë janë vrarë. Për çdo çift që birëson, 40 të tjerë do jenë në pritje të gjatë.[4]

Në një shoqëri që vlerëson zgjedhjen, pse të mos jenë doktorët, shkollat, klinikat e planifikimit familjar dhe klinikat e abortit ato që do t'u paraqesin grave faktet mbi *gjithë* zgjedhjet e mundshme, duke përfshirë edhe birësimin? Një mik na tha njëherë: "Kur kam punuar si këshillues në një klinikë aborti, isha plotësisht i painformuar mbi alternativat e tij. Nuk kam rekomanduar asnjëherë mbajtjen e fëmijës apo dhënien e tij për birësim. Isha tërësisht i pandërgjegjësuar mbi faktet mjekësore duke përfshirë këtu edhe zhvillimin e fetusit. Nuk isha trajnuar në asnjë rast mbi çështje faktike—e vetmja gjë që duhej të bëja ishte të sigurohesha që gruaja të kryente procesin e abortit."

Me këtë lloj "këshillimi" sa gra do zgjedhin diçka tjetër veç abortit? Ish-pronarë dhe punonjës të klinikave të aborteve kanë deklaruar se kishte qenë puna e tyre "të shisnin aborte" për gratë shtatzëna. Disa klinika madje punësojnë ekspertë në marketing për të trajnuar stafin në tregtinë e abortit.[5]

Birësimi është një alternativë pozitive që të shkarkon nga përgjegjësia e të rriturit të një fëmije ndërkohë që shpëton një jetë dhe bën një familje tjetër të lumtur. Është tragjike që birësimi zgjidhet kaq rrallë, madje edhe ofrohet shumë rrallë si alternativë ndaj abortit.

Studime të bëra nga qendrat për kujdesin ndaj grave shtatzëna tregojnë se rezistenca ndaj birësimit është pengesa më e zakonshme që shfaqet tek gratë që anojnë nga aborti.[6] Arsyeja pse birësimi mund të duket i dhimbshëm është e njëjtë me arsyen pse aborti

është shkatërrues,—në të dyja rastet ka të bëjë me një jetë njerëzore.

Birësimi shpesh përshkruhet si një aspekt negativ në literaturat e pro-zgjedhjes. Përkrahësit e pro-zgjedhjes Karol Endersën dhe Li Kempbëll thonë mbi birësimin: "Ndarja e panevojshme midis nënës dhe fëmijës është një dënim mizor, por fatkeqësisht i zakonshëm, që mund të zgjasë për gjithë jetën."[7]

Ndërsa e quajnë birësimin mizor, këta harrojnë ndjenjën e fajit që gruaja e vuan për gjithë jetën pasi kupton se ka vrarë fëmijën e saj përmes abortit. Birësimi zor se mund të konsiderohet dënim për një grua që nuk mund të rrisë fëmijën e saj. Edhe pse mund të tingëllojë e ashpër, është një alternativë e dërguar prej qiellit.

Ka shumë burime të shkëlqyeshme rreth birësimit që mund të gjenden përmes internetit,[8] ashtu si edhe përmes *Enciklopedisë së birësimit,* e cila përmbledh mbi katërqind artikuj informativë mbi çdo aspekt të birësimit.[9] Ne u jemi borxhli grave shtatzëna dhe fëmijëve që ato mbajnë për t'i informuar mbi birësimin.

## Aborti grabit familjet që mezi presin të birësojnë fëmijë

Duke e çuar shtatzëninë deri në muajin e nëntë, një grua e re pranon përgjegjësitë e zgjedhjeve të saj. Ajo rritet dhe tregon pjekuri. Kjo grua mund të hedhë sytë pas në kohë dhe të ndiejë krenari dhe kënaqësi për zgjedhjen e bërë, duke e lejuar fëmijën jo vetëm të jetojë, por edhe të jetë pjesëtar i një familjeje të mirë. Sigurisht që birësimi është vetëm një alternativë, sepse një grua mund të zgjedhë ta mbajë fëmijën dhe ta rrisë vetë. Të dyja zgjedhjet janë të drejta.

Disa mund të pyesin: "Çfarë nëne do të isha, nëse do e jepja fëmijën tim për birësim?" Ironia qëndron në faktin që një nënë që nuk mund ta japë fëmijën e vet për birësim, sepse është tepër i çmuar për të, si mundet ta vrasë? Pyetja që duhet bërë nuk është: "Si mund ta jap fëmijën tim për birësim?", por "Si mund ta vras fëmijën tim përmes abortit?" Edhe pse ajo nuk mund të jetë në

gjendje të mbajë fëmijën e saj, nuk mund ta shohë që ka të tjerë që mund të kujdesen dhe ta duan këtë fëmijë? Fatkeqësisht edhe kjo nuk është e thjeshtë.

Gruaja dëshiron që momenti i saj i krizës të mbarojë sa më shpejt, ndërkohë që birësimi duket sikur e lë situatën të pazgjidhur "me pasiguri dhe ndjenja faji për aq kohë sa ajo ka para vetes fëmijën që po rritet."[10] Kjo mund ta bëjë të ndihet sikur nuk është në gjendje të jetë nënë, aq më tepër një nënë e keqe, duke ua dhënë fëmijën e saj disa të huajve. Shqetësimi që e ka braktisur fëmijën apo mundësia që ata që e kanë birësuar po abuzojnë mbi të, mund të kalojë përmes qenies së saj. Arsyeja këtu është bazuar në një mendim të dëshiruar se, nëse do ta kishte abortuar, fëmija nuk do të ishte një fëmijë tani dhe ajo nuk do të ishte bërë asnjëherë nënë. Sigurisht që në realitet nuk është në dorën e saj nëse do të bëhet ose jo nënë apo nëse fëmija i saj është i vërtetë—të dyja janë fakte të pandryshueshme. Fëmija i saj *është* i vërtetë, prandaj dhe ajo *është* nënë. E vetmja pyetje që mund të shtrohet është "Çfarë do të bëjë ajo si nënë me fëmijën e saj?

Mungesa e lidhjes së fortë midis asaj dhe fëmijës mund ta bëjë birësimin më të lehtë si zgjidhje, ndërkohë që shkëputja me fëmijën pas lindjes mund të jetë emocionalisht e vështirë. Por jeta e fëmijës është njësoj reale si para lidhjes, po aq edhe pas saj. Gruaja vendoset para tri zgjedhjeve: ta mbajë fëmijën dhe ta rrisë, ta lindë dhe t'ia japë një familjeje tjetër ta rrisë ose ta vrasë. Edhe pse aborti shpesh duket më joshës, përfundimisht është më shkatërrues.

Duhet t'i ndihmojmë vajzat e reja që ta shohin rritjen e fëmijës, birësimin dhe abortin ashtu siç janë në të vërtetë. Duhet ta përshkruajmë birësimin si një zgjedhje të guximshme, një mundësi që do t'i japë fëmijës jetën për të jetuar dhe një familje për ta rritur.

Adoleshentja shtatzënë që ne e pranuam në shtëpinë tonë kishte pasur më parë edhe dy aborte të tjerë. Gjatë qëndrimit me ne, ajo vendosi ta lindte dhe ta jepte foshnjën për birësim. Nuk ishte e lehtë, por kjo vajzë e mrekullueshme kohë më vonë më tregoi: "Kur kthej kokën pas, kujtoj tri fëmijët që nuk munda t'i kisha, por me ndjenja krejt të ndryshme. Dy abortet e para më mbushin

me hidhërim dhe pendesë. Kur mendoj për të tretin, që e dhashë për birësim, mbushem me gëzim, sepse e di që po rritet në një familje që e do."

Komuniteti i Krishterë duhet të bëjë përpjekje të bashkërenduara për ta prishur këtë shtrembërim negativ mbi birësimin. Duhet të flasim për të me pozitivitet dhe të tregojmë respekt të veçantë për ato vajza të reja shtatzëna, që e mbajnë fëmijën për ta lindur dhe për ta dhënë për birësim. Duhet patjetër të nderojmë prindërit birësues dhe të bekojmë fëmijët e birësuar. Duhet t'i bëjmë të qarta burimet e shkëqyera të birësimit dhe të festojmë rastet e tij në kishat tona. Duke bërë kështu, mund t'i ndihmojmë gratë e reja të kuptojnë se birësimi është një zgjedhje e guximshme dhe ajo për të cilën të dy do të jenë thellësisht mirënjohës në të ardhmen.

Pro-zgjedhja përfundon shpesh pa asnjë zgjedhje ose në zgjedhje të dobëta. Por birësimi ofron një zgjedhje të mençur, përdëllyese dhe më të mirën e *çdokujt*.



# Pjesa 5

# Perspektiva dhe mundësitë shpirtërore

# 18

## A mund t'i falë Perëndia abortet?

Miliona gra dhe burra në shoqërinë e krishterë dhe jo të krishterë vuajnë sot nën ndjenjën e fajit për shkak të abortit. Ashtu siç e pamë edhe në kapitullin e parë, dy të tretat e atyre që abortojnë e identifikojnë veten si protestantë ose katolikë. Ndërkohë që afërsisht një në pesë gra identifikohen si të krishtera ungjillore.[1] Shumë prej etërve të këtyre fëmijëve janë pjesë e kishave tona.

Nëse je një grua që ke abortuar apo këshillon dikë të abortojë, ky kapitull është veç për ty. Nëse je një burrë i përfshirë në vendimin për abortin—pavarësisht në çfarë pozicioni je, i dashuri, bashkëshorti, vëllai apo dikush tjetër—ky kapitull është edhe për ty.

Përpjekja për të eleminuar ndjenjat e fajit pa u përballur me shkakun, është e padobishme. Disa mund të thonë: "Nuk ke pse të ndihesh në faj." Por ti vetë e di më mirë. Duke mohuar realitetin nuk arrin t'u shpëtosh ndjenjave të fajit. Mohimi të vë në një situatë kolapsi emocional në çdo moment kur përballesh me diçka që të sjell ndër mend fëmijën që dikur ke abortuar. Është e nevojshme një zgjidhje e qëndrueshme për problemin e fajit, të bazuar në realitet dhe jo në pretendime.

Do t'i drejtohem Biblës për citim duke qenë se ajo ofron një zgjidhje të tillë. Pyet drejtuesin e kishës, drejtuesen e grupit të grave ose një mik të krishterë apo të familjes që të të ndihmojë të kuptosh më mirë.

## Vepra e Krishtit

Lajmi i mirë është që Perëndia të do dhe dëshiron të të falë për abortin e kryer, pavarësisht situatës nëse ishe apo jo i vetëdijshëm për vendimin e marrë. Por, para se të vlerësohet ky lajm i mirë, duhet të marrim në konsideratë edhe lajmin e keq. Lajmi i keq është: "se ekziston faji i vërtetë moral dhe të gjithë ne jemi fajtorë për shumë shkelje morale të kryera kundër Perëndisë, dhe aborti është vetëm njëri prej tyre. "Të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë" (Romakëve 3:23).

Mëkati është humbja e standardit të shenjtë të Perëndisë, që na ndan nga një marrëdhënie me Të (Isaia 59:2) Mëkati na mashtron, duke na bërë të mendojmë se e gabuara është e drejtë dhe e drejta e gabuar. (Fjalët e Urta 14:12). "Pagesa e mëkatit është vdekja, por dhurata e Perëndisë është jeta e përjetshme në Krishtin Jezus, Zotin tonë." (Romakëve 6:23).

Jezus Krishti, Biri i Perëndisë, aq shumë na deshi sa u kthye dhe u bë një pjesëtar i racës njerëzore për të na çliruar nga problemi ynë i mëkatit (Gjoni 3:16) Ai u identifikua me ne në dobësitë tona, por pa rënë në mëkat (Hebrenjve 2:17–18; 4:15–16). Jezusi vdiq në kryq si i vetmi i denjë, që duhej të paguante për dënimin e mëkatit tonë të ndëshkuar nga shenjtëria e Perëndisë (2 Korintasve 5:21). Ai u ngrit nga varri, duke shkatërruar mëkatin dhe triumfuar mbi vdekjen. (1 Korintasve 15:3–4,54–57).

Kur Krishti vdiq në kryq në vendin tonë tha: "U krye!" (Gjoni 19:30). Fjala greke e përkthyer "u krye" është fjalë e përdorur në certifikatat e borxhit, pasi ato paguheshin. Do të thoshte: "E paguar plotësisht" Krishti vdiq për të paguar plotësisht borxhin tonë.

## Falje e plotë

Për shkak të veprës së Krishtit në kryq për ne, Perëndia na jep falas faljen. Ja disa prej këtyre dhuratave që na jepen:

*"Ai nuk na trajton siç e meritojnë mëkatet tona dhe nuk na dënon në bazë të fajeve tona. Sa larg është lindja nga perëndimi aq shumë ai ka larguar fajet tona. Ashtu si një baba që është i mëshirshëm me bijtë e tij, kështu është i mëshirshëm Zoti me ata që kanë frikë prej tij." (Psalmi 103:10, 12–13)*

*"Po t'i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na i falë dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi." (1 Gjonit 1:9)*

*"Tani pra, nuk ka asnjë dënim për ata që janë në Krishtin Jezus, që nuk ecin sipas mishit, por sipas Frymës." (Romakëve 8:1)*

## Një dhuratë që nuk mund të fitohet

Shpëtimi është dhuratë—"Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit dhe kjo nuk vjen nga ju, por është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush." (Efesianëve 2:8–9). Kjo dhuratë nuk fitohet duke punuar, nuk jepet për meritat dhe as për arritjet e tua. Madje as nuk varet nga përpjekjet apo meritat tona, por vetëm nga sakrifica e Krishtit për ne.

Perëndia na ofron dhuratën e faljes dhe jetën e përjetshme, por nuk bëhet automatikisht jona. Që ta kemi këtë dhuratë duhet më parë të vendosim ta pranojmë.

Ndoshta mund të mendosh: "Nuk e meritoj faljen pas gjithë atyre që kam bërë." Është e drejtë. Asnjë prej nesh nuk e meriton faljen, sepse, nëse do ta meritonim, nuk do të kishim nevojë për falje. Ky është momenti i mirësisë. Krishti mori në kryq dënimin që ne meritonim, që ne të marrim atë që nuk meritojmë—një jetë të re, një fillim të ri.

Me marrjen e faljes, ne mund të shohim vetëm përpara për ta kaluar përjetësinë me Krishtin dhe familjen tonë shpirtërore. (Gjoni 14:1–3; Zbulesa 20:11–22:6). Për t'u bashkuar në qiell

me gjithë të dashurit e tu, që janë mbuluar nga gjaku i Krishtit (1 Thesalonikasve 4:13–18).

## Mos jeto në mëkatet e kaluara

Një grua imorale qau dhe ia lau me lot këmbët Jezusit, ia puthi dhe ia fshiu me flokët e saj. Krishti i tha njërit prej të pranishmëve paragjykues: "Ndaj po të them se mëkatet e shumta të saj i janë falur, sepse ka dashur shumë" (Luka 7:47). Të njëjtën falje Jezusi e jep për të gjithë të tjerët.

Perëndia nuk do që jeta jote të kalojë nën ndjenjën e ndëshkimit për shkak të abortit të kryer apo edhe për çdo gjë tjetër të gabuar që ke bërë në jetë. Pjesa jote është të pranosh shlyerjen e bërë nga Krishti për ty dhe mospërsëritjen e mëkatit. Jezusi i tha gruas imorale: "Mëkatet e tua të janë falur... Besimi yt të shpëtoi, shko në paqe." (Luka 7:48, 50). Gratë e përjashtuara dhe të refuzuara nga shoqëria erdhën te Jezusi dhe ai i mirëpriti me dhembshuri dhe falje.

Nuk ka asnjë mëkat që të mos shlyhet nga mirësia e Perëndisë. Ai na ka parë në thellësinë e së keqes sonë dhe përsëri na do. Nuk ka asnjë kufi për mirësinë e tij të faljes dhe asnjë lloj lirie tjetër si liria e faljes.

Mund të ndihesh menjëherë i pastruar pas rrëfimit të mëkateve ose mund të kesh nevojë për ndihmë përmes këtij proçesi. Në të dyja rastet je i falur pa asnjë dyshim. Duhet të harrosh atë që lë pas vetes dhe të vazhdosh drejt një të ardhmeje pozitive të mundësuar përmes Krishtit. (Filipianëve 3:13–14). Sa herë ndjehemi të pafalur, është koha t'i kthehemi Biblës dhe të kujtojmë veten dhe njëri-tjetrin për faljen e Perëndisë.

Ndihmë e jashtëzakonshme për shërim mund të jetë përfshirja në një grup, që ka kryer abort më parë. Në këtë grup diskutohen çështje mbi abortin sipas udhëzimeve të Biblës të caktuara për gratë dhe për burrat. Burime të tjera të drejtpërdrejta në internet mund të të ndihmojnë të gjesh mbështetjen e nevojshme.[2]

## Falje e shoqëruar me zgjedhje të drejta

Shumë gra që kanë abortuar kanë mbartur mbi vete një hidhërim të pakuptueshëm karshi meshkujve, që i kanë shfrytëzuar dhe abuzuar me to, karshi prindërve që kanë ushtruar presion ndaj tyre apo edhe ndaj të tjerëve, që i kanë drejtuar në marrjen e vendimit për të vrarë fëmijët e tyre. Perëndia pret që ne ta marrim faljen që Ai po na e jep dhe ta tregojmë edhe te të tjerët (Mateu 6:14–15).

Është e nevojshme që të bëhesh pjesë e një komuniteti terapeutik, një familjeje të krishterë të quajtur kishë. (Nëse je pjesë e një kishe, tregoji dikujt përvojën tënde të abortit dhe kërko ndihmë e mbështetje.) Mund të ndihesh i vetgjykuar duke qenë me të krishterët vërdallë për shkak të së kaluarës. Por s'ka pse. Një Kishë e vërtetë e Krishtit nuk është vitrinë e shenjtorëve, por një spital për mëkatarët. Nuk do të gjykohesh dhe ndëshkohesh për mëkatet që Krishti të ka falur. Njerëzit rrotull teje janë njësoj; qenie njerëzore po aq mëkatarë dhe jo të përsosur si ti. Anëtarët e kishës nuk janë nga vetja të drejtë. Mjerë ata që mendojnë se janë të tillë, , sepse nuk e kuptojnë mirësinë e Perëndisë.

Një kishë e mirë mëson të vërtetat e Biblës, dhe siguron dashuri, pranim dhe mbështetje për këdo. Nëse nuk mundesh të gjesh një kishë të tillë në zonën ku je, kontakto me organizatën tonë në adresën e gjendur në pjesën e prapme të librit dhe do jemi të gatshëm të të ndihmojmë.

Një prej hapave të shëndetshëm, që mund të marrësh është të njihesh me gratë, që po përjetojnë shtatzëni të padëshirueshme. Perëndia mund t'i përdorë përjetimet e tua për të ndihmuar të tjerët dhe për të ndarë dashurinë e Tij përmes dashurisë tënde. Unë dhe gruaja ime kemi shumë mikesha të mira, që kanë abortuar më parë. Përmes kujdesit të lëvizjes pro-jetës, ato u kanë dhënë ndihmë grave të tjera për të bërë atë që do ta kishin dashur ta bënte dikush tjetër për to. Tregimi i historive të tyre nuk ka mundur vetëm të shpëtojë jetët e fëmijëve dhe nënat nga dhimbja e abortit, por i ka ndihmuar edhe në gjetjen e shërimit. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe me ty.

# 19

## Çështjet pro-jetës: çorientim nga porosia e madhe apo pjesë e saj?

Shumë të krishterë dashamirës besojnë se kishat nuk duhet ta përmendin abortin. Disa thonë se përmendja e fjalës abort mund t'i bëjë disa të ndihen në faj. Por arsyeja për të folur mbi këtë çështje është që të parandalohet aborti dhe ndjenja e fajit që e shoqëron, dhe t'u ofrohet ndihmë atyre që janë burgosur nga faji dhe kanë nevojë të lirohen. Është arsyeja më e keqe për të zgjedhur heshtjen në ato kisha që kanë njerëz të përfshirë në abort. Në fakt, është argumenti më i mirë për të folur dhe adresuar çështjen dhe ofrimin e të gjitha mundësive, ndihmën dhe mbështetjen që mund të ofrojmë.

Një student i një seminari në kishën time më tregoi diçka që në një mënyrë a në një tjetër e kam ndeshur shpesh: "Çështjet si aborti janë shpërqendrim nga kryesorja."

"Ç'është kryesorja?" e pyeta.

"Porosia e Madhe", tha ai. "Të fitosh njerëzit për Krishtin. Ja çfarë duhet të bëjmë. Çdo gjë tjetër është një mënyrë shpërqendrimi."

Ai po u referohej fjalëve të Krishtit te Mateu 28:19–20: "Shkoni pra dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit, të Birit dhe të Frymës së Shenjtë dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që ju kam urdhëruar."

A kishte të drejtë ai? A është veprimi pro-jetës një shpërqendrim nga Porosia e Madhe apo pjesë e saj?

## Një *njeri i quajtur* Uilliam

Rreth dyqind vjet më parë, një anglez i quajtur Uilliam, një predikues i mirënjohur, kundërshtar i skllavërisë, bojkotoi importimin e sheqerit nga India Perëndimore si fryt i skllavërisë. Uilliami e ndjente që Perëndia e thërriste të shkonte në Indi, ku ai zbuloi i shokuar që shumë njerëz hindu i çonin vetë fëmijët e tyre drejt vdekjes. Ata i braktisnin pa problem edhe kur ishin të sëmurë, të dobët apo lebrozë. Qeveria britanike bëri mënjanë duke mos dashur të ndërhynte në kulturën apo fenë vendase, por Uilliami u ndje i shtrënguar të vepronte personalisht teksa i shihte njerëzit të vdisnin.

Një ditë, Uilliami tregoi mbi një praktikë të quajtur *sati*, ku vejushat digjeshin të gjalla në turrën e druve të funeralit të burrave të tyre të vdekur. Duke qenë dëshmitar në një vdekje të tillë, ai u ngrit në mes të turmës së mbledhur për të djegur gruan e gjallë dhe u tregoi se ky veprim ishte i gabuar. Më pas, drejtoi një grup misionarësh që protestuan. Madje ngriti diskutime publike mbi këtë çështje në mënyrë që të ndriçohej perspektiva e Perëndisë.

Një të diel në mëngjes, në 6 Dhjetor 1829, pas shumë vitesh aktivizëm, ai mori dekretin zyrtar që ndalonte djegien e vejushave. Kishte planifikuar të predikonte në kishë atë të diel, por nuk e bëri. E kaloi gjithë ditën duke përkthyer dekretin në gjuhën e Bengalit, duke e ditur që jetët e njerëzve aty vareshin në fije të perit.

Ai u kritikua nga disa njerëz për veprimet e tij morale dhe politike. “Nuk je këtu për këtë gjë. Nuk është kjo thirrja jote. Përqendrohu te çështja kryesore, te predikimi i ungjillit dhe lutja.”

Kush ishte ky aktivist shoqëror kaq i shqetësuar për moralin dhe ligjet e shpëtimit të jetëve njerëzore? Ai ishte Uilliam Keri, i njohur sot si “Ati i Misioneve Moderne”. Kur mendojmë për Porosinë e Madhe dhe lëvizjen moderne të misioneve, nuk ka një emër më të përshtatshëm dhe të mirënjohur sa emri i tij.

Keri shkoi në Indi për të fituar njerëzit për Krishtin dhe t’i udhëhiqte ata në besimin e krishterë, jo vetëm duke treguar ungjillin, por duke e jetuar atë—çka përfshiu edhe ndërhyrjen në

shpëtimin e këtyre jetëve dhe përpjekjen për të ndryshuar opinionin publik dhe ligjet e këqija.

## Gjurmët që duhen ndjekur

Xhon Uesli ishte kundërshtar aktiv i skllavërisë. Çarls Finnej ka pasur një rol të rëndësishëm në Hekurudhën e Fshehtë, duke shpëtuar jetët e shumë skllevërve, ndërsa kritikohej rreptë nga bashkëkohësit e vet të krishterë për shkak të mosbindjes së tij civile. D. L. Mudi hapi dyert e shtëpisë së tij për vajzat pa të drejta duke i shpëtuar nga shfrytëzimi. Çarls Spurxhën ndërtoi shtëpi për gratë e moshuara dhe për jetimët, duke i shpëtuar nga jeta e rrugës. Emi Karmajkëll ndërhyri kundër shfrytëzimit seksual të vajzave në Indi duke i shpëtuar nga prostitucioni. U ndërtoi shtëpi, shkolla dhe një spital.

Të gjithë këta të krishterë janë të njohur si misionarë dhe ungjillorë, njerëz që u kujdesën për thirrjen e tyre, për Porosinë e Madhe. Dhe megjithatë, ne shumë rrallë i kushtojmë kujdes përkushtimit të tyre radikal mbi ndërhyrjet personale dhe shoqërore për të gjithë ata që janë të dobët, të shfrytëzuar dhe në nevojë.

Ndoshta ungjillëzimi i tyre ishte i suksesshëm, sepse predikuan atë që jetuan. Nuk kishte asnjë konflikt midis ungjillit, shqetësimit shoqëror dhe ndërhyrjes personale për nevojtarët. Në fakt, ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis tyre.

## Pjesa e "Çështjes kryesore"

Duhet të përpiqemi të shpëtojmë jetët për të njëjtën arsye të thjeshtë që Bibla e kishave tona na thotë në predikimet e çdo të diele:

> "Çliro ata, që i tërheqin drejt vdekjes dhe mbaji ata që po i çojnë në thertore." (Proverbat 24:11)

> "Mbroni të dobëtin dhe jetimin, sigurojini drejtësi të vuajturit dhe të varfërit." (Psalmi 82:3)

" Ndero atin tënd dhe nënën tënde dhe duaje të afërmin tënd si veten." (Mateu 19:19)

Njerëzit e Perëndisë janë për t'u kujdesur veçanërisht për gratë pa burra dhe fëmijët pa etër (Jakobi 1:27). Kush kualifikohet më shumë nën këtë kujdes se sa një grua e pamartuar dhe fëmija i saj i palindur?

Në ungjillin sipas Lukës 10:25, lexojmë mbi doktorin e ligjit që pyeti: "Çfarë duhet të bëj që të fitoj jetën e përjetshme?" Jezusi iu përgjigj: "Duaje Zotin Perëndinë tënd... dhe, duaje të afërmin porsi vetveten. " (v 27). Të duash Perëndinë Jezusi e quajti urdhërimin më të madh dhe të duash të afërmin, urdhërimin e dytë më të madh (Mateu 22:37–39). Kështu, Porosia e Madhe në vetvete nuk është urdhërimi më i madh... më saktë si pjesë e dashurisë për Perëndinë dhe të afërmin tënd.

Asgjë nuk mund t'i hapë dyert për ungjillëzim më shumë se shërbesat ndaj nevojtarëve. Me studentët, që kanë dëshirë të flasin për abortin mund të zhvillosh vazhdimisht biseda që do të të çojnë në ndarjen e ungjillit. Ata që punojnë në qendrat e shtatzënisë kanë mundësi të shumta për të ndarë ungjillin e Krishtit, ashtu si edhe ata që shpërndajnë literaturë në klinikat e abortit, shkojnë në qytetet e studentëve për t'u dhënë informacion. Njerëzit që u hapin dyert e shtëpisë grave shtatzëna u tregojnë atë dashuri që do t'i drejtojë ato gra pa dyshim tek ungjilli. Kurdo që ndeshemi me nevojat e njerëzve, ungjillëzimi bëhet më i natyrshëm dhe i besueshëm.

## Tri perspektivat e porosisë së madhe

Kemi nevojë të mendojmë për tri perspektiva që të kuptojmë lidhjen midis përpjekjeve të pro-jetës dhe Porosisë së Madhe.

**Së pari:** Porosia e Madhe është urdhërimi qendror, por Jezusi quajti një urdhërim tjetër si më të madhin. Porosia e madhe nuk është gjë tjetër veçse një shtrirje apo zgjerim i urdhërimit për të dashur Perëndinë dhe të afërmin tënd.

**Së dyti:** edhe nëse vetëm gjithçka që ka të bëjë me porosinë e Madhe quhet ungjillëzim, mbrojtja e atyre që u rrezikohet jeta do

ta kualifikonte në këtë çështje të madhe, sepse hap kështu dyert për ungjillëzim.

**Së treti:** Në Porosinë e Madhe, Jezusi nuk na thotë që vetëm të ungjillëzojmë. Ai na thotë "t'i mësojmë t'i binden gjithçkaje që u kam urdhëruar" (Mateu 28:20). Ai nuk po na thotë t'i mësojmë ata *të besojnë,* ai thotë t'i mësojmë *të binden.*

Jezusi na urdhëron të kemi dhembshuri dhe të veprojmë në mënyrë sakrifikuese për ata që janë të dobët dhe në nevojë. Kjo është pra pjesë e "gjithçkaje që ju kam urdhëruar". Dhe nëse dështojmë që t'i bindemi kësaj pjese, duke mos i mësuar as të tjerët t'i binden, ne nuk e përmbushim Porosinë e Madhe.

Nëse kisha nuk ndërhyn për fëmijët e palindur dhe nënat e tyre, dhe nëse nuk i mësojmë njerëzit tanë në kishë t'i ndihmojnë këto nëna, atëherë dështojmë në përmbushjen e porosisë së Madhe.

Kishat duhet të jenë si shtylla kurrizore e veprës së Perëndisë për nevojtarët. Nëse kisha jote nuk po bën mjaftueshëm për fëmijët e palindur dhe nënat e tyre, ndoshta kjo mund të jetë një thirrje që Zoti po ta bën ty personalisht për ta ndihmuar kishën dhe drejtuesit e saj të marrin përsipër këtë shërbesë jetësore.

# 20

## Si mund t'i ndihmoj bebet e palindura dhe nënat e tyre?

Ka shumë organizata të shkëlqyera pro-jetës të shtrira jo vetëm në vend, por edhe në të gjithë botën. Ato janë të orientuara në aktivitete të ndryshme si: edukim të përkorë, njohuri mbi zhvillimin e fetusit, këshillim për gratë shtatzëna, ndikim në ligjvënie, ofrim të mundësive të birësimit, përballjen e kulturës së sotme me holokaustin e paralindjes, protestat para klinikave të abortit, njohje të studimeve shkencore dhe psikologjike, lutje, këshillim në trotuar në afërsi të klinikave të abortit, si edhe mbështetje dhe ndihmë grave dhe burrave pas abortit. Ka këshillues që ofrojnë këshillim dhe përgjigje pyetjeve përmes linjës telefonike falas dhe internetit 24 orë në ditë.[1]

### Një thirrje për unitetin pro-jetës

Gjatë këtyre njëzet vjetëve të fundit, kam pasur privilegjin të punoj dhe të vërej një shërbesë të gjerë dhe të ndryshme të pro-jetës. Kam parë fuqi argumenti në trajtime të çështjeve të ndryshme për audienca të ndryshme me pjesëmarrjen e vullnetarëve dhe përkrahësve të ndryshëm.

Aktivistët e pro-jetës, kuptueshëm të zjarrtë për çështjen e tyre, shpesh mendojnë se forma e shërbesës së tyre është drejtimi më i rëndësishëm, më i drejtë edhe drejtimi *i vetëm* i duhur. Kjo mënyrë të menduari është aq largpamëse sa një ushtar të

thoshte për forcat detare që nuk janë në front të parë apo për një marinar të pretendonte që ushtarët e Këmbësorisë nuk bëjnë ndonjë detyrë të rëndësishme krahasuar me ta, ndaj të gjithë duhet të kthehen e të angazhohen në forcat detare. Patjetër që detyra e pro-jetës është e shumëfaqshme dhe e stërmadhe dhe ka nevojë për strategji të shumta. Por ne *nuk* duhet të bëjmë të gjithë të njëtën gjë.

Jemi urdhëruar: "Jini të gjithë të një mendjeje, të dhembshur, plot dashuri vëllazërore, të mëshirshëm dhe dashamirës..." (1 Pjetrit 3:8). Mendjet e përulura dhe zemrat e buta janë të shpejta për të mësuar nga të tjerët, që kanë personalitete, dhunti, dëshira dhe strategji të ndryshme. Kemi nevojë për mirësi, durim, dashuri, paqe dhe unitet në Frymën e Perëndisë. (Efesianëve 4:1–6).

Për disa vjet kam drejtuar një takim me drejtues të pro-jetës, që vinin nga një spektër i gjerë grupesh. Me kalimin e kohës u njohëm, kuptuam dhe mësuam nga njëri-tjetri. Zbuluam aktivitetet, ku mund të bashkëpunonim, dhe zbuluam se ishim munduar të shpiknim rrotën duke krijuar materiale dhe programe që të tjerët i kishin bërë tashmë para nesh. Në fillim, shumë prej tyre m'u shprehën që nuk i kishin kuptuar disa prej grupeve të tjera duke dyshuar edhe në përqasjen që ofronin. Madje ishin ndjerë në konkurencë, por ndërsa kalonin më shumë kohë me këta njerëz, u njohën zemrat dhe u kuptuan qëllimet. Kjo çoi në vlerësimin e motrave dhe vëllezërve që Zoti, kishte thirrur në aspekte të ndryshme të shërbesës së pro-jetës.

Kërko për organizatat më të mira, ku mund të përshtatesh më së miri me prejardhjen, personalitetin, dhuntitë dhe thirrjen që Perëndia ka për ty. Informacioni është i disponueshëm për një shumëllojshmëri organizatash kombëtare, rajonale dhe lokale.[2] Nëse ke nevojë për ndihmë për të kontaktuar me ndonjë grup të pro-jetës në vendbanimin tënd, kontakto me zyrën tonë për të marrë informacionin e nevojshëm.[3]

# Çfarë mund të bësh ti?

Nëse je pjesë e ndonjë kishe që mëson Krishtin dhe Biblën, kontakto me drejtuesit dhe kërko për shërbesën e pro-jetës në kishë dhe në komunitet (nëse nuk je pjesë e ndonjë kishe, gjej një kishë në vendin ku jeton). Duhet ta kundërshtojmë çdo herë konceptin: "Unë jam i vetëm, jemi veç një kishë e vogël, nuk mund të sjellim ndryshimin." Sigurisht që ti nuk mund t'i mbulosh gjithë nevojat, por mund të përdoresh nga Perëndia për t'i plotësuar ato me mënyrat më të mundshme. Si mund të ndihmosh miliona njerëz nevojtarë? Nga një në çdo moment.

Gjërat që vijojnë nuk duhet patjetër të ndiqen nga çdokush, por është një listë e zakonshme prej së cilës çdokush mund të zgjedhë sipas mundësisë dhe asaj që i përshtatet për të bërë:

1. *Hap derën e shtëpisë tënde.* Ndihmo një vajzë shtatzënë ose mirëprit në shtëpi një fëmijë të "padëshiruar" për birësim ose kujdestari. Ose përkushtoje veten një herë në javë për t'u kujdesur për fëmijët e një nëne pa bashkëshort.
2. *Ofro kohën, shërbimin dhe dhuntitë e tua vullnetarisht.* Ndihmo personalisht gratë shtatzëna, të sapolindurit, bebet e droguara, jetimët, fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit, njerëzit e rrugës dhe të tjerë nevojtarë. Dhuro nga koha jote, financat dhe aftësitë e tua apo rrobat, pajisje të ndryshme nëpër shërbesat e birësimit, shtëpitë e grave, agjencitë e përkora, dhe në organizata apo grupe të tjera edukative pro-jetës. Mund të ofrosh ndihmën tënde edhe me punë të tjera si kositjen e barit, pastrimin apo punë hidraulike, dizenjim të faqes së internetit, rregullimin e kompjuterave, etj.
3. *Bëhu nismëtar.* Nëse nuk ka ndonjë shërbesë pro-jetës në vendin tënd të banimit, atëherë filloje ti një. Ndërto një koalicion. Mendo të ngresh zyrën krah një klinike aborti ose një zyre për Planifikimin Prindëror. Ndërto një klinikë këshillimi për shtatzëninë ose një qendër informacioni pro-jetës. Krijo një mënyrë kujtimore për

fëmijët e palindur, ndoshta në formën e një kopshti me trëndafila, në oborrin e kishës apo në vendin tënd të banimit.[4]

4. *Ji i mirë informuar.* Njihu me faktet që të kesh prova para kohe për t'iu përgjigjur argumenteve të pro-zgjedhjes.[5] Ka shumë libra apo kaseta dhe video me informacion të mirë dhe të bollshëm (zakonisht falas) ashtu si edhe buletine informative nga lëvizja pro-jetës. Ka edhe shumë faqe interneti të pro-jetës.[6] Ndërkohë që abortet kirurgjikale po reduktohen, ndërhyrjet përmes kimikateve janë duke u rritur. Informohu mbi llojet e kimikateve, duke përfshirë edhe RU-486, pilulën e abortit. Shqyrto Norplantin, Depo-Provera-n, Mini-Pilulën, madje edhe pilulën për kontrollin e lindjes—ndërkohë që këto konsiderohen kryesisht si kontraceptivë, në raste të ndryshme mund të ndodhë ngjizja, por ky ilaç mund të parandalojë personin e sapongjizur, përmes të vendoset në endometrium, duke shkaktuar në këtë mënyrë aborte të hershme.[7] Informohu mjaftueshëm për të arritur në përfundime të qarta dhe të besueshme.
5. *Bisedo me miqtë, fqinjët dhe kolegët e punës.* Nxiti me mirësjellje të tjerët t'i rimendojnë supozimet e tyre mbi këtë çështje. Jepu një kopje të këtij libri me disa pjesë të nënvizuara për të tërhequr vëmendjen! Studio çështjet në më shumë detaje në librin tim me më shumë informacion "*Përgjigjet e Pro-jetës ndaj Argumenteve të Pro-zgjedhjes*". Shpërnda edhe libra artistikë me tematikë pro-jetës të tilla si: *Mundimet e Fëmijës* të Fransin Rivërs, *Lot në Shishe* nga Silvia Bambola, dhe libri im *Kufiri i Fundit*.
6. *Ngri dhe promovo diskutime mbi abortin.* Futu në lidhje të drejtpërdrejta interneti, duke dhënë perspektivën e pro-jetës. Mendo të ndërtosh një faqe personale pro-jetës. Kërko për të folur në emisione radiofonike apo televizive dhe interesohu edhe për

emisione me temë qendrore të çështjes së pro-zgjedhjes. Porosit dhe shpërnda literaturë të pro-jetës. Fol hapur në mënyrë që përfaqësuesit e pro-zgjedhjes të largohen të menduar dhe të sfiduar. Ashtu siç e kam cituar edhe në librin *Paradoksi i së Vërtetës dhe Mirësisë,* është tepër e rëndësishme t'i trajtojmë subjekte të tilla si aborti në një këndvështrim të krishterë ashtu siç do të bënte vetë Krishti. Jezusi erdhi plot mirësi dhe të vërtetë (Gjoni 1:14). Nëse duam që njerëzit të shohin në ne Jezusin, duhet t'ua japim të vërtetën me mirësi.

7. *Shkruaj letra*. Ji i sjellshëm, konçiz, i kujdesshëm dhe i dallueshëm. Përdor citime të shkurtra të këtij libri dhe të librit më gjithëpërfshirës *Përgjigjet e Pro-jetës*. Letrat drejtuar redaktorit të një reviste kombëtare apo të një gazete të mirënjohur mund të lexohen nga qindra dhe mijëra lexues.
8. *Nxit aktivitete bojkoti të klinikave të abortit*. Kontakto njerëz me ndikim duke përfshirë pronarë, biznesmenë, ofrues siguracionesh, ofrues shërbimesh mjeksore dhe ofrues të shërbimeve të ndryshme duke u treguar me mirësjellje se nuk mund të bashkoheni vetëdijshëm me ata që ofrojnë shërbime për të vrarë fëmijët.
9. *Aktivizohu në proceset politike!* Takohu me përfaqësues të pushtetit dhe trego këndvështrimin tënd në lidhje me abortin. Skico, dërgo dhe nënshkruaj peticione për votim të pro-jetës. Hidh kandidaturën për zgjedhje politike si kryetar bashkie a komune, apo zgjedhje në bordin e shkollës. Shpenzo kohë dhe para për kandidatët e lëvizjes pro-jetës. Voto për ta.
10. *Bashkohu ose organizo një grup pro-jetës në kishën tënde*. Kërko më shumë udhëzime nga drejtuesit e kishës. Jepu literaturë dhe kërkoju të shohin një video. Angazho njerëz pozitivë, që mbështesin shërbesa të tjera të kishës që të të ndihmojnë të formulosh dhe zbatosh një plan mbi edukimin dhe mobilizimin. Mos druaj të kërkosh periodikisht oferta speciale për

shërbesat e pro-jetës! Siguro revista apo buletine për ta shpërndarë në kishë gjatë javës së Shenjtërisë së Jetës Njerëzore në muajin janar. Siguro libra *Pse Pro-Jetës* me çmim të ulët dhe shpërnda nga një kopje për gjithësecilin në kishë. (Gjithë të drejtat e këtij libri nuk i takojnë autorit, por shërbesave të pro-jetës) Nëse drejtuesi i kishës të kërkon mendim për predikimin, jepi informacion mbi burimet e ndryshme të gjendshme përmes referencave të këtij libri.[9]

11. *Shfrytëzo burimet më të mira të pro-jetës*. Gjej mundësi të shfaqësh në kishë video si "Jeta është e Shenjtë"[10] apo video, që përshkruajnë kryerjen e aborteve.[11] (Paralajmëroji njerëzit që video të tilla nuk janë për t'u parë nga fëmijët). Shpërnda informacion për grupet e tjera pro-jetës, që gjenden në komunitetin tënd. Reklamo një tabelë me numrin 0800 si një mundësi e grave shtatzëna për të marrë në telefon. Fillo një grup me këshillues të trotuareve, planifiko një manifestim të heshtur lutjeje ose një protestë të hapur. Qëndro në kontakt me grupet e pro-jetës në zonën tënde. Ata mund të kenë njohuri që ti nuk i ke dhe ndihma e tyre mund të jetë burim i çmuar.
12. *Lutu çdo ditë për shërbesat e pro-jetës, kishat, drejtuesit e kishave, nënat dhe bebet*. Organizo një grup tëndin të lutjes. Nëse terri i vrasjes së fëmijëve duhet të ndriçohet me dritën e së vërtetës dhe të dashurisë, kjo do të kërkojë beteja shpirtërore, luftë përmes lutjeve të vazhdueshme dhe me zemër të përulur. (Efesianëve 6:10–20).
13. *Jep për organizatat pro-jetës*. Kam parë nga afër shërbesa të shumëllojshme të pro-jetës. Në gati të gjitha rastet, kam mbetur pa fjalë nga ndikimi, që kanë dhënë në komunitet. Ndaj të nxis ty edhe kishën tënde të kërkoni organizatat pro-jetës në zonën tuaj ose një prej shërbesave kombëtare apo ndërkombëtare, që punon në zonën ku banoni dhe jepni me bujari për ta.

Pyete veten, *Pesë minuta pasi të vdes, çfarë do të kisha dashur të jepja në të mirë të nevojtarëve, nëse do të kisha pasur një shans të dytë?* Pse të mos e kalojmë pjesën tjetër të jetës duke mbushur boshllëkun midis asaj që do të dëshiroja të jepja me atë që *po japim?*

Kemi një mundësi—kohën e jetës në tokë—për të përdorur të gjitha burimet, që na janë dhënë për të bërë një ndryshim për përjetësinë. Përfytyroje për një çast përjetësinë dhe mendo si do të ndjeheshe nëse dikush të afrohet me një buzëqeshje plot mirësi dhe të thotë: “Faleminderit! Ajo që ke dhënë më shpëtoi jetën mua dhe fëmijës sim.”

# Mbi Autorin

Rendi Alkorn është studiues dhe autor i njëzet librave më të shitur. Librat e tij jo-artistik përfshijnë *"Paradoksi i Mirësisë dhe së Vërtetës"*, *"Parimi i Thesarit"*, *"Përgjigjet e Pro-jetës ndaj Argumenteve të Pro-zgjedhjes"*. Ndër romanet e tij përmenden, *"Kufiri i Fundit"*, *"Autoriteti Suprem"*, *"Komploti i Ishbanit"* dhe fituesi i Medalionit të Artë, *"Të sigurt në Shtëpi"*. Babai i dy vajzave të martuara, Karina Frenklin dhe Anxhela Stamp, Rendi jeton në Gresham, Oregon, me gruan e tij Nensin, e cila për të është dhe mikja më e mirë. Botimi është bërë përmes Shërbesës së Perspektivës së Përjetshme, të cilën mund ta kontaktoni përmes

www.epm.org,
503-668-5200,
39085 Pioneer Blvd.,
Suite 206,
Sandy, OR, USA 97055.

# Shënime

## *Kapitulli 1*


1. "Gallupi: Shtatëdhjetë e dy përqind e adoleshentëve thonë se Aborti është i Gabuar," Nëntor 24, 2003, WorldNetDaily.com.
2. "Sondazhi i Ri Kombëtar tregon se shumica e amerikanëve janë pro-jetës," (Dhjetor 2003 Zogby, Sondazhi Ndërkombëtar, publikuar në Janar 16,2004,209.157.64.200/focus/fnews/1062123/posts).
3. Janar 23, 1994, "Turma e të Rinjve Shumëfishohet në Uashington në Marshimin e Jetës," 209.157.64.200/focus/freligion/1064531/posts.
4. Shih www.standupgirl.com.
5. "Aborti: Fakte në një shikim" (Nju Jork: Planifikimi Prindëror në Amerikë.), 1.
6. Uebsajti i Institutit Alan Guttmacher, www.agi-usa.org/pubs/fb_induced_abortion.html; Fakte të Përmbledhura, rev. Shkurt 2000.
7. Instituti Alan Guttmacher, "Të nxisësh abortin," Fakte të Përmbledhura, Shkurt 2002.
8. James Patterson dhe Peter Kim Dita kur Amerika tregon të Vërtetën (Nju Jork: Salla e Nxënësve të Shtypit, 1991), 32.
9. Lydia Saad, "Amerikanët të ndarë në debatin për abortin," 18 Maj 1999, Sondazhi i Lejuar Gallup për Shërbimet Informative; www.gallup.com/content/login.aspx?ci=3847.
10. Perspektiva e Planifikimit Familjar Korrik–Gusht 1996, 12.
11. Randy Alcorn, Përgjigjet e Pro-Jetës Argumenteve të Pro-Zgjedhjes. (Motrat,

OSE: Publikimet Multnomah, 2000), 3 13–22; "Perspektiva biblike për fëmijët e palindur, " www.epm.org/articles/aborbibl.html.

## *Kapitulli 2*

1. "Gallupi tregon se dy të tretat e amerikanëve besojnë se aborti është moralisht i gabuar," Qershor 2003, wwwiifesite.net/ldn/2003/jun/03060308.html.
2. Paul Swope, "Aborti: Një dështim i komunikimit," Gjërat e para, Prill 1998,31–35. See www.firstthings.com/ftissues/ft9804/articles/swope.html.

## *Kapitulli 3*

1. Nënkomisioni në Ndarjen e Pushtetit të Komitetit të Senatit Gjyqësor S-158, Raport, 97th Kongr., Sesioni 1, 1981.
2. Po aty.
3. Po aty.
4. Qendra e Dashurisë dhe Gëzimit, Përkrahësit e Shërbesës për Jetën al., 1989, Dëshmia e Ejlin Klasës (Aileen Klass).
5. Alexander Tsiaras, prej Konceptimit në Lindje: Një jetë e çelur (Nju Jork: Ditë e Dyfishtë, 2002).
6. Statuti i Rishikuar i Mizurit, kapitulli 1, "Ligjet në fuqi dhe Ndërtimi i Statutit" Seksioni 1.205, Gusht 28, 2003. Shih www.moga.state.mo.us/statutes/C000-099/0010000205.htm.
7. R. Houwink, Fakte: Pasqyrat e Shkencës (Nju Jork: Publikimet Amerikane Elsevier Co., Inc., 1970), 104–190.
8. Lennart Nilson, "Drama e jetës para lindjes," Jeta, 30 Prill 1965.
9. "Faktet e jetës " (Norcross, GA: Këshilli i Pasurisë së Zhvillimit Njerëzor), 2.
10. Vincent J. Collins, "Dhimbja e fetusit dhe aborti: Evidenca Mjekësore," Studime në Drejtësi dhe Mjekësi (Çikago: Amerikanët e Bashkuar për Jetën, 1984), 6–7.
11. Shih Lajmet e Javës (Newsweek), Qershor 9, 2003, "Lufta mbi të Drejtat e Fetusit," 40–47.
12. Këto janë fakte shkencore të vërtetuara më së miri. Shih për shembull, Landrum Shettles dhe David Rorvik, Ceremonitë e Jetës (Grand Rapids: Zondervan, 1983), 41–66.

13. Scott Klusendorf, Pro-Jetës 101: Një udhëzues Hap pas Hapi për ta bërë çështjen tënde më bindëse (Signal Hill, CA: Shtypi i të qenët i arsyeshëm, 2002).
14. Justin Taylor, "Gjembat e ferrës," Bota, Janar 17, 2004, 43.

## *Kapitulli 4*

1. Leonide M. Tanner, ed., "Të zhvillosh Parametra Profesionalë: Rolet e punonjësit social dhe infermierit në kujdesin për të nxitur pacientin në kryerjen e abortit," Gjinekologji dhe Obstetrikë Klinike (14 Dhjetor 1971): 1271.
2. Paul Marx, Shitjet e Vdekjes: Luftë për të Palindurin (Collegeville, MN: St. Shtypi i Universitetit të Xhonit, 1971), 21.
3. Feministët për Manualin e Debatit për Jetën (Kansas City, MO: Feministët e Jetës së Amerikës, n.d.), 3.
4. Carl Sagan and Ann Druyan, "A është e mundur të jesh njëkohësisht edhe pro-jetës edhe pro—zgjedhjes? Parada, 22, prill 1990,4.
5. Nëntë Muajt e Parë (Pranverat e Kolorados : Të Fokusohesh në Familje), 3.
6. Shikim Paraprak mbi Lindjen (Norcross, GA: Qendra e Pasurisë së Zhvillimit Njerëzor 1991), 4.
7. Shih Scott Klusendorf, "Të Korrësh të Palindurin: Kërkimi mbi Etikën e Bërthamës së Qelizës së Embrionit" www.str.org/free/bioethics/harvest.pdf.
8. "Afati i fundit i skadencës për komentin e NIH mbi korrjen e bërthamës së qelizave.," Info-net Pro-jetës, 31 Janar 2000.
9. Thomas W. Hilgers, Dennis J. Horan and David Mall, eds., Perspektiva të Reja mbi Abortin Njerëzor (Frederick, MD: Publikimet e Universitetit të Amerikës Inc./Aletheia Books, 1981), 351.
10. Guri i Varrit: Analizuesi Mjekësor, "A e dhunova unë lindjen e parakohshme? Një doktor mendon mbi Epokën e Re të persekutimit nga Dr. Warren M. Hern, Tetor 22, 2003; http://slate.msn.com/id/2090215.

## *Kapitulli 5*

1. Mortimer J. Adler, Të kesh pa pasur: Ese për Shekullin e 21-të në Demokraci dhe Socializëm (Nju Jork: MacMillan, 1991), 210.
2. "Truri i vdekur i gruas që lind fëmijën" Oregonisti, 31 Korrik 1987.

3. Shih www.michaelclancy.com/story.html.
4. Chuck Colson, "Vendimet e jetës dhe të vdekjes: Të Lutesh për më të Lartin." Komentari Pika e Thyerjes #000425, 25 prill 2000.
5. HR 1997 kaloi në Apelin e Senatit për votim 61-38, Mars 25, 2004.

## *Kapitulli 6*

1. Madeline Nash, "Brenda mitrës," Koha, Nëntor 11, 2002, 68–77; Debra Rosenberg, "Lufta për të drejtat e fetusit," Lajmet e javës (Newsweek), Qershor 9, 2003,40–51.
2. Mark O'Keefe, "Aktivistët mbledhin të dhëna mbi imazhet ultratinguj për të shkurajuar abortin," Shërbimi i lajmeve të Shtëpisë së Re, www.newhouse.com/archive/okeefe021903.html, © 2003.
3. Jennifer Kabbany, "Aborti vs. Ultratingulli," Lidhjet e Uashingtonit, Tetor 29, 2003.
4. Audrey Stout, Marietta, GA, imel Randy Alcorn, Shkurt 12, 2000.
5. Shih www.logiqlibrary.com/browseAction.cfm?productID=20; www.geddeskeepsake.com/showcase.html; www.clearviewultrasound.com/gallery.asp; firstsightultrasound.com/4d_liveSA.htm; www.gemedicalsystems.com/rad/us/4d/virtual.html; për të gjetur imazhe të tjera përdorni fjalët ultratingull (Ultrasound), imazhe (images), dhe i palindur (unborn) mbi faqen e kërkimit.
6. Jeta, Gusht 1990.
7. Lennart Nilson, Një fëmijë është lindur (Nju Jork: Delacorte Shtypi, 1977).
8. Shih www.abortiontv.com/AbortionPictures1.htm.
9. Warren Hern, "Procedurat dhe teknikat operative," Praktika e Abortit (Boulder, CO: Alpenglo Graphics, Inc., 1990), 154.
10. Naomi Wolf, "Trupat tanë, shpirtrat tanë," Republika e Re, tetor 16, 1995; www.epm.org/articles/naomiwolf.html.
11. Rrjeti i raportit të kujdesit, vol. 4, no. 5, Nëntor 2003, Sterling, VA.
12. Trasmetimi Publik i Oregonit, "Kundërshtisë," Ish-staf i administratës së B. Klintonit Maria Echaveste, et al., Janar 4, 2004.

## *Kapitulli 7*

1. Mary Fischer, "Një vështrim i ri për Jetën," doracak, Tetor 2003, 95–103.

2. Peter Singer, Etika praktike (1979), E cituar në " Peter Singer me fjalët e veta" Përpikëri akademike,www.academia.org/singerquotes.html.
3. Jim Newhall, i cituar nga Maureen O'Hagan, "Të durosh vuajtjet," Willamette Week, 3 Maj 1995.
4. Shtypi i shoqëruar (Associated Press) i cituar në Linjën e Veprimit të Këshillit të Veprimit të Krishterë, Mars–prill 1991.
5. Sharon Begley, "A dëgjon atë që po dëgjoj unë Lajmet e javës (Newsweek), Edicioni i veçantë i verës, 1991, 12.
6. Po aty.
7. T. Verney and J. Kelley, Jeta sekrete e fëmijës së Palindur (Nju Jork: Delta Books, 1981).
8. H. B. Valman and J. F. Pearson, "Çfarë ndjen fetusi." (Ky është një artikull i printuar pa referenca në publikimin e bërë. Dr. Valmen është konsulent pediatër në Spitalin Northwick Park dhe në Qendrën e Kërkimit Klinik në Harrow; Pearson është lektor, konsulent obstretist dhe gjinekolog në Shkollën Kombëtare të Mjekësisë në Kardif.)
9. John Willke, Aborti, Pyetje dhe Përgjigje Cincinnati, OH: Hayes Publishing Co., 1988), 53.
10. Begley, "A e dëgjon?" 14.
11. Peter Singer, "Shenjtëri e jetës apo cilësi e jetës," Pediatry, Korrik 1983, 129.
12. Singer, "Të marrësh jetën: Njerëzit," http://www.petersingerlinks.com/taking.htm; Ekstrakt nga Singer, Etika Praktike (Nju Jork: Shtypi i Universitetit të Kembrixhit, 1993).
13. Charles Hartshorne, "Të shqetësohesh për abortin: Një përpjekje për një vështrim të arsyeshëm," Shekulli i Krishterë, 21 Janar 1981, 42–45.
14. David Boonin, Justifikimi i Abortit (Nju Jork: Shtypi i Universitetit të Kembrixhit, 2003), 5–9.
15. Feministët për Manualin e Debatit për Jetën (Qyteti Kansas, MO: Feministët për jetën në Amerikë, n.d.), 9.
16. Cituar nga George Will, Në gjurmët e lumturisë dhe të mendimeve të kthjellëta (Nju Jork: Harpër Kolofon, 1978), 62–63.

## *Kapitulli 8*

1. Kate Michelman, e cituar në Kohët e Nju Jorkut (The New York Times), Maj 10, 1988.

2. Feministët për Manualin e Debatit për Jetën (Qyteti Kansas, MO: Feministët për jetën në Amerikë.), 17.
3. Rosemary Bottcher, “Feminizmi: E joshur nga aborti,” në Të Shpëtosh të Ardhmen, ed. Dejv Andrusko (Nju Jork: Librat e Ciklit të Jetës, 1983).
4. Shih www.feministsforlife.org/news/commonë.htm.
5. Susan B. Anthony, Revolucioni, Korrik 8, 1869,4.
6. Mattie Brinkerhoff, Revolucioni, prill 9, 1868, 215–16.
7. Elasah Drogin, Margaret Senger: Ati i Shoqërisë Moderne, (Publikimet CUL, 1989), 11–13.
8. R. C. Sproul, Aborti: Vështrim i arsyeshëm për një çështje emocionale (Pranverat e Kolorados , CO: NavPress, 1990), 117–18.
9. Guy M. Condon, “Ju thoni zgjedhje, unë them vrasje,” Krishterimi Sot (Christianity Today), Qershor 24, 1991, 22.
10. Mary Ann Schaefer, cituar nga Catherine dhe William Odell, E drejta e Parë Njerëzore (Toronto: Librat e Ciklit të jetës, 1983), 39–40.
11. Feministi Amerikan, Pranverë 2003, 14, 17.
12. “Aborti dhe Besimet Morale: Një anketë mbi opinionin amerikan,” realizuar nga organizata Gallup, 1991,4–7.
13. Willke, “Lëvizja e grave,” 3.
14. Condon, “Ti thua zgjedhje,” 23.
15. Robert Stone, “Gruaja si specie e rrezikuar në Indi,” Oregonisti, Mars 14, 1989, B7.
16. Jo McGowan, “Në Indi abortohen femrat,” Lajmet e Javës (Newsweek), Shkurt 13, 1989.
17. Raporti Kohët e kufizuara, Beijing, Shkurt 7, 2000; Histori të ngjashme në www.lifesite.net.
18. Lajmet Mjekësore të Botës (Medical World News), Dhjetor 1, 1975,45. Shih gjithashtu Lajmet e Javës (Newsweek), “Fëmijë të rinj të guximshëm,” Shkurt 1, 2004.

## *Kapitulli 9*

1. Mary O’Brien Drum, “Takim në mes të radikalizmit,” E Përkohshme, Nëntor 1980, 23.
2. Nat Brandt, Qyteti që nisi Luftën Civile (Nju Jork: Shtypi i Universitetit të Sirakuzës, 1990); Thomas Clarkson, Skllavëri dhe tregti me Speciet Humane

(Majemi, FL: Mnemosyne Publ. Co., 1969); Austin Willey, Historia e Çështjes Anti-Skllavëri (Portland, ME: Broën Thurston Publ.,., e riprintuar Mnemosyne Publ. Co., Majemi, FL, 1886).

## *Kapitulli 10*

1. Shih Robert Jay Lifton, Doktorët Nazistë: Vrasja Mjekësore dhe Psikologjia e Genocidit (Nju Jork: Librat themelorë, 1986).
2. Shih www.teen-aid.org/Links.htm; www.abstinencedu.com; www.abednet.org; www.PureRevolution.com.

## *Kapitulli 11*

1. Serrin M. Foster, "Gratë meritojnë më mirë se aborti", Respekto jetën, 2003.
2. Cituar nga Mary Meehan, "Ish- abornistët: Pse e kanë lënë këtë punë? ," Rishikim i jetës njerëzore (Pranverë–verë 2000), 12.
3. Elizabeth Shadigan, MD, dëshmia përpara Nënkomisionit të Shkencës, Teknologjisë dhe Kozmosit të Senatit për të hetuar pasojat fizike dhe psikologjike të abortit te gratë: e përmendur në "Dëshmitë e pyetura në Senatin e SHBA-së mbi pasojat anësore të abortit te gratë." ," Kulturë & Kozmos, vol. 1, no. 30, Mars 9, 2004.
4. Brent Rooney dhe Byron C. Calhoun, MD, "Të nxisësh abortin dhe rreziku në lindjet e parakohshme," Revista e Fizikantëve dhe Kirurgëve Amerikanë vol. 8, no. 2, Verë 2003.
5. S. Linn, "Lidhja midis abortit të nxitur dhe pasojat në shtatzënitë pasuese," Revista Amerikane e Obstetërve dhe Gjinekologëve, Maj 15, 1983, 136–40.
6. John A. Richardson dhe Geoffrey Dixon, "Pasojat e fundit të ligjshëm në shtatzënitë pasuese," Revista Mjekësore Britanike (1976): 1303–4.
7. B. Luke, Udhëzuesi për çdo grua shtatzënë për të parandaluar lindjen e parakohshme (Nju Jork: Librat e Kohës, 1995); E. Ring-Kassidi, Shëndeti i gruas pas abortit (Toronto: Instituti i Veberit, 2002).
8. Perspektiva e planifikimit familjar, Mars–prill 1983, 85–86.
9. Departamenti i SHBA-së për Shëndetin dhe Shërbimet njerëzore, Raporti Javor i Sëmundshmërisë dhe Vdekshmërisë 42 (SS-6) 73–85 (Dhjetor 17, 1993; prill 1984).
10. Ann Aschengrau Levin, "Shtatzënia ektopike dhe aborti i mëparshëm"Revista

Amerikane e Shëndetit Publik (Mars 1982): 253.
11. "Shtatzënia Ektopike: Prognoza për riprodhimin pasues," www.physicianeducation.org. Mars 1, 2004.
12. Qendrat për Kontrollin e Sëmundjeve, Shtypi i lejuar, Maj 1, 2001, "Raportet e nënvizuara të CDC, për shtazënitë e seleksionuara sipas racës dhe etnisë—të lidhura me shkallën e vdekjeve," http://www.cdc.gov/od/oc/media/pressrel/r010511.htm.
13. Allan Osser, MD, dhe Kenneth Persson, MD, "Infeksioni i legenit pas abortit e shoqëruar me Klamidia Trakomatis
14. dhe ndikimi në gjendjen e humorit," Revista Amerikane e Obstetërve dhe Gjinekologëve (Nëntor 1984): 669–703.
15. Lars Heisterberg, MD, et al., "Pasoja e abortit të nxitur në tremestrin e parë," Revista Amerikane e Obstetërve dhe Gjinekologëve (Korrik 1986): 79.
16. Anath, CV, et al "Lidhja midis dëmtimit të placentës dhe historisë së lindjes cezariane dhe abortit , Një meta-analizë," Revista Amerikane e Obstetërve dhe Gjinekologëve (Nëntor 1997): 1071–78.
17. Jeffrey M. Barrett, MD, "Të nxisësh abortin: Një faktor rreziku për dëmtimin e placentës," Revista Amerikane e Obstetërve dhe Gjinekologëve (Dhjetor 1981): 769.
18. David Reardon, Gratë që kanë bërë abort: Mos heshtni! (Uestçestër, IL: Librat e Udhëkryqit, 1987), 106.
19. F. Parazzini, et al., "Faktorët riprodhues dhe rreziku i tumoreve përshpejtues në qafën e mitrës" Revista Britanike për Kancerin, 59:805–9 (1989); H. L. Stewart, dhe al., "Epidemiologjia dhe llojet e kancereve të qafës dhe trupit të mitrës, kancerit të gjirit dhe vezoreve në Izrael dhe qytetin e Nju Jorkut ," Revista e Institutit për Studimin Kombëtar të Kancerit 37(i):1–96; I. Fujimoto et al., "Studim Epidemiologik i Karsinomas Revista e Mjekësisë Riprodhuese 30(7):535 (Korrik 1985); C. LaVeçhia, et al., "Faktorët riprodhues dhe rreziku i tumoreve kancerozë te gratë," Revista Ndërkombëtare për Kancerin, 52:351, 1992.
20. Dr. Joel Brind, "Rishikim tërësor dhe meta-analizë mbi abortin- dhe lidhjen me kancerin e gjirit"; http://members.aol.com/DFjoseph/brind.html.
21. Brinton LA, Hoover R, Fraumeni IF, Ir. (1983) Revista Britanike për Kancerin, 47:757–62.
22. Linn, "Pasojat në shtatzënitë pasuese," 136–40. 22. John A. Richardson dhe Geoffrey Dixon, "Pasojat e fundit të ligjshëm në shtatzënitë pasuese," Revista Britanike Mjekësore (1976): 1303–4.

23. Herman, Trauma dhe Shërimi, (Nju Jork: Librat Themelorë, 1992), 34; "Pasojat dëmtuese fizike dhe psikologjike te gratë të shkaktuara nga aborti" (Një listë studimesh).
24. Për këtë dhe studime të tjera shih Instituti Elliot www.afterabortion.org.
25. David C. Reardon, "Pasojat më të mëdha psikologjike të abortit" 1997, Instituti Elliot.
26. "Të shkulësh me themel murin," Suporti për jetën, Pranverë–Verë 1991,1–3.
27. Shih Alcorn, Përgjigjet Pro-Jetës, 118–20, 285–86.
28. Informacion i lirë dhe këshillim i disponueshëm në www.lifeissues.org/men/.
29. Gissler M, Berg C, Bouvier-Colle MH, Buekens P., "Shtatzënia, lidhja me vdekjen pas lindjes, aborti spontan ose aborti i nxitur në Finlandë, 1987–2000," Am J Ob-Gyn 2004; 190:422–27.
30. Qendrat për Kontrollin e Sëmundjeve, Raporti Javor i Sëmundshmërisë dhe Vdekshmërisë 52 (SS12); 1–32, "Vëzhgim mbi Abortin në SHBA, 2000," 32.
31. James A. Miller, "Një rrëfim mbi dy aborte," Raportet Ndërkombëtare mbi Jetën Njerëzore , Mars 1991, 1.
32. John Willke, Pyetjet dhe Përgjigjet mbi Abortin (Cincinnati, OH: Hayes publikuar Co., 1988), 99; Brian Clowes, Faktet e Jetës, "Vdekjet amënore për shkak të abortit" ed. (Qershor 2001).
33. Wanda Franz, "Aborti i lidhur me shkallën e lartë të vdekshmërisë, studim zbulues" www.nrlc.org/news/2002/NRL09/franz.html.
34. Elizabeth Ring-Cassidy dhe Ian Gentles Shëndeti i Grave pas Abortit: Evidenca Mjekësore dhe Psikologjike, ed. Dytë (Instituti i Veberit, 2003), www.deveber.org.
35. "Fakte kyçe në lidhje me abortin," Instituti Elliot, n.d., www.afterabortion.org.

## *Kapitulli 12*

1. Shettles and Rorvik, Ceremonitë e Jetës (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1983), 129.

## *Kapitulli 13*

1. Jean Staker Garton, Kush e Këputi Jetën e Bebes? (Minneapolis, MN:

Publikimet e shtëpisë Bethëni, 1979), 76.
2. “Kush bën aborte?” Instituti Alen Gutmashër, www.agi-usa.org/pubs/fb_induced_abortion.html.
3. “Aborti: Fakte në një shikim të shpejtë,” Federata e Planifikimit Prindëror në Amerikë, n.d., 1.
4. John Wilke, Aborti, Pyetje dhe Përgjigje (Cincinnati, OH: Publikimet Hayes Co., 1988), 146–50.
5. Sue Reily, “Jeta e shqetësuar e gruas në qendrën e sundimit të abortit,” Oregonisti, 9 Maj 1989, A2.
6. “Jane Roe Do të Kthejë Sërish Historinë duke e bërë të Ligjshme,” Qershor 21 2003, www.theage.com.au/articles/2003/06/20/1055828492398.html
7. Feministët për Manualin e Debatit për Jetën (Kansas City, MO: Feministët për Jetën e Amerikës, n.d.), 14.
8. Frederica Mathewes-Green, “Pyet viktimat,” Revista Qytetare 2000, family.org/cforum/citizenmag/features/a0013078.cfm.

## *Kapitulli 14*

1. W. Peacock, “Vdekje e Vullnetshme,” Çështje mbi Ligjin dhe Mjekësinë, 1987. Cituar nga John Wilke, Aborti, Pyetje dhe Përgjigje (Cincinnati, OH: Publikimet Hayes Co., 1988), 212.
2. Raportet Statistikore Thelbësore Kombëtare vol. 48, no. 3, Mars 28,2000.
3. March of Dimes Foundation 2003 www.marchofdimes.com/professionals/681_1164.asp.
4. Kongresi Botëror i të Rejave për Familjen, vol. 3, çështja 1119, Mars 2002,wwworldcongress.org/WCFUpdate/Archive03/ wcf_update_3 1 1.htm cituar nga R. E. Gilbert, et al., “Shfaqja e sindromës Daun: Efektet, sigurimi, kostoja e rezultatit të strategjisë në trimestin e parë dhe të dytë”; dhe Euan M. Wallace dhe Sheila Mulvey, “Komentar: Rezultatet nuk mund të jenë gjerësisht të aplikueshme,” BMJ 2001; 323:1–6 (25 Gusht 2001); www.bmj.com.
5. Wilke, Aborti Pyetjet, 211.
6. “Të padëshiruarit e lindur: Pasojat e Zhvillimit te Fëmijët e Shtatzënive të Padëshiruara,” Federata e Planifikimit të Prindërimit në Amerikë.d.
7. Fondi i Majkëllit, Qendra 400 Penn, Pitsburgh, PA 15146.

## *Kapitulli 15*

1. Raporti i Qendrës Kombëtare të Fëmijës së Abuzuar dhe Braktisur, Departamenti i Shëndetit dhe Burimeve Njerëzore të SHBA-së, 1973–1982.
2. Shih www.acf.hhs.gov/programs/cb/publications/cm01/ chapterthree. htm#victim.
3. Edward Lenoski, Rrahje Zemre (3 Dhjetor 1980); cituar nga John Willke, Aborti, Pyetjet dhe Përgjigjet (Cincinnati, OH: Publikimet Hayes Co., 1988), 140–41.
4. Nancy Michels, Të ndihmosh gruan të marrë veten nga aborti (Minneapolis, MN: Publikimiet e Shtëpisë Bethany, 1988), 168.
5. Philip G. Ney, “Konsideratë për të mbijetuarit e abortit,” Psikiatria e Fëmijës dhe Zhvillimi Njerëzor (Pranverë 1983): 172–73.
6. Philip G. Ney, “Lidhja midis Abortit dhe Abuzimit të Fëmijës,” Revista Kanadeze e Psikiatrisë (Nëntor 1979): 611–12.
7. Michels, Të ndihmosh gruan të marrë veten..., 169–70.
8. Cituar nga James Dobson, Të Fokusohesh te Familja, trasmetim në radio, 21 Qershor 1991.
9. Peter Singer, Duke Rimenduar për Jetën dhe Vdekjen (Nju Jork: St. Martin’s Griffin, 1996), 217.

## *Kapitulli 17*

1. Frederica Mathewes-Green, Zgjedhjet e Vërteta (Sisters, OR: Publikimet Multnomah, 1995), 19.
2. David Reardon, Gratë që kanë kryer abort: Mjaft Heshtjes!” (Uestçestër, IL: Librat e Udhëkryqit, 1987), 10.
3. 1989 Libri i Faktuar i birësimit, Këshilli Kombëtar i birësimit (Uashington, DC, Qershor 1989), 158. Këto të dhëna janë relativisht të njëjtat në vitin 2000, për çdo bisedë telefonike në 5/8/00 me një përfaqësues të NCFA-së, duke deklaruar të paktën një milion çifte të pjekur për t’u bërë me fëmijë, të cilët zgjedhin minimumin e numrit të birësimeve për të sapolindurit në SHBA.
4. Cituar nga Charmaine Yoest, “Pse është kaq i vështirë birësimi?” Të fokusohesh te Familja Qytetare, 17 Dhjetor 1990, 10.
5. Dëshmi nga punojës të klinikës Siguruesit e Abortit, një video e prodhuar nga Lidhja e Veprimit të Pro-Jetës, Çikago. E konfirmuar nga ish- pronari i

klinikës, Carol Everet, në një bisedë telefonike private midis asaj dhe Frank Peretit në maj 24, 1991.
6. Mathewes-Green, Zgjedhjet e Vërteta, 14–15.
7. Yoest, "Pse është kaq i vështirë aborti?" 10.
8. Shih www.bethany.org; www.cwa.org/links.html; www.preciouskids.org/adopt/resources.html; www.adopting.com/info.html.
9. Shih http://encyclopedia.adoption.com.
10. Swopes, "Aborti: një dështim i komunikimit," www.firstthings.com/ftissues/ft9804/articles/swope.html.

## *Kapitulli 18*

1. Perspektiva e Planifikimit Familjar, Korrik–gusht 1996, 12.
2. Shih wwwiifeservices.org/pace.htm; www.afterabortion.org/healing; telefono 1-888-486-SHPRESË për këshillë konfidenciale, listë e burimeve për nevojat pas abortit www.afterabortion.org/resourc.html.

## *Kapitulli 20*

1. Rrjeti i kujdesit përmes mundësisë së linjës telefonike 1-800-395-NDIHMË (4351); në linjë direkte ndihmë në www.optionline.org.
2. Shih www.catholic.net/RCc/Prolife/prolife1.html.
3. Shërbesat e perspektivës së përjetshme, www.epm.org, info@epm.org, (503) 668-5200, 39085 Pioneer Blvd., Suite 206, Sandy, OR 97055.
4. Për informacion në Memorialin Kombëtar për Bebet e Palindura, shih www.atcmag.com/v1n4/article6.asp; Kopshti me Trëndafila i Kishës në www.epm.org/articles/rosegard.html.
5. Librin tim Përgjigjet e Pro-Jetës Argumenteve të Pro-Zgjedhjes është një përgjigje e plotë ndaj pretendimeve të përkrahësve të pro-zgjedhjes, e mbështetur në tetëqind referenca.
6. Shih Alcorn, Përgjigjet e Pro-Jetës, Shtesa K: Burimet e pro-jetës, 381–404; shih wwwë.epm.org/proliferesources.html. Një burim jashtëzakonisht ndihmës është Burimi i Fundit i Pro-Jetës te www.prolife.org/ultimate. Për t'u regjistruar rregullisht dhe për të pasur kontakt me informacionet për pro-jetën dërgoni një mesazh "subscribe" në infonet-list-request@lists.prolife.org.
7. Randy Alcorn, A shkakton abort përdorimi i kontraceptivëve? (Sendi, OR:

Shërbesat e Perspektivës së Përjetshme 1997, 2000, 2004), www.epm.org/bcp.html; Drs. Walter Larimore and Joseph Stanford, "Efektet në riprodhimin pas përdorimit të kontraceptivëve oralë." Arkivat e Mjekësisë Familjare 2000; 9:133; Dr. Walter L. Larimore, "Debati i ngritur mbi efektet e abortit në kontraceptivët dhe parimi i pasojës së dyfishtë," Revista e Etikës dhe Mjekësisë , Janar 2000; 16(1):23–30. Është i disponueshëm edhe në formatin e përditësuar në www.epm.org/articles/pilldebate.html.

8. Shih www.family.org/pregnancy/general/A0028208.html.
9. Shumë burime informuese të pro-jetës janë të gjendshme në internet, si edhe organizatën tonë në www.epm.org/prolife.html. Të gjithë artikujt e shkruar prej meje dhe çdo gjë tjetër gjendet në faqen tonë të internetit falas për të gjitha kishat dhe shërbesat, duke përfshirë edhe grupet e studimit të biblës në www.epm.org/articles/aboleson.html, dhe një shebmbull të plotë të një shërbese pro-jetës në kishë shoqëruar me mesazhin në www.epm.org/articles/abosergs.html.
10. Jeta është e Shenjtë dhe burime të tjera pro-jetës, www.family.org/resources/itempg.cfm?itemid=1072.
11. Shih www.abortionno.org/pdf/order.pdf.

# Përmbajtja

Pjesa 1 Parimet themelore

Kapitulli 1 Pse të flasim për abortin? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 10
Kapitulli 2 Pro-gruas apo pro-fëmijës? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 15

Pjesa 2 Fëmija

Kapitulli 3 A është vërtet i palinduri një qenie njerëzore? . . . . . . 20
Kapitulli 4 Cili është ndryshimi midis vezës, spermës, embrionit dhe fetusit . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 25
Kapitulli 5 A është i palinduri pjesë e trupit të gruas? . . . . . . . . . 29
Kapitulli 6 Çfarë na thonë fotografitë? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 33
Kapitulli 7 Çfarë e bën një jetë njerëzore "kuptimplotë"? . . . . . . . 38

Pjesa 3 Gruaja

Kapitulli 8 A është aborti vërtet një çështje e së drejtës së gruas? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 44
Kapitulli 9 A kemi të drejtë të zgjedhim të bëjmë ç'të duam me trupat tanë? . . . . . . . . . . . . . . . . . . 48
Kapitulli 10 A është aborti pjesë e së drejtës së privatësisë? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 52
Kapitulli 11 A dëmton aborti shëndetin fizik dhe mendor të gruas? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 55
Kapitulli 12 A është aborti i drejtë kur shtatzënia rrezikon jetën e nënës? . . . . . . . . . . . . . . . . . . 61
Kapitulli 13 A është aborti i drejtë kur shtatzënia vjen për shkak të një përdhunimi apo incesti? . . . . 63

Pjesa 4 Çështje të tjera të rëndësishme

Kapitulli 14 Po rastet e fëmijëve të padëshiruar apo me aftësi të kufizuara ? . . . . . . . . . . . . . . . 68
Kapitulli 15 A e parandalon aborti abuzimin e fëmijës? . . . . . . . 73
Kapitulli 16 Personalisht kundërshtoj abortin, por jam pro-zgjedhjes? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 76
Kapitulli 17 Po në lidhje me birësimin? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 78

## Pjesa 5 Perspektiva dhe mundësitë shpirtërore

Kapitulli 18 A mund t'i falë Perëndia abortet? . . . . . . . . . . . . . . 84
Kapitulli 19 Çështjet pro-jetës: çorientim nga porosia e madhe apo pjesë e saj? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 89
Kapitulli 20 Si mund t'i ndihmoj bebet e palindura dhe nënat e tyre? . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 94
Mbi autorin . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 101
Shënime. . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . 102